



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 16

Tiranë – E martë, 31 janar 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 27.1.2023	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2024–2026.....	1975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 27.1.2023	Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (përfituesi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (agjencia), për financimin e projektit “Furnizimi me ujë i qytetit të Durrësit”.....	1988
Vendim, i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 27.1.2023	Për miratimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore	2010
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 21, datë 19.1.2023	Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në detin Adriatik (në zonat gjeografike 17 dhe 18).....	2026



VENDIM

Nr. 31, datë 27.1.2023

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT
MAKROEKONOMIK E FISKAL PËR
PERIUDHËN 2024–2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2024–2026, “Treguesit kryesorë makroekonomikë”, lidhja nr. 1, dhe “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, lidhjet nr. 2/1 e nr. 2/2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**KUADRI MAKROEKONOMIK DHE
FISKAL 2024–2026
JANAR, 2023**

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtime

Hyrje

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

2. Politikat fiskale

3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike
Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Lidhja nr. 1, “Treguesit kryesorë makroekonomikë”

Lidhja nr. 2/1, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milion lek)”

Lidhja nr. 2/2, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)”

SHKURTIME

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	<i>World Economic Outlook</i>

**KUADRI MAKROEKONOMIK DHE
FISKAL 2024–2026**

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën 2024–2026 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF-ja ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë, në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, si: balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF-ja shërben si bazë për përcaktimin e taveve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024–2026 në nivel ministrie.

KMF-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA-së dhe të taveve për shpenzimet.

KMF-ja përmban dy komponentë kryesorë: i. parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë, të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vitet e ardhshëm; dhe ii parashikimet dhe objektivat për



treguesit fiskalë të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2024–2026 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë, sipas buxhetit të konsoliduar. Këto komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht lidhja nr. 1; lidhja nr. 2/1; dhe lidhja nr. 2/2.


1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, deri përpara goditjes nga pandemia e COVID-19, ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Performanca e vitit 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështira në tri dekada. Ekonomia e vendit përjetoj dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij.

Sidoqoftë, me gjithë ndikimin e rëndë që të dyja goditjet kanë pasur për ekonominë e vendit, në saje

të përgjigjeve relativisht të mira të politikave ekonomike dhe masave të duhura rregullatore të ndërmarra, të dhënat statistikore dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë ishte konsiderueshëm më e shpejtë se sa pritshmëritë fillestare.

Gjithashtu, edhe nën ndikimin e goditjes më të fundit negative, e reflektuar në një pakësim të ofertës globale të disa mallrave bazë, e cila ka çuar në një rritje të fortë të nivelit të përgjithshëm të çmimeve (inflacionit), si dhe në një shtrëngim të fortë të kushteve financiare, sërish deri më tani, fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj të gjitha këtyre goditjeve.



Pas recesionit të fortë në vitin 2020, në normën prej -3.5 përqindësh, ekonomia është rikuperuar fuqishëm në vitin 2021, në normën 8.5 për qind dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2022, ekonomia e vendit vijoi sërish të performojë me një rritje pozitive dhe relativisht të lartë edhe pse nën ndikimin e goditjes më të fundit të ofertës. Sipas vlerësimeve më të fundit nga INSTAT-i, PBB-ja reale u rrit me 6.37 për qind në terma vjetorë në tremujorin e parë të vitit 2022, duke u pasuar nga një rritje më e përmbajtur prej

2.65 përqindësh në tremujorin e dytë dhe vijoi trajektoren pozitive me një rritje prej 4.02 përqindësh në tremujorin e tretë, krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2021. Ndërsa në terma nëntëmujorë, për vitin 2022, ekonomia ka shënuar rritje me 4.23 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të 2021.

Sipas optikës së kërkesës agregate, sipas vlerësimeve të deritanishme, rritja përgjatë vitit 2022 duket të jetë gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat, ashtu edhe nga investimet.



Eksportet, si të mallrave, ashtu edhe të shërbimeve (veçanërisht turizmi), kanë pasur një ecuri mjaft të mirë, Megjithëse njëkohësisht edhe importet kanë regjistruar po ashtu një rritje të fortë (në reflektim të rritjes së kërkesës agregate), sërish kontributi neto i kërkesës së huaj ka qenë pozitiv.

Konsumi final për nëntëmujorin 2022 ka shënuar rritje prej 6.4 përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 8.3 për qind. Ndërkohë, vetëm për tremujorin e tretë konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan një normë rritje në respektivisht 6.7 për qind dhe 8.1 për qind.

Formimi i Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale) shënoi rritje me rreth 4.6 për qind në terma realë vjetorë përgjatë nëntë muajve të vitit 2022, ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2022 kjo normë ishte 7.12 për qind.

Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore të INSTAT-it, përgjatë nëntë muajve të vitit 2022, eksportet e mallrave dhe shërbimeve kanë pasur një rritje të moderuar prej rreth 9.2 përqindësh, ndërsa rritja ka qenë e fortë në importet e mallrave dhe shërbimeve prej rreth 17.2 përqindësh.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, sektorët të cilët kanë shënuar rritjen më të fortë përgjatë periudhës nëntëmujore të viti 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: “Aktivitete të pasurive të paluajtshme”, me rritje prej 13.28 përqindësh; “Tregtia me shumicë dhe pakicë”, me rritje me 10.84 për qind; “Aktivitete financiare dhe të sigurimit”, me rritje prej 10.77 përqindësh; “Ndërtimi”, me rritje prej 9.31 përqindësh; si dhe “Informacioni dhe komunikacioni”, me rritje prej 8.36 përqindësh etj. Ndër sektorët që kanë pësuar rënie janë : “administrimi publik, arsimi dhe shëndetësia”, me rënie prej -3.03 përqindësh; dhe “industria”, me rënie prej -0.69 përqindësh.

Zhvillimet në tregun e punës, referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, kanë qenë pozitive dhe në rikuperim të vijueshëm pas valës së rënies së aktivitetit ekonomik shkaktuar nga pandemia. Situata aktuale në numrin total të të punësuarve është përmirësuar, duke shënuar rritje për çdo tremujor, prej tremujorit të dytë 2021 e në vijim deri në tremujorin e tretë 2022, që janë dhe të dhënat e fundit të disponueshme. Për nëntëmujorin 2022, rritja vjetore e numrit të të punësuarve ka

qenë mesatarisht 4.7 për qind. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e 2022 ishte 11.3 për qind, duke pësuar rënie nga niveli prej 12.1 përqindësh i nëntëmujorit të 2021. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë 2022, norma e papunësisë për grup-moshën 15–64 vjeç, ka shënuar 10.8 për qind, normën më të ulët të regjistruar në të paktën dekadën e fundit. Gjithashtu, për grup-moshën 15 vjeç e lart, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, shënoi nivelin më të ulët prej rreth 10.6 përqindësh.

Bazuar në statistikën e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, Bilanci i Pagesave (BP) për vitin 2021 regjistroi një tepëriçë pozitive prej 936.2 milionë eurosh, ndërsa për nëntëmujorin e vitit 2022 bilanci i pagesave regjistroi një tepëriçë negative prej -58.1 milionë eurosh, kundrejt një balance pozitive prej 209.6 milionë eurosh në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Deficiti i llogarisë korrente për nëntëmujorin 2022 shënon një deficit prej 621 milionë eurosh, i ngushtuar lehtësisht krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë me rreth 4.6 milionë eurosh ose 0.7 për qind. Ecuria e deficitit korrent reflektoi kryesisht thellimin e deficitit tregtar në mallra dhe zgjerimin e balancës negative të të ardhurave parësore, faktorë të cilët janë kompensuar në masë të madhe nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime, si dhe rritja e remitancave. Eksporti i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me turizmin u zgjerua në vlerën 2.2 miliardë euro për nëntëmujorin 2022, ose rreth 48.8% më shumë krahasuar me 1.5 miliardë euro në të njëjtën periudhë të një vitit më parë.

Nga ana tjetër, deficiti tregtar rezultoi me një zgjerim prej rreth 424 milionë eurosh ose 16.3 për qind krahasuar me nëntëmujorin e 2021. Eksporti i mallrave për nëntëmujorin 2021 u rrit me 61.8 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021, por në të njëjtën kohë edhe importi i mallrave u zgjerua ndjeshëm me rreth 28.1 për qind, në reflektim të rritjes së kërkesës së brendshme stimuluar edhe nga sezoni turistik. Pësua ndjeshëm më e lartë e importeve të mallrave në raport me eksportet çoi për rrjedhojë në zgjerimin e deficitit tregtar. Remitancat për periudhën nëntëmujore të vitit 2022 shënuan vlerën 592 milionë euro, me një rritje prej rreth 9.8 përqindësh krahasuar me 539 milionë euro në periudhën respektive të një viti më parë. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2022, tepërica



pozitive e llogarisë financiare dhe kapitale rezultoi në 582 milionë euro krahasuar me 734 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brenda kësaj llogarie, investimet e huaja direkte hyrëse shënuan nivelin prej 984 milionë eurosh për nëntëmujorin e parë të vitit 2022, ose një rritje prej 34.8 përqindësh në krahasim me nivelin prej 730 milionë eurosh të së njëjtës periudhë të 2021.


Inflacioni mesatar përgjatë vitit 2021 ishte 2.0 për qind. Ndërsa inflacioni mesatar për periudhën janar–nëntor të vitit 2022 shënoi 6.7 për qind, duke reflektuar rritjen e çmimeve prej goditjes së fundit të ofertës globale të disa të mirave bazë, për shkak të luftës në Ukrainë, duke e kthyer inflacionin në një nga çështjet kryesore makroekonomike për ekonominë tonë, ashtu si në shumë vende të tjera të botës. Gjithsesi, inflacioni në Shqipëri deri më tani ka rezultuar sa pothuajse vetëm gjysma e inflacionit mesatar të vendeve të rajonit tonë (Ballkanit Perëndimor), si dhe ndjeshëm më ulët se sa mesatarja e Bashkimit Evropian. Kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore ka qëndruar përgjithësisht stabil. Kursi mesatar lek/euro për janar–nëntor 2022 ishte 119.4 nga

122.6 që ishte mesatarisht gjatë së njëjtës periudhë të 2021–shit. Ndërsa kursi mesatar lek/USD për janar–nëntor 2022 ishte 113.5 nga 103.2, që ishte mesatarisht gjatë së njëjtës periudhë të 2021.

2. Politikat fiskale

Pas një stimuli të lartë, për të kryer një politikë fiskale ekspansioniste të domosdoshme dhe njëkohësisht të paevitueshme gjatë viteve 2020 dhe 2021, me qëllim amortizmin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme 2024–2026 do të riorientohet sërish drejt konsolidimit fiskal, ndërkohë që do të sigurojë një nivel investimesh publike relativisht të lartë prej mesatarisht rreth 5 përqindësh të PBB-së në vit (vetëm nga qeveria qendrore). Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2024–2026 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të Ligjit Organik të Buxhetit (shih kuadratin në faqen 8).

Targetet e politikës fiskale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 2.2 përqindësh të PBB-së për 2024, nga 2.6 për qind i programuar për vitin 2023; nivelin prej 2.2 përqindësh të PBB-së në vitin 2025 dhe 1.7 për qind në 2026. Njëkohësisht, balanca primare pritët të rikthehet në norma pozitive prej rreth 0.3 përqindësh, që prej vitit 2023, në përmirësim të qartë nga niveli negativ prej 1.2 përqindësh i PBB-së i pritshëm deri në fund të 2022-shit. Ndërkohë që targetohet në vijimësi në vlera pozitive për vitin 2024 me 0.9 për qind, në vitin 2025 me 1.2 për qind dhe 1.8 për qind në vitin 2026.

Balanca primare është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjate të financave publike, për të cilën, në korrik të 2020 u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore, duke përfshirë një rregull të ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të “aquis” të BE-së, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë, që duke filluar që

prej vitit buxhetor 2024 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarëvajtjes së ekonomisë së vendit. Më konkretisht, duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të KMF-së aktuale, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objekti (rregull fiskal) të parametrit të balancës primare, pritët të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik bruto rreth nivelit prej 64.2 përqindësh të PBB-së deri në vitin 2026 nga rreth 68.8 për qind që pritët të rezultojë në 2022.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 9936/2008, të ndryshuar, KMF 2024–2026 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, KMF-së 2024–2026 targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB-së më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, KMF-së 2024–2026 bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB-së nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të FMN-së të raportit “Perspektiva Ekonomike Botërore” (World Economic Outlook)¹, të tetorit 2022.

Parashikimet e PBB nominale të MFE dhe FMN				(në miliardë Lekë)			
	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
			Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
MFE	1,644.1	1,889.8	2,058.2	2,176.1	2,285.9	2,401.8	2,526.6
FMN	1,644.1	1,889.8	2,059.0	2,176.7	2,287.5	2,403.3	2,530.8
Diferenca MFE - FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	0.0	0.0	-0.9	-0.6	-1.6	-1.4	-4.2

¹ Linku për raportin WEO: <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2022/10/11/world-economic-outlook-october-2022>



3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 përqindësh të shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga lubatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, kuadri 2024–2026 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për lubatjet e normave të interesit etj.” një kontingjencë prej jo më pak se 0.7 përqindësh të shpenzimeve totale.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4/1, të ligjit organik të buxhetit nr. 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, kuadri 2024–2026 nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulla e artë”) të LOB-së, deficitin e targetuar në kuadrin 2024–2026 është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara. Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 3.1 përqindësh të PBB-së në çdo vit të programuar.

6. Në çdo vit buxhetor, që prej vitit 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (suficit primar).

Në përputhje me këtë dispozitë, kuadri 2024–2026 targeton një balancë primare pozitive në vitin 2024 me 0.9 për qind, 1.2 për qind në vitin 2025 dhe 1.8 për qind në vitin 2026.

3. Parashikimet e Treguesve Makroekonomikë dhe Fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si INSTAT-i, BSH-ja, MFE-ja, FMN-ja, BB-ja, Eurostat etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre, e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri, është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme për të ndodhur dhe maksimalisht

konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre vjetëve në vijim, nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa më shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Evropian, janë:

- Synimi i një trajktore rënëse të borxhit publik, duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit prej vitit buxhetor 2024 dhe në vijim. Ky objektiv është ligjërish i detyrueshëm në LOB.

- Mbatja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 5 për qind të PBB-së mesatarisht çdo vit.

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektivi themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3.0 për qind, në një periudhë afatmesme dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizimin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare, me qëllim për të mbështetur rritjen afatgjatë ekonomike të vendit.

- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel



dysHEME të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal, brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recesionit të fortë prej -3.5 përqindësh në vitin 2020, ekonomia u rimëkëmb fuqishëm në vitin 2021, duke shënuar rritje reale prej 8.5 përqindësh. Për vitin 2022 kjo rritje vlerësohet të jetë rreth 3.7 për qind dhe pritet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në normën 2.6 për qind për vitin 2023 dhe parashikohet mesatarisht rreth 3.9 për qind në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2024–2026. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 3.8, 3.9 dhe 4.0 për qind, respektivisht për vitet 2024, 2025 dhe 2026.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi, ashtu edhe investimet. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto (eksport-import) pritet të ketë një efekt të moderuar pozitiv. Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave, të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, veçanërisht pas rikthimit në nivelet normale të inflacionit, i cili pritet të ndodhë gradualisht brenda vitit 2023, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredimarrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet edhe nga përmirësimi i pritshëm i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ që goditja e ofertës ka shkaktuar në inflacion dhe në normat e interesit.

Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i

kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përsheptimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht, edhe përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies gradualisht përgjatë afatit të mesëm, priten të jenë faktorë të rëndësishëm incentivues të investimeve private.


Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2024–2026) parashikohet të rritet në terma realë, me mesatarisht rreth 2.9 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.5 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa, investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë, mesatarisht në rreth 3.7 për qind në vitet 2024–2026, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 0.8 pikë përqindjeje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të rikthejnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2024–2026, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 4.7 për qind në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.9 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa, importet e mallrave dhe të shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 2.6 për qind në vit, me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së, me rreth 1.3 pikë përqindjeje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut të moderuar pozitiv në rritjen totale të PBB-së me mesatarisht rreth 0.6 pikë përqindjeje në vit.



Grafik 3.1: Rritja reale (majtas, në për qind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës agregate




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në mbi 5 për qind të PBB në vitet 2024–2026 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimul në sektorin privat, fundamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritjeje të lartë e të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritët të rritet mesatarisht me rreth 2.4 për qind në vit në terma realë përgjatë periudhës 2024–2026, me një kontribut mesatar vjetor në rritjen ekonomike prej rreth 0.4 pikë përqindjeje; industria me një rritje mesatare vjetore prej rreth 4.5 përqindësh dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.6 pikë përqindjeje; ndërtimi me rritje mesatare vjetore prej rreth 2.8 përqindësh dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.3 pikë përqindjeje; Shërbimet me një rritje mesatare vjetore prej rreth 4.5 përqindësh dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.1 pikë përqindjeje.


Grafik 3.2: Rritja reale (majtas, në përqindje) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të ofertës agregate



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 0.4 përqindësh në vit gjatë viteve 2024–2026. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pothuajse të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Krahas zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatën e mesëm, pritet që edhe produktiviteti i përgjithshëm i punës të vijojë një përmirësim gradual gjatë kësaj periudhe.

Grafik 3.3: Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në përqindje) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në përqindje)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Presionet inflacioniste parashikohet të zbuten në periudhën afatmesme. Me shuarjen e efektit të bazës në normën e inflacionit, duke supozuar se nuk do të ketë një goditje tjetër të qenësishme në ofertën globale të mallrave bazë, si dhe në reflektim të tkurrjes së të ardhurave reale të disponueshme dhe shtrëngimit domethënës të kushteve financiare, të cilat do të ushtrojnë një presion frenues të kërkesës agregate, në skenarin bazë parashikohet (supozohet) se inflacioni do të rikthkehet gradualisht drejt targetit të tij prej 3% në fund të vitit 2023 dhe do të qëndrojë rreth këtij niveli për periudhën afatmesme 2024–2026.


Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur VKM-së.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave dhe ndryshimeve fiskale të ndërmarra dhe veçanërisht ato të pritshme për t'u ndërmarrë në vijim, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vjetët në vijim (2024–2026) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 3.7 për qind në çdo vit. Më specifikisht 0.7 për qind për vitin 2024; 4.9 për qind për 2025-n; dhe 5.5 për qind për 2026-n. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 4.9 përqindësh.

**Grafik 3.4:** Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në përqindje të PBB-së)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vjetët në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2024–2026 pritet të jenë mesatarisht në rreth 729.2 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 30.3 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5.1 përqindësh të PBB-së në çdo vit (vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përstatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik 3.5: Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në përqind të PBB-së)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëngjitur VKM-së, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBBë-në.

**Lidhja nr. 1:** Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
					Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
Inflacioni (mesatar)	%	1.4	1.6	2.0	6.7	3.6	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	1.3	0.7	5.9	5.1	3.0	1.2	1.1	1.1
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	109.9	108.6	103.5	113.1	113.1	113.1	113.1	113.1
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	123.0	123.8	122.5	119.0	119.0	119.0	119.0	119.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	42.3	42.5	43.0	42.4	42.1	41.7	41.5	41.3
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	57.1	58.3	57.8	58.0	58.3	58.5	58.8	58.9
Rritja reale e PBB	%	2.1	-3.5	8.5	3.7	2.6	3.8	3.9	4.0
PBB	Lek miliardë	1,691.9	1,644.1	1,889.8	2,058.2	2,176.1	2,285.9	2,401.8	2,526.6
PBB	USD	15.4	15.1	18.3	18.2	19.2	20.2	21.2	22.3
PBB	Euro miliard	13.8	13.3	15.4	17.3	18.3	19.2	20.2	21.2
PBB për banor	Lek mijë	591.1	577.7	667.8	736.7	781.1	823.1	867.9	916.7
PBB për banor	USD	5,380.7	5,317.0	6,451.4	6,515.6	6,908.2	7,279.5	7,675.9	8,106.7
PBB për banor	Euro	4,804.9	4,667.6	5,453.6	6,188.8	6,561.7	6,914.4	7,290.9	7,700.1
PBB për banor	USD-PPP	13,959.1	13,593.4	15,542.5	17,378.3	18,558.7	19,718.0	20,900.1	22,171.1
PBB për banor	Euro-PPP	10,352.8	9,916.4	11,556.6	12,699.8	13,407.2	14,067.1	14,765.4	15,550.1
Norma e papunësisë	%	12.0	12.2	12.0	11.2	10.7	10.2	9.8	9.5
Të ardhurat totale	% të PBB	27.2	25.9	27.0	28.2	29.5	28.3	28.3	28.4
Shpenzimet totale	% të PBB	29.1	32.6	31.6	31.4	32.1	30.5	30.4	30.1
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-1.9	-6.7	-4.5	-3.2	-2.6	-2.2	-2.2	-1.7
Bilanci primar fiskal	% të PBB	0.2	-4.6	-2.6	-1.2	0.3	0.9	1.2	1.8
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	2.6	-0.5	2.3	2.4	3.1	2.9	3.0	3.5
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	64.8	74.0	69.3	67.5	66.3	65.2	64.2	62.6
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	65.8	74.5	73.2	68.8	67.5	66.3	65.3	64.2
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	63.3	71.5	70.3	65.4	64.1	63.3	62.4	61.5
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	2.5	3.0	2.9	3.4	3.4	3.0	2.9	2.7
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-7.9	-8.7	-7.6	-7.6	-6.9	-5.6	-5.1	-5.0
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-13.7	-14.5	-13.2	-12.6	-11.2	-9.5	-8.6	-8.0
Mallra	% të PBB	-22.9	-22.5	-24.8	-26.1	-24.3	-23.1	-22.4	-22.0
Eksporte	% të PBB	6.6	6.0	8.2	11.8	12.7	13.1	13.2	13.4
Importe	% të PBB	-29.4	-28.4	-33.0	-37.9	-37.0	-36.2	-35.6	-35.3
Bilanci i pagesave	% të PBB	-0.6	4.9	6.1	1.1	2.5	3.4	3.5	3.4
Rezervat valutore	Euro milion	3,359.6	3,942.4	4,972.2	5,157.8	5,622.4	6,284.1	6,988.5	7,716.9
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	6.5	9.6	8.8	6.8	7.2	7.8	8.3	8.8

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore

**Lidhja nr. 2/1 : Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milion lek)**

Nr.	E M E R T I M I	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
					Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	460,349	425,905	510,951	579,831	642,619	647,426	679,194	716,871
I.	Ndihmat	10,609	8,294	13,050	9,994	30,558	13,957	13,365	13,200
II.	Të ardhura tatimore	426,271	398,658	475,612	545,187	588,453	610,070	641,830	679,071
II.1	Nga tatimet dhe doganat	304,758	278,984	338,074	398,000	431,200	444,329	467,689	495,825
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	23,102	21,975	26,666	27,632	29,153	30,516	31,973	33,544
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	98,411	97,699	110,872	119,555	128,100	135,224	142,168	149,702
III.	Të ardhura jo-tatimore	23,469	18,953	22,289	24,650	23,608	23,400	24,000	24,600
	TOTALI I SHPENZIMEVE	491,897	536,279	596,279	645,307	698,117	697,585	730,883	759,266
I.	Shpenzime Korrente	416,852	421,366	461,065	490,578	546,709	579,142	602,346	625,856
I.1	Personeli	76,962	76,895	83,268	84,734	96,978	99,566	100,716	101,366
	Paqja	65,636	65,800	71,179	72,054	80,065	80,269	81,519	81,769
	Kontributi për sigurime shoqërore	10,579	10,562	11,403	11,881	13,413	13,398	13,298	13,698
	Fondi i veçantë i pagave					400		400	400
	Politika të reja paqash					2,300	4,500	4,500	4,500
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	747	532	686	800	2,300	4,500	4,500	4,500
I.2	Interesat	35,143	34,393	35,822	40,000	60,943	71,612	79,840	88,822
	Të brendshme	22,838	22,351	23,470	24,363	34,283	41,126	46,808	50,483
	Të huaja	12,305	12,042	12,352	15,636	21,760	24,683	27,432	32,039
	Kontingjencë për risqet e borxhit					4,900	5,800	5,800	6,300
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	47,215	48,906	59,363	66,875	65,203	64,085	64,235	64,675
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)				63,375	61,703	60,485	60,435	60,775
	Arsimi i lartë				900	900	1,000	1,000	1,000
	Të tjerë jashtë limitit				2,600	2,600	2,600	2,800	2,900
I.4	Subvencionet	1,421	1,478	1,422	1,689	1,600	1,700	1,700	1,700
I.5	Shpenzime për fondet speciale	175,628	179,364	199,457	209,204	226,351	243,344	252,804	262,844
	Sigurime shoqërore	131,238	134,151	148,030	156,352	161,585	174,838	181,838	190,238
	Politika të reja pensionesh				2,200	4,353	4,763	4,763	4,853
	Bonusi i pensionistit					3,530	3,650	3,750	3,800
	Sigurime shëndetësore	42,118	43,289	49,130	50,719	54,536	55,502	56,952	57,952
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	2,272	1,924	2,297	2,134	4,500	5,000	5,500	6,000
I.6	Buxheti lokal	56,227	51,626	52,585	57,960	65,584	68,585	71,401	74,450
	Transferat nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	33,124	29,651	25,226	25,751	31,651	32,799	34,008	35,406
	Transferat e pakushtëzuar e përgjithshme				15,233	21,761	22,859	24,018	25,266
	Transferat e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specific)				9,353	9,890	9,940	9,990	10,140
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	23,102	21,975	25,791	27,632	29,153	30,516	31,973	33,544
	Taksa të ndara				1,110	1,080	1,170	1,220	1,300
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				2,840	2,900	3,100	3,200	3,200
	Financimi i huaj vendor dhe të tjerë të mbartura			404	627	800	1,000	1,000	1,000
I.7	Transferat të tjerë	24,257	28,703	29,149	30,115	30,505	30,250	31,650	32,000
	Paqesa e papunësisë	505	888	952	774	900	800	800	800
	Ndihma ekonomike dhe politike e femijeve, etj	20,189	23,996	23,981	24,994	25,950	26,250	26,600	26,900
	Kompensim për të përndjekurit politikë	1,199	1,000	913	1,197	1,000	1,000	2,000	2,000
	Bonusi i lindjeve	2,364	2,820	3,303	3,150	2,200	2,200	2,250	2,300
II.	Fondi rezervë		12,052	461		15,500	2,000	4,000	3,400
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave					1,700	2,000	2,500	3,400
	Rezervë për zqiedhjet					1,800		1,500	
	Paketa e mbështetjes sociale (Covid); Pasojat e luftës Rus-Ukr		12,052	461					
	Kontingjencë					12,000			
III.	Shpenzime kapitale	74,993	101,672	128,044	115,729	123,908	116,443	124,537	130,010
	Financimi i brendshëm	50,641	59,547	72,116	61,927	72,248	65,413	68,387	67,410
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	890	1,040	708	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Financimi i huaj	23,462	24,494	25,699	20,702	45,660	50,030	53,150	58,600
	Trans kapitale për illog. speciale të shpronësimeve				1,000			2,000	3,000
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit.		16,591	29,521	31,100	5,000			
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)			29,521	31,100	5,000			
V.	Të tjerë	53	988	3,709	28,000	12,000			
	Hua e dhënë për sis. energji, e të tjerë nga burimet e brendshme				8,000				
	Mbështetje buxhetore për sektorin energjistik				20,000	12,000			
VI.	Fond shpronësimi		200	3,000	11,000				
		-31,549	-110,374	-85,328	-65,476	-55,498	-50,159	-51,688	-42,396
	FINANCIMI DEFIÇITIT	31,549	110,374	85,328	65,476	55,498	50,159	51,688	42,396
I.	I brendshëm	40,932	49,426	-18,701	71,740	31,325	38,400	26,980	12,288
	Të ardhura nga privatizimi	242	228	306					
	Hua-marrje e brendshme (neto)	17,846	48,380	48,705	25,000	25,000	39,500	28,000	27,000
	Të tjerë, nga të cilat:	22,844	818	-67,712	46,740	6,325	-1,100	980	-14,712
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	16,624	14,747	-72,713	46,740	325	-1,100	980	-14,712
	Ndryshimi i gjendjes së depozitës sig. Shoq&Shend					6,000			
II.	I huaj	-9,383	60,948	104,029	-6,265	24,173	11,759	22,708	30,108
	Hua afatgjatë (e marrë)	20,493	97,467	93,491	14,329	92,110	96,680	99,300	104,950
	Për projekte	20,493	17,162	14,561	13,702	33,660	38,030	40,650	46,300
	Eurobond		80,305	78,527		57,650	57,650	57,650	57,650
	Nen-hua (Pushteti vendor)			404	627	800	1,000	1,000	1,000
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-1,729	1,386	1,161					
	Ripaqsat	-29,791	-61,698	-33,164	-39,042	-79,467	-84,921	-76,592	-74,842
	Eurobond		-30,945			-28,825	-28,825		-28,825
	Maturim		-30,887						
	Para-bletje					-28,825	-28,825		-28,825
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	1,643	23,793	42,541	18,448	11,530			
MEMO:									
	Balanca e përgjithshme (deficitit përgjithshëm)	-31,549	-110,374	-85,328	-65,476	-55,498	-50,159	-51,688	-42,396
	Balanca korente	43,444	-8,702	42,716	50,253	68,410	66,284	72,848	87,614
	Balanca primare	3,594	-75,980	-49,506	-25,476	5,444	21,454	28,152	46,426
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	16,176	7,793	72,635	25,895	25,569	26,669	25,689	40,401
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	1,096,450	1,216,677	1,310,341	1,389,926	1,443,726	1,489,370	1,541,618	1,582,008
	Borxhi publik BRUTO (stok)	1,112,626	1,224,470	1,382,976	1,415,820	1,469,296	1,516,040	1,567,307	1,622,408
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	1,070,191	1,175,226	1,327,765	1,346,500	1,395,673	1,446,932	1,497,640	1,554,748
	I brendshëm (stok)	582,136	630,791	678,881	703,881	728,881	768,381	796,381	823,381
	I huaj (stok)	488,056	544,434	648,884	642,620	666,793	678,551	701,259	731,367
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	42,434	49,245	55,211	69,320	73,622	69,108	69,667	67,661
	Pushteti vendor (stok)	582	432	315	650	750	900	900	900
	Borxhi publik i garantuar (stok)	41,853	48,813	54,896	68,670	72,872	68,208	68,767	66,761
	Stoku i detyrimeve të papaguara (stok)								
	Shlyerje e stokut të detyrimeve direkt nga buxheti (fluksi)								
	Shlyerje e stokut të detyrimeve nepermjet netting-off (fluksi)								
	PBB nominal	1,691,903	1,644,077	1,889,839	2,058,155	2,176,100	2,285,879	2,401,850	2,526,593

Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Lidhja nr. 2/2: Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)

Nr.	E M È R T I M I	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
					Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	27.2	25.9	27.0	28.2	29.5	28.3	28.3	28.4
I.	Ndihmat	0.6	0.5	0.7	0.5	1.4	0.6	0.6	0.5
II.	Të ardhura tatimore	25.2	24.2	25.2	26.5	27.0	26.7	26.7	26.9
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.0	17.0	17.9	19.3	19.8	19.4	19.5	19.6
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.4	1.3	1.4	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	5.8	5.9	5.9	5.8	5.9	5.9	5.9	5.9
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.4	1.2	1.2	1.2	1.1	1.0	1.0	1.0
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.1	32.6	31.6	31.4	32.1	30.5	30.4	30.1
I.	Shpenzime Korrente	24.6	25.6	24.4	23.8	25.1	25.3	25.1	24.8
I.1	Personeli	4.5	4.7	4.4	4.1	4.5	4.4	4.2	4.0
	Paqa	3.9	4.0	3.8	3.5	3.7	3.5	3.4	3.2
	Kontributi për sigurime shoqërore	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.5
	Fondi i vecantë i pagave								
	Politika të reja pagash								
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta								
I.2	Interesat	2.1	2.1	1.9	1.9	2.8	3.1	3.3	3.5
	Të brendshme	1.3	1.4	1.2	1.2	1.6	1.8	1.9	2.0
	Kontingjencë për risqet e borxhit	0.7	0.7	0.7	0.8	1.0	1.1	1.1	1.3
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	2.8	3.0	3.1	3.2	3.0	2.8	2.7	2.6
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)				3.1	2.8	2.6	2.5	2.4
	Arsimi i lartë								
	Të tjera jashtë limitit								
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	10.4	10.9	10.6	10.2	10.4	10.6	10.5	10.4
	Sigurime shoqërore	7.8	8.2	7.8	7.6	7.4	7.6	7.6	7.5
	Politika të reja pensionesh					0.1	0.2	0.2	0.2
	Bonusi i pensionistit								
	Sigurime shëndetësore	2.5	2.6	2.6	2.5	2.5	2.4	2.4	2.3
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2	0.2
I.6	Buxheti lokal	3.3	3.1	2.8	2.8	3.0	3.0	3.0	2.9
	Transferat nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	2.0	1.8	1.3	1.3	1.5	1.4	1.4	1.4
	Transferat e pakushtëzuar e përqijthshme				0.7	1.0	1.0	1.0	1.0
	Transferat e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specific)				0.5	0.5	0.4	0.4	0.4
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	1.4	1.3	1.4	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3
	Taksa të ndara				0.1	0	0.1	0.1	0.1
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura								
I.7	Transferat të tjera	1.4	1.7	1.5	1.5	1.4	1.3	1.3	1.3
	Pagosa e papunësisë	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Ndihma ekonomike dhe politike e famjeve, etj	1.2	1.5	1.3	1.2	1.2	1.1	1.1	1.1
	Kompensim për të përndjekurit politikë	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Bonusi i lindjeve	0.1	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë		0.7	0.0		0.7	0.1	0.2	0.1
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave					0.1	0.1	0.1	0.1
	Rezerve për zgjedhjet					0.1			
	Paketa e mbështetjes sociale nga COVID		0.7						
	Kontingjencë								
III.	Shpenzime kapitale	4.4	6.2	6.8	5.6	5.7	5.1	5.2	5.1
	Financimi i brendshëm	3.0	3.6	3.8	3.0	3.3	2.9	2.8	2.7
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0.1	0.1	0.1					
	Financimi i huaj	1.4	1.5	1.4	1.0	2.1	2.2	2.2	2.3
	Trans kapitale për lloq, speciale të shpronësimeve								
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit			1.0	1.6	1.5	0.2		
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)				1.6	1.5	0.2		
V.	Të tjera		0.1	0.2	1.4	0.6			
	Hua e dhene për sis. energji, e të tjera nga burimet e brendshme				0.4				
	Mbështetje buxhetore për sektorin energjiek				1.0	0.6			
VI.	Fond shpronësimit		0.0	0.2	0.5				
	DEFICITI	-1.9	-6.7	-4.5	-3.2	-2.6	-2.2	-2.2	-1.7
	FINANCIMI DEFICITIT	1.9	6.7	4.5	3.2	2.6	2.2	2.2	1.7
I.	I brendshëm	2.4	3.0	-1.0	3.5	1.4	1.7	1.2	0.5
	Të ardhura nga privatizimi								
	Hua-marrje e brendshme (neto)	1.1	2.9	2.6	1.2	1.1	1.7	1.2	1.1
	Të tjera, nga të cilat	1.4		-3.6	2.3	0.3			-0.6
	Ndriyshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	1.0	0.9	-3.8	2.3				-0.6
	Ndriyshimi i gjendjes së depozitës sig. Shoq&Shend					0.3			
II.	I huaj	-0.6	3.7	5.5	-0.3	1.1	0.5	0.9	1.2
	Hua afatgjatë (e marrë)	1.2	5.9	4.9	0.7	4.2	4.2	4.1	4.2
	Per projekte	1.2	1.0	0.8	0.7	1.5	1.7	1.7	1.8
	Per ri-ndërtimin nga tërmeti								
	Eurobond		4.9	4.2		2.6	2.5	2.4	2.3
	Nen-hua (Pushteti vendor)								
	Ndriyshimi i gjendjes së arkës	-0.1	0.1	0.1					
	Ripagesat	-1.8	-3.8	-1.8	-1.9	-3.7	-3.7	-3.2	-3.0
	Eurobond		-1.9			-1.3	-1.3		-1.1
	Maturim		-1.9						
	Para-bletje					-1.3	-1.3		-1.1
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	0.1	1.4	2.3	0.9	0.5			
MEMO:									
	Balanca e përqijthshme (deficiti përqijthshëm)	-1.9	-6.7	-4.5	-3.2	-2.6	-2.2	-2.2	-1.7
	Balanca korente	2.6	-0.5	2.3	2.4	3.1	2.9	3.0	3.5
	Balanca primare	0.2	-4.6	-2.6	-1.2	0.3	0.9	1.2	1.8
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	1.0	0.5	3.8	1.3	1.2	1.2	1.1	1.6
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	64.8	74.0	69.3	67.5	66.3	65.2	64.2	62.6
	Borxhi publik BRUTO (stok)	65.8	74.5	73.2	68.8	67.5	66.3	65.3	64.2
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	63.3	71.5	70.3	65.4	64.1	63.3	62.4	61.5
	I brendshëm (stok)	34.4	38.4	35.9	34.2	33	33.6	33.2	32.6
	I huaj (stok)	28.8	33.1	34.3	31.2	30.6	29.7	29.2	28.9
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	2.5	3.0	2.9	3.4	3.4	3.0	2.9	2.7
	Pushteti vendor (stok)								
	Borxhi publik i garantuar (stok)	2.5	3.0	2.9	3.3	3.3	3.0	2.9	2.6
	Stoku i detyrimeve të papaqura (stok)								
	Shlyerje e stokut të detyrimeve direkt nga buxheti (fluks)								
	Shlyerje e stokut të detyrimeve nepermjet netting-off (fluks)								
	PBB nominal	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë



VENDIM
Nr. 34, datë 27.1.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (PËRFITUESI) DHE
AGJENCISË FRANCEZE PËR ZHVILLIM
(AGJENCIA), PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË I
QYTETIT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (përfituesi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (Agjencia), për financimin e projektit “Furnizimi me ujë i qytetit të Durrësit” me një grant, në shumën 1 000 000 (një milion) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE AFD N° CAL 1012 02 Z
MARRËVESHJE FINANCIMI
e datës 15 nëntor 2022
ndërmjet Agence Française de
Developpement (Agjencia) dhe Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë
(Përfituesi)

Tabela e lëndës

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI
 - 1.1 Përkufizimet
 - 1.2 Interpretimi
2. SHUMA, QËLLIMI DHE KUSHTET E PËRDORIMIT
 - 2.1 Granti
 - 2.2 Qëllimi

- 2.3 Mungesa e përgjegjësisë
- 2.4 Kushtet pararendëse
3. TËRHEQJA E FONDEVE
 - 3.1 Kërkesa për tërheqjen e Fondit
 - 3.2 Mekanizmi i pagesës
 - 3.3 Afati për tërheqjen e Fondit
4. SHTYRJA OSE PUSHIMI I KËRKE-SAVE PËR TËRHEQJEN E FONDIT
5. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË
 - 5.1 Kompetenca dhe autoriteti
 - 5.2 Detyrimet e detyrueshme
 - 5.3 Mosqenia në konflikt me detyrimet e tjera
 - 5.4 Vlefshmëria dhe pranueshmëria në dëshmitë
 - 5.5 Autorizimet e Projektit
 - 5.6 Prokurimet
 - 5.7 Origjina e fondeve, aktet e korrupsionit, mashtrimi dhe praktikant antikonkurrese
6. SIPËRMARRJET
 - 6.1 Autorizimet
 - 6.2 Dokumentet e Projektit
 - 6.3 Pajtuueshmëria me ligjet dhe rregulloret
 - 6.4 Prokurimet
 - 6.5 Financimet shtesë
 - 6.6 Delegimi
 - 6.7 Zbatimi i Projektit
 - 6.8 Origjina e fondeve, moskryerja e akteve të korrupsionit, mashtrimi ose praktikant antikonkurrese
- 6.9 Përgjegjësia mjedisore dhe sociale
- 6.10 Ruajtja e Projektit
- 6.11 Inspektimet
- 6.12 Vlerësimi i Projektit
7. SIPËRMARRJET E INFORMACIONIT
 - 7.1 Progres raporti
 - 7.2 Informacioni – të ndryshme
 - 7.3 Informacioni financiar dhe statusor
8. KOSTOT DHE SHPENZIMET – REGJISTRIMI
9. TË NDRYSHME
 - 9.1 Gjuha
 - 9.2 Pavlefshmëria e pjesshme
 - 9.3 Mosheqja dorë
 - 9.4 Delegimi
 - 9.5 Efekti ligjor
 - 9.6 Marrëveshja e plotë
 - 9.7 Amendimet
 - 9.8 Konfidencialiteti – zbulimi i informacionit
 - 9.8 Parashkrimi
10. NJOFTIMET



10.1 Me shkrim

10.2 Efektiviteti

10.3 Komunikimet elektronike

11. HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA, PËRFUNDIMI

11.1 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

11.2 Përfundimi

12. LIGJI RREGULLUES, ZBATIMI DHE NJOFTIMI I PROCESIT

12.1 Ligji rregullues

12.2 Juridiksioni

12.3 Zgjedhja e vendbanimit

SKEDULI 1A – Përkufizimet

SKEDULI 1B – Interpretimi

SKEDULI 2 – Përshkrimi i Projektit

SKEDULI 3 – Plani i financimit

SKEDULI 4 – Kushtet pararendëse

SKEDULI 5 – Informacioni që agjencia autorizohet shprehimisht të zbulojë në faqen e internetit të Agjencisë (në veçanti në platformën e tij të hapur të të dhënave)

SKEDULI 6 – Plani i veprimit mjedisor dhe social

SKEDULI 7 – Forma e raportit të ndjekjes së indikatorëve të projektit

SKEDULI 8 - Njoftimi për informacionin e transaksionit

SKEDULI 9 – Lista joshteruese e dokumenteve mjedisore dhe sociale që përfituesi lejon të zbulohen në lidhje me procedurën e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave

MARRËVESHJE FINANCIMI

NDËRMJET

1. KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

të përfaqësuar nga znj. Delina IBRAHIMAJ, në cilësinë e saj si Ministre e Financave dhe Ekonomisë, e cila është autorizuar sipas rregullave për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje

(“Përfituesi”);

DHE

2. AGENCE FRANCAISE DE DEVELOPPEMENT, një ent publik francez i rregulluar nga legjislacioni francez, me zyrë të regjistruar në adresën: 5, Rue Roland Barthes, 75598 Paris Cedex 12, France, i regjistruar në Regjistrin Tregtar dhe Shoqërive Tregtare të Parisit me numrin 775 665 599, i përfaqësuar nga znj. Cécile COUPRIE, në cilësinë e saj si drejtor

rajonal për Euroazinë, e autorizuar sipas rregullave për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, (“Agjencia”);

(në vijim të referuar bashkërisht si “Palët” dhe secila një “Palë”);

DUKE PASUR PARASYSH SE:

A) Përfituesi synon të përmirësojë shërbimin e furnizimit me ujë në rajonin e Durrësit (“Projekt”), siç përshkruhet më tej në skedulin 2 (*Përshkrimi i Projektit*).

B) Përfituesi ka kërkuar që Agjencia të vendosë në dispozicion një Grant për qëllimet e financimit të Projektit pjesërisht;

C) Sipas rezolutës N° C20200793 të Bordit të Drejtorëve, të datës 5 nëntor 2020, Agjencia ka rënë dakord të vendosë në dispozicion Grantin për Përfituesin, sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje;

PALET KANË RËNË DAKORD si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje (përfshirë ato që paraqiten në pikat e mësipërme dhe në skedule) kanë kuptimin që u jepet në skedulin 1 A (*Përkufizimet*), përveç kur përcaktohen ndryshe në këtë Marrëveshje.

1.2 Interpretimi

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje interpretohen në përputhje me dispozitat e skedulit 1 B (*Interpretimi*), nëse nuk shfaqet një synim i kundërt.

2. GRANTI, QËLLIMI DHE KUSHTET E PËRDORIMIT

2.1 Granti

Në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Agjencia i vë në dispozicion Përfituesit një Grant në shumën totale maksimale prej një milion euro (1,000,000 EURO).

2.2 Qëllimi

Përfituesi do të aplikojë të gjitha shumat që i janë vënë në dispozicion ekskluzivisht në kuadër të këtij Granti drejt financimit të shpenzimeve të pranueshme, pa përfshirë taksat, detyrimet dhe çdo të drejtë tjetër në përputhje me përshkrimin e Projektit, siç përcaktohet në skedulin 2 (*Përshkrimi i Projektit*) dhe Planin e Financimit të përcaktuar në skedulin 3 (*Plani i financimit*).



2.3 Mungesa e përgjegjësisë

Agjencia nuk mban përgjegjësi për përdorimin e ndonjë shume të vënë në dispozicion të Përfituesit, e cila nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2.4. Kushtet pararendëse

a) Jo më vonë se data e nënshkrimit, Përfituesi do t'i japë Agjencisë të gjitha dokumentet e përcaktuara në pjesën I të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*).

b) Përfituesi ka të drejtë t'i dorëzojë Agjencisë një kërkesë për tërheqje fondi, nëse:

i. në rastin e tërheqjes së parë të Fondit, Agjencia ka marrë të gjitha dokumentet e listuara në pjesën II dhe/ose III të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*) dhe ka njoftuar Përfituesin se dokumente të tilla janë të pranueshme në formë dhe përmbajtje;

ii. në rastin e ndonjë tërheqje të mëtejshme të Fondit, Agjencia ka marrë të gjitha dokumentet e përcaktuara në pjesën III të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*) dhe ka njoftuar Përfituesin se këto dokumente janë të pranueshme në formë dhe përmbajtje; dhe

iii. në datën e kërkesës për tërheqje fondi dhe në datën e propozuar të tërheqjes së fondit për tërheqjen përkatëse të fondit, kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje janë përmbushur, duke përfshirë:

1. Kërkesa për tërheqjen e fondit është paraqitur në përputhje me kushtet e klauzolës 3;

2. asnjë rast i përmendur në klauzolën 4 (*Shtyrja ose pushimi i kërkesave për tërheqje fondi*) nuk vijon ose mund të ndodhë;

3. çdo përfaqësim i dhënë nga Përfituesi në lidhje me klauzolën 5 (*Përfaqësimet dhe garancitë*) është i vërtetë;

3. TËRHEQJA E FONDEVE

3.1 Kërkesa për tërheqjen e fondit

Me kusht që kushtet e përcaktuara në klauzolën 2.4 (*Kushtet pararendëse*) të përmbushen, Përfituesi mund të tërheqë fondet nga Granti, në një ose disa tërheqje fondesh, duke i dorëzuar Agjencisë një kërkesë për tërheqje fondi, të plotësuar siç duhet.

Çdo kërkesë për tërheqje fondi do të dorëzohet nga Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM te Përgjegjësi i zyrës së Agjencisë në adresën e specifikuar në pikën 10 (*Njoftimet*).

Kërkesa për tërheqje fondi nuk do të konsiderohet e plotësuar sipas rregullave nëse të gjitha dokumentet e kërkuara nuk i bashkëngjiten kërkesës për tërheqje fondi dhe nuk janë në përputhje me dispozitat e klauzolës 3.2 (*Mekanizmi i pagesës*).

Nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Agjencia do t'ia transferojë përfituesit tërheqjen e kërkuar të Fondit.

3.2 Mekanizmi i pagesës

Fondet do të vihen në dispozicion në përputhje me afatet dhe kushtet e mëposhtme:

3.2.1 Pagesat direkte nga Agjencia për Kontraktuesit në lidhje me komponentin 5

a) Përfituesi mund të kërkojë që të ardhurat e një tërheqje fondi t'i vihen në dispozicion drejtpërdrejt kontraktuesve për pagesën e shpenzimeve të pranueshme të kërkueshme sipas një kontrate prokurimi për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe/ose punëve të tjera të kryera për qëllimet e zbatimit të Projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM do t'i dorëzojë Agjencisë çdo udhëzim të nevojshëm për të paguar tërheqjen e fondit drejtpërdrejt te kontraktuesi palë e tretë dhe dokumentet e listuara në pjesën II dhe/ose pjesën III, sipas rastit, të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*):

b) Përfituesi autorizon Agjencinë, me kërkesën e saj, të bëjë pagesa direkt në përputhje me paragrafin e mësipërm (a) nga fondet e një tërheqje fondi. Agjencia nuk do të jetë e detyruar, në çdo kohë, të verifikojë nëse ekziston një kufizim të çfarëdo natyre në lidhje me tërheqjen e kërkuar të fondit. Agjencia rezervon të drejtën të refuzojë një kërkesë të tillë, nëse merr dijeni për ndonjë kufizim të tillë.

Agjencia nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse ndaj Përfituesit, çfarëdo qoftë, në lidhje me këto tërheqje fondesh dhe Përfituesi heq dorë nga çdo veprim që mund të ketë kundër Agjencisë në këtë drejtim. Përfituesi do të dëmshpërblejë Agjencinë për çdo kosto, humbje ose përgjegjësi që i lind Agjencisë në lidhje me veprimet e palës së tretë ndaj Agjencisë në lidhje me një autorizim të tillë.

3.2.2 Vendi i pagesës

Çdo fond që do të transferohet nga Agjencia te Përfituesi me anë të Grantit do të paguhet në çdo llogari bankare në Francë, që është caktuar



në mënyrë specifike për këtë qëllim nga Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM.

Si përjashtim nga sa më sipër dhe me kusht që Agjencia të ketë dhënë pëlqimin e saj paraprak, fondet që do t'i transferohen Përfituesit mund të paguhen në një llogari bankare në vendin e Përfituesit ose në çdo vend tjetër të rënë dakord më parë me Agjencinë.

Fondet do t'i paguhen çdo institucioni financiar të atij vendi dhe, në bazë të kërkesës së Përfituesit, në euro në një llogari bankare të shprehur në euro.

3.3 Afati për tërheqjen e fondit

Kërkesa përfundimtare për tërheqjen e fondit do të merret nga Agjencia jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike para afatit për tërheqjen e fondit. Nëse një kërkesë e tillë është bërë gjatë muajit që i paraprin afatit për tërheqjen e fondit, ajo do t'i drejtohet Agjencisë dhe do t'i dërgohet me postë rekomande, duke kërkuar një vërtetim të pranimit.

Çdo pjesë e Grantit që mbetet e papaguar në këtë afat për tërheqje fondi do të anulohet automatikisht.

4. SHTYRJA OSE PUSHIMI I KËRKE-SAVE PËR TËRHEQJE FONDI

Agjencia ka të drejtë të pezullojë ose shtyjë, ose të pushojë përfundimisht çdo kërkesë për tërheqje fondi, në rast të ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) Dokumentet e Projektit

Çdo dokument Projekti, ose çdo e drejtë ose detyrim i përcaktuar në të, pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë ose i nënshtrohet një njoftimi për përfundimin ose vlefshmëria, ligjshmëria ose zbatueshmëria e tij kundërshtohet.

b) Keqpërfaqësimi

Një përfaqësim i bërë ose garanci e dhënë nga Përfituesi në këtë Marrëveshje, duke përfshirë sipas klauzolës 5 (*Përfaqësimet dhe garancitë*), ose në çdo dokument të dorëzuar nga ose në emër të Përfituesit sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, është i pasaktë ose çorientues kur bëhet ose jepet, ose konsiderohet të jetë bërë ose dhënë.

c) Sipërmarrjet dhe detyrimet

Përfituesi nuk respekton asnjë kusht të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, pa kufizim, asnjë nga angazhimet që ka dhënë në përpunje me

klauzolën 6 (*Sipërmarrjet*) dhe klauzolën 7 (*Sipërmarrjet e informacionit*).

d) Paligjshmëria

Është ose bëhet e paligjshme që Përfituesi të kryejë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Bëhet e paligjshme për Agjencinë, në përpunje me legjislacionin e saj në fuqi, të kryejë ndonjë nga detyrimet e saj, siç parashikohet nga kjo Marrëveshje ose të financojë ose mbajë Grantin.

e) Ndryshimi material negativ

Ndodh ose ka të ngjarë të ndodhë ndonjë rast (duke përfshirë një ndryshim në situatën politike të vendit të Përfituesit) ose ndonjë masë që, sipas mendimit të Agjencisë, ka një efekt material negativ.

f) Tërheqja ose pezullimi i Projektit

Ndodh ndonjë nga sa vijon:

- zbatimi i Projektit pezullohet ose shtyhet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj; ose
- Projekti nuk është përfunduar plotësisht deri në datën e përfundimit teknik; ose
- Përfituesi tërhiqet nga, ose pushon së marri pjesë në Projekt.

g) Autorizimet

Çdo autorizim i kërkuar për Përfituesin, në mënyrë që të përmbushë ose zbatojë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose detyrimet e tij të tjera materiale sipas ndonjë dokumenti të Projektit ose që kërkohet në ecurinë e zakonshme të Projektit nuk merret brenda afatit kohor të kërkuar ose anulohet ose bëhet i pavlefshëm ose përndryshe pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë.

h) Pezullimi i transferimit falas

Transferimi falas i shumave të marra në lidhje me Grantin nga Përfituesi, ose çdo fond tjetër i dhënë nga Agjencia për Përfituesin ose çdo përfitues të juridiksionit të Projektit, kundërshtohet.

i) Mospërmbushja e detyrimeve nga Përfituesi në lidhje me një marrëveshje të shumës së kredisë.

Përfituesi nuk përmbush detyrimin në lidhje me marrëveshjen e shumës së kredisë të lidhur me Agjencinë.

5. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë klauzolë 5 (*Përfaqësimet dhe*



garancitë) janë bërë nga Përfituesi në interes të Agjencisë në datën e nënshkrimit. Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë në këtë klauzolë 5 (*Përfaqësimet dhe garancitë*) konsiderohen të jenë bërë nga Përfituesi në secilën datë të tërheqjes së fondit.

5.1 Kompetenca dhe autoriteti

Përfituesi ka kompetencën të lidhë këtë Marrëveshje dhe të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara. Përfituesi ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar lidhjen e kësaj Marrëveshjeje.

5.2 Detyrimet detyruese

Detyrimet e shprehura për t'u marrë përsipër nga Përfituesi sipas kësaj Marrëveshjeje pajtohen me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për Përfituesin në juridiksionin e tij të themelimit dhe janë detyrime ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme, të cilat janë në fuqi në përputhje me kushtet e tyre me shkrim.

5.3 Mosqenia në konflikt me detyrimet e tjera

Lidhja dhe përmbushja nga Përfituesi, dhe detyrimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje nuk bien ndesh me ndonjë ligj apo rregullore të brendshme ose të huaj të zbatueshme, ose ndonjë marrëveshje ose instrument detyrues për Përfituesin ose që prek ndonjë prej aseteve të tij.

5.4 Vlefshmëria dhe pranueshmëria në prova

Të gjitha autorizimet e kërkuara për ta bërë këtë Marrëveshje të pranueshme si prova në gjykatat e juridiksionit të Përfituesit ose në procedurat e arbitrazhit, janë marrë në datën e hyrjes në fuqi dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe nuk ekzistojnë rrethana që mund të rezultojnë në revokimin, mosrinovimin ose modifikimin, tërësisht ose pjesërisht, të ndonjë Autorizimi të tillë.

5.5 Autorizimet e Projektit

Përfituesi, nëpërmjet MIE/AKUM-së, do të marrë të gjitha autorizimet e projektit dhe sigurojë dhe ruajë ato në fuqi dhe efekt të plotë për zbatimin e duhur të Projektit.

5.6 Prokurimi

Përfituesi: i) ka marrë një kopje të udhëzimeve të prokurimit; dhe ii) kupton kushtet e udhëzimeve të prokurimit, në veçanti, ato kushte që lidhen me çdo veprim të cilat Agjencia mund të marrë në rast të shkeljes së udhëzimeve të prokurimit nga Përfituesi.

Përfituesi, nëpërmjet MIE/AKUM-së, është i

lidhur kontraktualisht nga udhëzimet e prokurimit, sikur udhëzime të tilla të prokurimit të ishin përfshirë duke iu referuar kësaj Marrëveshjeje.

5.7 Origjina e fondeve, aktet e korrupsionit, mashtrimi dhe praktikant antikorrupsive

Përfituesi përfaqëson dhe garanton se:

i. të gjitha fondet e investuara në Projekt janë nga të ardhurat e shumës dhe Granti i disponuar nga AFD-ja, siç përcaktohet në planin e financimit.

ii. Projekti (në veçanti, negocimi, dhënia dhe ekzekutimi i çdo kontrate të financuar nga Granti) nuk ka shkaktuar asnjë akt korrupsioni, mashtrimi ose praktike kundër konkurrencës. Ky përfaqësim zbatohet nga data e hyrjes në fuqi.

6. SIPËRMARRJET/ANGAZHIMET

Sipërmarrjet/angazhimet në këtë klauzolë 6 (*Sipërmarrjet/angazhimet*) do të hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

6.1 Autorizimet

Përfituesi do të sigurojë menjëherë, do të respektojë dhe do të bëjë gjithçka që është e nevojshme për të ruajtur në fuqi dhe efekt të plotë çdo autorizim të kërkuar në bazë të ndonjë ligji ose rregulloreje në fuqi, për t'i mundësuar atij të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të garantojë ligjshmërinë, vlefshmërinë, zbatueshmërinë dhe pranueshmërinë në prova të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë dokumenti të Projektit.

6.2 Dokumentet e Projektit

Përfituesi do t'i sigurojë Agjencisë një kopje të çdo ndryshimi të ndonjë dokumenti të Projektit dhe nuk do të dhe nuk do të pranojë të bëjë ndonjë ndryshim material në ndonjë dokument Projekti pa marrë paraprakisht pëlqimin e Agjencisë.

6.3 Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

Përfituesi zbaton:

a) në të gjitha aspektet me të gjitha ligjet dhe rregulloret të cilave i nënshtrohet ai dhe/ose Projekti, veçanërisht në lidhje me publikimin e informacionit që nxit transparencën tatimore, si dhe të gjitha ligjet e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit, të sigurisë dhe të punës, duke përfshirë konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës ("ONP") dhe konventat ndërkombëtare



mjedisore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi të vendit përkatës;

b) me të gjitha detyrimet e tij sipas dokumenteve të Projektit.

6.4 Prokurimi

Në lidhje me prokurimin, dhënien dhe zbatimin e kontratave të lidhura në lidhje me zbatimin Projektit, Përfituesi nëpërmjet MIE/ AKUM do të respektojë dhe zbatojë dispozitat e udhëzimeve të prokurimit.

Përfituesi, nëpërmjet MIE/ AKUM-së, do të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm për zbatimin efektiv të udhëzimeve të prokurimit.

6.5 Financimi shtesë

Përfituesi nuk do të amendojë ose ndryshojë planin e financimit pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të Agjencisë dhe do të marrë të gjitha masat për të marrë ndonjë kosto shtesë që nuk parashikohet në planin e financimit pjesë e skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

6.6 Delegimi

Në rast se Agjencia bie dakord ndryshe me shkrim, Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM do t'i caktojë Agjencisë përfitimin e garancive të Kontraktuesit. Palët duhet të lidhin një marrëveshje në kohën e duhur për rivendosjen e fondeve në Projekt.

6.7 Zbatimi i Projektit

Përfituesi, nëpërmjet MIE/AKUM-së:

i. do të sigurojë që personat, grupet ose subjektet që marrin pjesë në zbatimin e Projektit nuk listohen në asnjë listë të sanksioneve financiare (duke përfshirë ato që lidhen me luftën kundër financimit të terrorizmit);

ii. nuk do të blejë, furnizojë, financojë asnjë furnizim, shërbim ose sektor që i nënshtrohet një embargoje nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Franca.

6.8 Origjina e fondeve, moskryerja e akteve të korrupsionit, mashtrimi ose praktikant antikonkurrese

Përfituesi ndërmerr:

i. të sigurojë që fondet, përveç atyre me origjinë Shtetërore, të investuara në Projekt nuk do të jenë me origjinë të paligjshme;

ii. të sigurojë, nëpërmjet MIE/AKUM sipas rastit, që Projekti (veçanërisht gjatë negociatave, hyrja në dhe përmbushja e kontratave të

financuara nga Granti) nuk do të shkaktojë ndonjë akt korrupsioni, mashtrim ose praktikë antikonkurrese;

iii. të njoftojë Agjencinë nëpërmjet MIE/AKUM pa vonesë, sapo të vihet në dijeni ose të dyshojë për ndonjë akt korrupsioni, mashtrim ose praktikë antikonkurrese.

iv. të marrë të gjitha masat e nevojshme për të korrigjuar situatën në një mënyrë të pranueshme për Agjencinë dhe brenda periudhës kohore të përcaktuar nga Agjencia, në rastin e paragrafit “iii”; ose me kërkesë të Agjencisë nëse Agjencia dyshon se kanë ndodhur aktet ose praktikant e specifikuar në paragrafin “iii”; dhe

v. të njoftojë Agjencinë pa vonesë nëse ka informacione që çojnë në dyshimin për origjinën e paligjshme të fondeve të investuara në Projekt.

6.9 Përgjegjësia mjedisore dhe sociale

6.9.1 Zbatimi i masave mjedisore dhe sociale

Për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, Palët bien dakord se është e nevojshme të sigurohet pajtueshmëria me standardet mjedisore dhe të punës të njohura në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (“ONP”) dhe traktatet ndërkombëtare mjedisore.

Për këtë qëllim, Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM në kuadër të Projektit:

a) do të përfshijë në dokumentacionin e ofertës konkurrese dhe kontratat e prokurimit një klauzolë me anë të së cilës çdo Kontraktues merr përsipër dhe siguron që nënkontraktuesit e tij (nëse ka) marrin përsipër të zbatojnë standardet e tilla ndërkombëtare, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të vendit në të cilin Projekti është duke u zbatuar. Agjencia rezervon të drejtën të kërkojë që Përfituesi nëpërmjet MIE/ AKUM të sigurojë një raport mbi kushtet mjedisore dhe sociale të zbatimit të Projektit;

b) do të vendosë në funksion masat e duhura zbutëse specifike për Projektin, siç përcaktohet në kuadër të politikës së menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social të Projektit, të përcaktuar në Planin e Angazhimit Mjedisor dhe Social (ESCP), bashkëlidhur si skeduli 6 (*Plani i veprimit mjedisor dhe social*);

c) do të kërkojë që kontraktuesit e caktuar për zbatimin e Projektit, të zbatojnë masat zbutëse të përcaktuara në paragrafin (b) më sipër dhe të



sigurojnë që nënkontraktuesit e tyre (nëse ka) të respektojnë të gjitha masat e tilla dhe të marrin të gjitha hapat e duhur në rast të dështimit për të qenë në përputhje me masa të tilla zbutëse; dhe

d) do t'i sigurojë Agjencisë raportet vjetorë të ndjekjes, në lidhje me zbatimin e ESCP-së.

6.9.2 Menaxhimi i ankesave mjedisore dhe sociale (E&S).

a) Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM: i) konfirmon se ai ka marrë një kopje të procedurës së punës të mekanizmit të menaxhimit të ankesave E&S dhe ka pranuar kushtet e tij, veçanërisht në lidhje me veprimet që mund të ndërmerren nga Agjencia në rast se një palë e tretë paraqet ankesë, dhe ii) pranon që procedura e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave E&S sjell, si midis Përfituesit dhe Agjencisë, të njëjtin efekt detyrues kontraktues si kjo Marrëveshje.

b) Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM autorizon shprehimisht Agjencinë që t'u zbulojë ekspertëve (siç përcaktohet në procedurën e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave E&S) dhe palëve të përfshira në proceset e rishikimit të pajtueshmërisë dhe/ose zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dokumentet e Projektit në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale, të nevojshme për përpunimin e ankesave mjedisore dhe sociale, duke përfshirë, pa kufizim, ato të listuar në skedulin 9 (*Lista joshtertuese e dokumenteve mjedisore dhe sociale që Përfituesi lejon të zbulohen në lidhje me procedurën e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave E&S*).

6.10 Ruajtja e Projektit

Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM:

a) do të zbatojë dhe mirëmbajë Projektin në përputhje me parimet e pranuar përgjithësisht të kujdesit dhe praktikës tregtare dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi;

b) do të mbajë të gjitha asetet e Projektit në gjendje dhe kushte të mira pune, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe t'i përdorë ato asete për qëllimin e tyre të duhur dhe në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi;

6.11 Inspektimet

Përfituesi do të lejojë Agjencinë dhe përfaqësuesit e saj të kryejnë inspektime në lidhje me zbatimin dhe aktivitetet, aspektet financiare të përfshira, të Projektit, ndikimin e tij dhe arritjen e objektivave të Projektit.

Përfituesi do të bashkëpunojë nëpërmjet MIE/ AKUM me Agjencinë dhe përfaqësuesit e saj gjatë kryerjes së këtyre inspektimeve, koha dhe formati i të cilave, në çdo rast, do të përcaktohen nga Agjencia pas konsultimit me Përfituesin.

Përfituesi do të ruajë dhe vendosë në dispozicion për inspektim nga Agjencia, të gjitha dokumentet në lidhje me Projektin për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) pas afatit për tërheqjen e fondit.

6.12 Vlerësimi i Projektit

Përfituesi pranon që Agjencia mund të kryejë, ose të sigurojë që një palë e tretë të kryejë në emër të tij, një vlerësim të Projektit. Rezultati nga ky vlerësim do të përdoret për të përgatitur një përmbledhje që përmban informacion mbi Projektin, të tilla si: shuma totale dhe kohëzgjatja e financimit, objektivat e Projektit, rezultatet sasiore të pritshme dhe të arritura të Projektit, vlerësimi i rëndësisë, efektiviteti, ndikimi dhe zbatueshmëria/qëndrueshmëria e Projektit, përfundimet kryesore dhe rekomandimet.

Objektivi kryesor i vlerësimit do të jetë artikulli i një gjykimi të besueshëm dhe të pavarur mbi çështjet kryesore të rëndësisë, zbatimit (efektshmërisë) dhe efekteve (efektiviteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria).

Vlerësuesit do të duhet të marrin parasysh në mënyrë të balancuar pikëpamjet e ndryshme legjitime që mund të shprehen dhe të kryejnë vlerësimin në mënyrë të paanshme.

Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM do të përfshihet sa më shumë që të jetë e mundur në vlerësim, që nga hartimi i termave të referencës deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.

7. SIPËRMARRJET E INFORMACIONIT

Sipërmarrjet/angazhimet në këtë klauzolë 7 (*Sipërmarrjet e informacionit*) hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbeten në fuqi dhe efekt të plotë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

7.1 Raporti i Progresit

Përfituesi nëpërmjet MIE/ AKUM do t'i japë Agjencisë:

a) deri në datën e përfundimit teknik, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e fundit e çdo tremujori një raport të progresit teknik dhe financiar në lidhje me zbatimin e Projektit dhe një raport vjetor të ndjekjes të indikatorëve të Projektit, në formën e përcaktuar



në skedulin 7 (Forma e raportit të ndjekjes së indikatorëve të Projektit).

b) brenda 3 (tre) muajve pas datës së përfundimit teknik, një raport të përgjithshëm zbatimi (“Raporti i përgjithshëm i zbatimit”) duke përfshirë një raport të ndjekjes në lidhje me indikatorët e projektit, në formën e përcaktuar në shtojcën 7 (Forma e raportit të ndjekjes të indikatorëve të projektit).

7.2 Informacione të ndryshme

Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM do t'i japë Agjencisë:

a) menjëherë me marrjen në dijeni të tyre, detajet e çdo rasti ose rrethane që është ose mund të jetë një rast që shkakton shtyrjen ose refuzimin e një kërkesë për tërheqje fondi ose që ka ose mund të ketë një efekt material negativ, natyrën e një rasti të tillë dhe të gjitha veprimet e ndërmarra ose që do të ndërmerren për ta korrigjuar atë (nëse ka);

b) menjëherë pasi të vihet në dijeni dhe jo më vonë se 48 orë pas ndodhës së tij, detajet e çdo incidenti apo aksidenti që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e Projektit, i cili mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në vendin e Projektit, sigurinë, kushtet e punës së punonjësve të tij ose çdo kontraktuesi që punon për zbatimin e Projektit, natyrën e një incidenti ose aksidenti të tillë, së bashku me detajet e çdo veprimi të ndërmarrë ose të propozuar për t'u ndërmarrë, sipas rastit, nga Përfituesi nëpërmjet MIE/ AKUM për ta korrigjuar atë;

c) menjëherë, detajet e çdo vendimi ose rasti që mund të ndikojë në organizimin, përfundimin ose funksionimin e Projektit;

d) për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të Projektit, raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare të përgatitura nga çdo ofrues i shërbimit dhe/ose Kontraktues, dhe më pas një raport gjithëpërfshirës të zbatimit;

e) menjëherë, çdo informacion ose dokument të mëtejshëm në lidhje me përdorimin e fondeve dhe kushtet e zbatimit të dokumenteve të Projektit, si dhe kontratat e lidhura për zbatimin e tyre që Agjencia mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme;

f) sa më shpejt të jetë e mundur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së biznesit, t'i sigurojë Agjencisë çdo dokument ose informacion në lidhje me Përfituesin që Agjencia mund të kërkojë, për t'i mundësuar Agjencisë të përmbushë detyrimet e saj njih klientin tënd (“KYC”) sipas rregulloreve

kundër pastrimit të parave dhe kundër terrorizmit, veçanërisht për qëllimin e përditësimit të informacionit të tij KYC për klientin (Përfituesin);

7.3 Informacioni financiar dhe statusor

Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM, ndërmerr:

i. t'i sigurojë Agjencisë dokumentet e saj financiare ose buxhetore vjetore pas miratimit të tyre, si dhe çdo detaj që Agjencia mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me gjendjen e saj financiare;

ii. t'i dërgojë Agjencisë, me kërkesën e saj, raportet vjetore të AKUM-it, kontratën e performancës dhe indikatorët e rëna dakord ndërmjet AKUM-it dhe SHUKD-së; sipas rastit.

8. KOSTOT DHE SHPENZIMET – REGJISTRIMI

Përfituesi do të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet e bëra në lidhje me negocimin, përgatitjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, sipas rastit:

i. tarifat e avokatit;

ii. kostot e regjistrimit, nëse regjistrimi kërkohej nga njëra nga Palët, dhe taksa të tjera të ngjashme të pagueshme në lidhje me këtë Marrëveshje; dhe

iii. kostot dhe shpenzimet në lidhje me transferimin e fondeve nga qendra financiare e Parisit në çdo qendër tjetër financiare të rënë dakord me Agjencinë.

9. TË NDRYSHME

9.1 Gjuha

Gjuha e kësaj marrëveshjeje është gjuha angleze. Nëse kjo marrëveshje përkthehet në një gjuhë tjetër, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi në rast të ndonjë interpretimi konfliktual të termave të kësaj Marrëveshjeje ose në rast të një mosmarrëveshjeje midis Palëve.

Të gjitha komunikimet ose dokumentet e parashikuara në, ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të jenë në gjuhën angleze.

Agjencia mund të kërkojë që çdo komunikim ose dokument i dhënë sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, që nuk është në gjuhën angleze, të shoqërohet me një përkthim të certifikuar në gjuhën angleze, në këtë rast, përkthimi në anglisht do të ketë përparësi, përveç nëse dokumenti është një tekst juridik ose dokument tjetër zyrtar.

9.2 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse, në çdo kohë, një term i kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet i paligjshëm, i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, vlefshmëria,



ligjshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj marrëveshjeje nuk do të ndikohen.

9.3 Mosheqja dorë

Mosushtrimi ose vonesa për të ushtruar nga ana e Agjencisë të ndonjë të drejte nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga kjo e drejtë.

Ushtrimi i pjesshëm i ndonjë të drejte nuk do të pengojë ndonjë ushtrim të mëtejshëm të kësaj të drejte ose ushtrimin e ndonjë të drejte ose mjeti tjetër juridik sipas ligjit në fuqi.

Të drejtat dhe mjetet juridike të Agjencisë sipas kësaj Marrëveshjeje janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese e të drejtave dhe mjeteve juridike sipas ligjit në fuqi.

9.4 Delegimi

Përfituesi nuk mund të delegojë ose transferojë, në asnjë mënyrë, çfarëdo qoftë, të gjitha ose ndonjë nga të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Agjencisë.

9.5 Efekti ligjor

Skedulet e aneksuara në këtë marrëveshje, udhëzimet e prokurimit dhe pikat e tij janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe kanë të njëjtin efekt ligjor si kushtet e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Marrëveshja e plotë

Në datën e nënshkrimit, kjo Marrëveshje përfaqëson të gjithë marrëveshjen midis Palëve, në lidhje me çështjet e përcaktuara këtu dhe tejkalon dhe zëvendëson të gjithë dokumentet, marrëveshjet ose kuptimet e mëparshme, të cilat mund të jenë shkëmbyer ose komunikuar si pjesë e negociatave në lidhje me këtë Marrëveshje.

9.7 Amendimet

Asnjë ndryshim nuk mund të bëhet në këtë Marrëveshje, përveç nëse është rënë dakord shprehimisht me shkrim ndërmjet Palëve.

Përfituesi përfaqëson dhe garanton, se:

i. ministri i Financave dhe Ekonomisë autorizohet të nënshkruajë çdo amendament, që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave; dhe

ii. amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponibilitetit nuk kërkojnë miratimin paraprak nga Këshilli i Ministrave.

9.8 Konfidencialiteti – zbulimi i informacionit

a) Përfituesi nuk do ta zbulojë përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje te ndonjë palë e tretë pa pëlqimin paraprak të Agjencisë, përveç te ndonjë person, ndaj të cilit Përfituesi ka detyrimin e

zbulimit, sipas ndonjë ligji, rregulloreje apo vendimi gjyqësor në fuqi. Përfituesi mund të publikojë këtë Marrëveshje në gazetë zyrtare nëse kërkohet nga legjislacioni dhe aktet ligjore në fuqi për efektshmërinë e Marrëveshjes.

b) Pavarësisht nga ndonjë marrëveshje ekzistuese e konfidencialitetit, Agjencia mund të zbulojë çdo informacion ose dokument në lidhje me Projektin tek: i) auditorët, ekspertët, agjencitë e klasifikimit, këshilltarët ligjorë ose organet mbikëqyrëse; ii) çdo person ose ent për qëllimin e marrjes së masave mbrojtëse ose ruajtjen e të drejtave të Agjencisë sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) Gjithashtu, Përfituesi autorizon shprehimisht Agjencinë të komunikojë dhe zbulojë në faqen e internetit të Agjencisë informacion në lidhje me Projektin dhe financimin e tij, siç janë listuar në skedulin 5 (*Informacioni që Agjencia është e autorizuar shprehimisht të zbulojë në faqen e internetit të Agjencisë (në veçanti në platformën e saj të hapur të të dhënave).*

9.9 Parashkrimi

Afati i parashkrimit në lidhje me këtë Marrëveshje është 10 (dhjetë) vjet.

10. NJOFTIMET

10.1 Me shkrim

Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që duhet të jepet ose bëhet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të jepet ose bëhet me shkrim dhe, përveç nëse përcaktohet ndryshe, mund të jepet me postë elektronike ose zyrë postare në adresën dhe numrin e Palës përkatëse, të përcaktuar më poshtë:

Për Përfituesin:

MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË

Adresa: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Telefoni: 00 35 54 22 84 05

Faksi: sekretariamin@financa.gov.al

Në vëmendje të: ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Për Agjencinë:

AFD – PARIS ZYRA QENDRORE

Adresa: 5, rue Roland Barthes – 75598 Paris Cedex 12, France

Telefon: + 33 1 53 44 31 31

Në vëmendje të: drejtor i DEPARTAMENTIT ORIENTS

ose në ndonjë adresë, postë elektronike, departament ose zyrtar tjetër, që Palët i njoftojnë njëra tjetrës.



Kopje për:

AFD – ZYRA RAJONALE E BALLKANIT
PERËNDIMOR

Adresa: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Telefoni: Twin Tours, Tour 2, 7th Floor

Faksi: +381 11 78 58 830

Në vëmendje të: afdbalkans@afd.fr

Në vëmendje të: Dominique
HAUTBERGUE, drejtor i Zyrës Rajonale për
Ballkanin Perëndimor.

10.2 Efektshmëria

Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim që bëhet
ose çfarëdo dokumenti që Palët i dërgojnë njëra
tjetrës në lidhje me këtë Marrëveshje do të jetë
efektive vetëm, nëse:

i. kur dërgohet me faks, merret në një formë
të pranueshme; dhe

ii. kur dërgohet me letër nëpërmjet zyrës
postare, dorëzohet në adresën e saktë,

dhe, kur një person ose një departament i
caktuar specifikohet, nëse një njoftim, kërkesë
ose komunikim i tillë i është drejtuar atij personi
ose departamenti.

10.3 Komunikimet elektronike

a) Çdo komunikim, që një person i dërgon një
personi tjetër sipas ose në lidhje me këtë
Marrëveshje, mund të bëhet me postë
elektronike ose mjete të tjera elektronike, nëse
Palët:

i. bien dakord që, përveç nëse dhe derisa të
njoftohet për të kundërtën, kjo do të jetë një formë
e pranuar e komunikimit;

ii. njoftojnë njëra-tjetrin me shkrim për adresën
e tyre të postës elektronike dhe/ose çdo
informacion tjetër që kërkohet për të mundësuar
dërgimin dhe pranimin e informacionit me atë
mjet; dhe

iii. njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të
adresës së tyre ose ndonjë informacion tjetër që
Palët japin.

b) Çdo komunikim elektronik ndërmjet Palëve
do të jetë efektiv vetëm kur merret në një formë të
lexueshme.

11. HYRJA, KOHËZGJATJA, PËRFUNDIMI

11.1 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e hyrjes
në fuqi dhe do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë
deri në datën e skadimit të një periudhe dyvjeçare
(2-vjeçare), duke filluar nga data e Raportit të

Përgjithshëm të Zbatimit të përcaktuar në
klauzolën 7.1 (b) dhe për 5 (pesë) vjet nga data e
nënshkrimit.

Pavarësisht sa më sipër, kërkesat e klauzolës
6.11 (*Inspektimet*) dhe klauzolës 9.8 (*Konfidencialiteti –
Zbulimi i informacionit*) do të mbeten në fuqi dhe
efekt të plotë për 5 (pesë) vjet pas datës së
përmendur në paragrafin e mësipërm; dispozitat e
klauzolës 6.9.2 (*Menaxhimi i ankesave mjedisore dhe
sociale* (E&S)) do të vazhdojnë të kenë efekt ndërsa
çdo ankesë e paraqitur në kuadër të procedurës së
punës të mekanizmit të menaxhimit të ankesave të
E&S është akoma në përpunim apo monitorim.

11.2 Përfundimi para kohe

Agjencia rezervon të drejtën për të përfunduar
këtë Marrëveshje nëse tërheqja e parë e fondit nuk
është tërhequr brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve
nga data e nënshkrimit të Grantit të përmendur në
paragrafin “C” të pikave.

Agjencia gjithashtu rezervon të drejtën të
përfundojë këtë Marrëveshje me ndodhinë e një
prej rasteve të përmendura në klauzolën 4 (*Shtyrja
ose pushimi i kërkesave për tërheqje fondi*).

Agjencia do të informojë Përfituesin për këtë
përfundim para kohe me postë rekomande. Me
kërkesë të Agjencisë, dhe për shkak të ndodhisë së
ndonjë prej këtyre rasteve, Përfituesi do të shlyejë
fondet e Grantit, tërësisht ose pjesërisht.

12. LIGJI RREGULLUES, ZBATIMI DHE NJOFTIMI I PROCESIT

12.1 Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji francez

12.2 Juridiksioni

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje
me këtë Marrëveshje do të zgjidhet nga gjykatat e
Parisit.

12.3 Zgjedhja e vendbanimit

Pa cenuar asnjë ligj të zbatueshëm, për qëllime
të dorëzimit të dokumenteve gjyqësore dhe
jashtëgjyqësore në lidhje me çdo veprim ose
procedurë të përmendur më lart, Përfituesi zgjedh
në mënyrë të parevokueshme zyrën e tij të
regjistruar që nga data e kësaj Marrëveshjeje, në
adresën e përcaktuar në klauzolën 10 (*Njoftimet*) si
vendbanimin e tij dhe Agjencia zgjedh adresën
“Zyra Qendrore e AFD-së” të përcaktuar në
klauzolën 10 (*Njoftimet*) si vendbanimin e saj.

Ekzekutuar në 2 (dy) origjinale, 1 (një) për
Agjencinë dhe 1 (një) për Përfituesin, në Tiranë
(Republika e Shqipërisë), më 15 nëntor 2022.



PËRFITUESI
KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

/ nënshkrimi/

Përfaqësuar nga:

Emri: Shkëlqesia e Saj, znj. Delina Ibrahimaj
Funksioni: ministre e Financave dhe Ekonomisë

AGJENCIA
AGENCE FRANÇAISE DE
DÉVELOPPEMENT

/ nënshkrimi/

Përfaqësuar nga:

Emri: Znj. Cécile COUPRIE
Funksioni: drejtore rajonale për Euroazinë
Bashkënenëshkruese, Shkëlqesia e Saj, znj.
Laurence BOONE, ministre e Shtetit për Evropën,
Republika Franceze
/ nënshkrimi/

Skeduli 1A. Përkufizimet

Akti i korrupsionit	Nënkupton ndonjë nga sa më poshtë vijon: a) akti i premtimit, ofrimit ose dhënies, drejtpërdrejt ose jodrejtpërsëdrejt, te një zyrtar publik ose cilitdo personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, për një ent të sektorit privat, një avantazh të padrejtë të çdo natyre, për vetë personin përkatës ose për një person ose ent tjetër, në mënyrë që ky person të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në kundërshtim me detyrimet e tij ligjore, kontraktuale ose profesionale dhe, duke pasur efekt të ndikojë në veprimet e tij ose të saj ose të një personi ose enti tjetër; ose b) akti i një zyrtari publik ose i ndonjë personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, për një ent të sektorit privat, duke kërkuar ose pranuar, direkt ose indirekt, një avantazh të padrejtë të çdo natyre, për vetë personin përkatës ose për një person ose ent tjetër, në mënyrë që ky person të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në kundërshtim me detyrimet e tij ligjore, kontraktuale ose profesionale dhe, duke pasur efekt të ndikojë në veprimet e tij ose të saj ose të një personi ose enti tjetër.
Marrëveshje	Nënkupton këtë marrëveshje financimi, duke përfshirë pikat e saj, klauzolat, skedulet, udhëzimet e prokurimit dhe, nëse është e zbatueshme, çdo ndryshim të bërë me shkrim në marrëveshje.
Praktikat antikonkurruese	Nënkupton: a) çdo veprim të bashkërenduar ose të nënkuptuar që ka si objekt të tij dhe/ose efekte të tij për të penguar, kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën e ndershme në një treg, duke përfshirë pa kufizime kur synon të: i) kufizojë aksesin në treg ose ushtrimin e lirë të konkurrencës nga kompani të tjera; ii) parandalojë vendosjen e çmimeve nga loja e lirë e tregjeve duke favorizuar artificialisht rritjen ose uljen e çmimeve të tilla; iii) kufizojë ose kontrollojë çdo prodhim, treg, investim ose përparim teknik; ose iv) ndajë tregjet ose burimet e furnizimit; b) çdo abuzim nga një shoqëri ose grup shoqërish me një pozitë mbizotëruese në tregun e brendshëm ose në një pjesë të konsiderueshme të tij; ose c) çdo çmim oferte ose e ulur që ka si objekt dhe/ose efektin e tij për të eliminuar nga një treg, ose për të parandaluar që një shoqëri ose një prej produkteve të saj të hyjë në treg.
Autoritet (autoritete)	Nënkupton çdo qeveri ose çdo organ, departament ose komision që ushtron një prerogativë publike, ose çdo administratë, gjykatë, agjenci ose shtet ose çdo ent qeveritar, administrativ, tatimor ose gjyqësor.
Autorizimi/e	Nënkupton çdo autorizim, pëlqim, aprovim, zgjidhje, leje, licencë, përjashtim, paraqitje, noterizim ose regjistrim, ose ndonjë përjashtim në lidhje me të, marrë nga ose siguruar nga një Autoritet, i dhënë me anë të një akti ose mosveprimi brenda një periudhe të caktuar kohe.
Vërtetuar	Nënkupton për çdo kopje, fotokopje ose kopjim tjetër të një dokumenti origjinal, vërtetim nga çdo person i autorizuar sipas rregullave, në lidhje me përputhshmërinë e kopjes, fotokopjes ose kopjimit me dokumentin origjinal.
Komponenti 5	nënkupton komponentin 5 të Projektit, siç përshkruhet në skedulin 2 (Përshkrimi i Projektit)
Kontraktues (kontraktuesit)	Nënkupton Kontraktuesin/ët palë e tretë të caktuar nga Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM për zbatimin e të gjithë ose një pjesë të Projektit, siç përshkruhet në skedulin 2 (Përshkrimi i Projektit).
Garancia/të e Kontraktuesit	Nënkupton çdo garanci që i jepet Përfituesit drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çdo bashkëkontraktues të ngarkuar për zbatimin e Projektit ose të ndonjë pjese të tij, të tilla si, për shembull, garancia e përfundimit ose garancia e paradhënies.
Afati për tërheqjen e fondit	Nënkupton datën 15 nëntor 2027, datën pas së cilës nuk mund të kryhet asnjë tërheqje e mëtejshme fondi.



Tërheqje fondi	Nënkupton tërheqjen e të gjithë ose një pjese të fondeve të vënë në dispozicion nga Agjencia për Përfituesin në lidhje me Grantin, në zbatim të kushteve të përcaktuara në klauzolën 3 (<i>Tërheqja e fondeve</i>).
Shpenzim (Shpenzime) i pranueshëm	Nënkupton shpenzimin/et e lidhura me komponentin 5 të Projektit.
Embargo	Nënkupton çdo sanksion i një natyre tregtare, që synon të ndalojë çdo import dhe /ose eksport (furnizim, shitje ose transferim) të një ose disa mallrave, produkteve ose shërbimeve që shkojnë në dhe/ose që vijnë nga një vend për një periudhë të caktuar, siç publikohet dhe ndryshohet herë pas here nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Franca.
Procedura e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave ES	Nënkupton kushtet kontraktuale të përfshira në procedurën e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave mjedisore dhe sociale, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit, të ndryshuara herë pas here.
Data e hyrjes në fuqi	Nënkupton datën e publikimit në Gazetën Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton këtë Marrëveshje.
ESCP	Nënkupton planin e angazhimit mjedisor dhe/ose social të bashkëlidhur si skeduli 6 (<i>Plani i veprimit mjedisor dhe social</i>), ku përcaktohet angazhimi i Përfituesit për të shmangur, zbutur ose kompensuar pasojat negative të Projektit, në mjedisin njerëzor dhe natyror dhe çdo monitorim të planifikuar, si dhe hapat formalë që kërkohen për të kryer veprime të tilla.
Euro(t) ose EUR	Nënkupton valutën e vetme të shteteve anëtare të Unionit Ekonomik dhe Monetar Evropian, duke përfshirë Francën, dhe që ka kurs ligjor në këto shtete anëtare.
Raport përfundimtar i auditimit	Ka kuptimin e dhënë këtij termi në klauzolën 3.2.5 (ii) (<i>Justifikimi për përdorimin e paradhënies</i>).
Lista e sanksioneve financiare	Nënkupton listën/at e personave, grupeve ose subjekteve që i nënshtrohen sanksioneve financiare nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe/ose Franca. Vetëm për qëllime informacioni dhe për lehtësinë e Përfituesit, i cili nuk mund të mbështetet tek ato, jepen referencat ose adresat e mëposhtme të internetit: Për listat e mbajtura nga Kombet e Bashkuara, mund të shikoni faqen e mëposhtme të internetit: https://www.un.org/securitycouncil/fr/content/un-sc-consolidated-list Për listat e mbajtura nga Bashkimi Evropian, mund të shikoni faqen e mëposhtme të internetit: https://eeas.europa.eu/headquarters/headquartershomepage/8442/consolidated-list-sanctions_fr Për listat e mbajtura nga Franca, mund të shikoni faqen e mëposhtme të internetit: https://www.tresor.economie.gouv.fr/services-auxentreprises/sanctions-economiques/dispositif-national-de-gel-desavoirs
Plani i financimit	Nënkupton planin e financimit të Projektit të përcaktuar në skedulën 3 (<i>Plani i financimit</i>).
Mashtrim	Nënkupton çdo praktikë të padrejtë (veprime ose mosveprime) të qëllimshme për të mashtruar të tjerët, për të fshehur me dashje elemente, ose për të tradhtuar ose përligjur pëlqimin e tij/saj, për të shmangur çdo kërkesë ligjore ose rregullore dhe/ose për të shkelur rregullat dhe procedurat e brendshme të Përfituesit ose një pale të tretë, për të marrë një përfitim të paligjshëm.
Mashtrimi ndaj interesave financiare të Komunitetit Evropian	Nënkupton çdo veprim ose mosveprim të qëllimshëm të synuar për të dëmtuar buxhetin e Bashkimit Evropian dhe që përfshin: i) përdorimin ose paraqitjen e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota, i cili ka si efekt shpërdorimin ose mbajtjen e gabuar të fondeve ose ndonjë reduktim të paligjshëm të burimeve të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian; ii) moszbulimin e informacionit me të njëjtin efekt; dhe iii) shpërdorimin e fondeve të tilla për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat këto fonde ishin dhënë fillimisht.
Granti	Nënkupton angazhimin e dhënë nga Agjencia në përputhje me këtë Marrëveshje deri në shumën maksimale të principalit të përcaktuar në klauzolën 2 (<i>Granti, qëllimi dhe kushtet e përdorimit</i>).
Origjina e paligjshme	Nënkupton fondet e marra përmes: Kryerjes së ndonjë veprë atribut siç përcaktohet në Fjalorin e rekomandimeve të FATF 40 sipas “ <i>Kategorive të përcaktuara të veprave penale</i> ” (http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/Recommandations_GAFI.pdf); - çdo akt i korrupsionit; ose - çdo mashtrim ndaj interesave financiare të Komunitetit Evropian, nëse ose kur është e zbatueshme
Deklarata e integritetit	Nënkupton integritetin, përshtatshmërinë dhe deklaratën e sipërmarrjes mjedisore dhe sociale, në formën e përcaktuar në skedulet e udhëzimeve të prokurimit. Një deklaratë e tillë do të sigurohet nga çdo tenderues ose kandidat, në përputhje me kushtet e përcaktuara në klauzolën 1.2.3 të udhëzimeve të prokurimit.



Efekti material negativ	Nënkupton një efekt material negativ mbi: a) Projektin, për aq sa do të rrezikonte vazhdimësinë e Projektit në përputhje me këtë Marrëveshje dhe dokumentet e Projektit; b) biznesin, asetet, gjendjen financiare të Përfituesit ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje dhe dokumenteve të Projektit; c) vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje ose ndonjë dokumenti të Projektit;
Marrëveshja/t e operimit	Nënkupton marrëveshjen (marrëveshjet) e shërbimit/eve të lidhura ndërmjet një ose disa Kontraktuesve dhe Përfituesit në lidhje me Projektin.
Udhëzimet e prokurimit	Nënkupton dispozitat kontraktuale në udhëzimet në lidhje me prokurimin e financuar nga Agjencia në vendet e huaja, në fuqi dhe efekt të plotë në datën e kësaj Marrëveshjeje, një kopje e së cilës është e disponueshme në faqen e internetit dhe i është dorëzuar Përfituesit nëpërmjet MIE/AKUM.
Projekti	Nënkupton Projektin, siç përshkruhet në skedulin 2 (<i>Përshkrimi i Projektit</i>).
Llogaria e Projektit	Ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në klauzolën 3.2.1 (<i>Hapja e llogarisë së Projektit</i>).
Autorizimet e Projektit	Nënkupton Autorizimet e nevojshme në mënyrë që: i) Përfituesi të zbatojë Projektin dhe të ekzekutojë të gjitha dokumentet e Projektit në të cilat është palë, dhe të ushtrojë të drejtat e tij dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas dokumenteve të Projektit ku është palë; dhe ii) dokumentet e Projektit në të cilat Përfituesi është palë, të jenë të pranueshme si prova para gjykatave në juridiksionin e Përfituesit ose përpara një tribunali kompetent të arbitrazhit.
Dokumentet e Projektit	Nënkupton të gjitha dokumentet, dhe në veçanti marrëveshjet, të dorëzuara ose të ekzekutuara nga Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM në lidhje me zbatimin e Projektit, d.m.th.: - Marrëveshja për zbatimin e projektit e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës; - Manuali i Aktiviteteve të Projektit; - Raportet tremujore të zbatimit të Projektit; - ESCP; - Rezultatet e projektit, duke përfshirë studimet e fizibilitetit, projektet paraprake dhe të detajuara, dokumentet e tenderit, raportet e vlerësimit të ofertës, kontratat e nënshkruara, raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare të kontraktuesve të projektit;
Zyrtari publik	Nënkupton çdo mbajtës të funksionit legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor, i emëruar ose zgjedhur, që shërben mbi baza të përhershme ose të përkohshme, i paguar ose i papaguar, pavarësisht nga grada, ose çdo person tjetër i përcaktuar si zyrtar publik në bazë të legjislacionit të brendshëm të juridiksionit të themelimit të Përfituesit, dhe çdo person tjetër që ushtron një funksion publik, duke përfshirë një agjenci ose organizatë publike ose duke siguruar një shërbim publik.
Skeduli/et	Nënkupton çdo skedul ose skedule të kësaj Marrëveshjeje.
Shërbimi (shërbimet)	Nënkupton studimet dhe/ose asistencën teknike siç përshkruhet në skedulin 2 - (<i>Përshkrimi i Projektit</i>).
Data e nënshkrimit	Nënkupton datën e fundit të dy datave të ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje.
Data e përfundimit teknik	Nënkupton datën e përfundimit teknik të Projektit e cila pritet të jetë data 31 dhjetor 2026.
Faqja e internetit	nënkupton faqen e internetit të Agjencisë (http://www.afd.fr/) ose ndonjë faqe tjetër e tillë interneti zëvendësuese.

Skeduli 1B. Interpretimi

a) “asetet” përfshijnë të gjitha pronat e tashme dhe të ardhshme, të ardhurat dhe të drejtat;

b) çdo referencë për “Përfituesin”, “Palën” ose “Agjencinë” përfshin pasuesit e tij në titull, delegimet e lejuara dhe transferimet e lejuara;

c) çdo referencë në këtë Marrëveshje ose dokument tjetër ose siguri është një referencë në këtë Marrëveshje ose në një dokument tjetër ose siguri të ndryshuar, përsëritur ose plotësuar dhe përfshin, nëse është e zbatueshme, çdo dokument që e zëvendëson atë përmes novacionit, në përputhje me këtë Marrëveshje;

Faqe | 2000

d) një “garanci” përfshin çdo siguri dhe çdo garanci, që është e pavarur nga borxhi me të cilin ka të bëjë;

e) një “person” përfshin çdo person, shoqëri, korporatë, partneritet, trust, qeveri, shtet apo agjenci shtetërore ose ndonjë shoqatë, ose grup prej dy ose më shumë nga sa më sipër (pavarësisht nëse ka ose jo personalitet të veçantë juridik);

f) një “rregullore” përfshin çdo legjislacion, rregullore, rregull, dekret, direktivë zyrtare, udhëzim, kërkesë, këshilla, rekomandim, vendim ose udhëzim (pavarësisht nëse ka ose jo forcën e ligjit) të ndonjë organi qeveritar, ndërqeveritar ose



mbikombëtar, autoriteti mbikëqyrës, autoriteti rregullator, autoriteti të pavarur administrativ, agjencie, departamenti ose ndonjë ndarje të ndonjë autoriteti ose organizate tjetër (duke përfshirë çdo rregullore të lëshuar nga një ent publik industrial ose tregtar) që ka efekt në këtë Marrëveshje ose mbi të drejtat dhe detyrimet e një Pale;

g) një dispozitë e ligjit është një referencë për atë dispozitë, të ndryshuar;

h) përveç nëse parashikohet ndryshe, një orë e ditës është një referencë për orën lokale të Parisit;

i) titujt e seksionit, klauzolës dhe skedulit janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

j) përveç nëse parashikohet ndryshe, fjalët dhe shprehjet e përdorura në çdo dokument tjetër që lidhen me këtë Marrëveshje ose në ndonjë njoftim të dhënë në lidhje me këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në atë dokument ose njoftim si në këtë Marrëveshje;

k) një referencë për një klauzolë ose skedul do të jetë një referencë për një klauzolë ose skedul të kësaj Marrëveshjeje; dhe

Skeduli 2. Përshkrimi i Projektit

Objektivat e Projektit

Projekti synon të sigurojë banorët e Durrësit me shërbim me cilësi dhe të qëndrueshëm të furnizimit me ujë. Investimi do të mundësojë rinovimin e infrastrukturave për të mbështetur shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve të Durrësit (SHUKD) në përmirësimin e performancës së saj operacionale, sipas strategjisë së saj 5-vjeçare, për periudhën 2018–2023. Objektivat e Projektit mbulojnë tre akset e zhvillimit të qëndrueshëm të shërbimit të ujit:

- Boshti social: përballja me kërkesën në rritje të vazhdueshme për ujë në zonën e shërbimit të SHUKD-së, duke përparuar drejt ofrimit të vazhdueshëm të shërbimeve, duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin e aktivitetit social ekonomik të rajonit.

- Boshti mjedisor: mbrojtja e burimeve ujore në sasi dhe cilësi, në një kontekst të rritjes së cenueshmërisë, e përforcuar nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.

- Boshti ekonomik: rritja e performancës operative dhe financiare të SHUKD-së dhe potenciali i rajonit të Durrësit për zhvillimin ekonomik.

Përmbajtja e Projektit

Projekti ndahet në 4 komponentë, 3 komponentë për punimet (1, 2 & 3) të cilët do të ekzekutohen sipas 2 ose më shumë kontratave; dhe 1 komponent të ndihmës teknike (4), i cili do të ekzekutohet sipas 1 ose më shumë kontratave.

Komponenti 1: Rinovimi i rrjetit të shpërndarjes në qendrën e qytetit Durrës -37 milionë euro. Ky komponent do të zbatojë studimin e projektimit të detajuar, të përgatitur nga Invictus në vitin 2020, pas shqyrtimit nga Konsulenti i Zbatimit të modelimit të rrjetit, përzgjedhjes së tubacionit, natyrës së punës, zgjedhjes së materialeve, llogaritjes së kostove, vizatimeve, rëlevimit topografik kur është e nevojshme. Konsulenti i zbatimit do ta pasurojë atë me një shënim vlerësimi mjedisor dhe social dhe do ta ndajë planin e punës në lote dhe faza. Objektivi i këtij komponenti është siguri i vazhdueshëm i furnizimit me ujë në zonat e qendrës së qytetit të Durrësit dhe Kenata, si dhe reduktimi i humbjeve të ujit (NRW) (i cili do të ndahet me dy pas përfundimit të projektit).

Komponenti 2: rehabilitimi i sistemit të Fushë-Kuqe -15.7 milionë euro. Ky komponent do të bëjë një pasqyrë të studimit të eficiencës së energjisë të realizuar nga Projekti Huk (financuar nga GIZ) në vitin 2014, i cili vlerësoi përfitimet e mundshme në 10 GWh/vit. Konsulenti i Zbatimit do të përgatisë studime të fizibilitetit dhe projektimit përpara prokurimit të punimeve.

Komponenti 3: masterplani i kanalizimeve -1.3 milionë euro. Asistenti Teknik do të përgatisë një masterplan, bazuar në ofrimin e parashikuar të shërbimit sanitar në vitin 2040.

Komponenti 4: ndihmë teknike për AKUM-in dhe menaxhimi i ndryshimit brenda SHUKD-së.

Ekipi i ndihmës teknike do të vendoset në Tiranë si Njësia e Zbatimit të Projektit për menaxhimin kontraktual, administrativ dhe financiar të projektit. Ata do të përgatisin dokumentet përkatëse për vendimmarrje, si kërkesat për propozime, raportet për vlerësimin e ofertave, kërkesat për moskundërshtimin e AFD-së dhe prova që nxisin pagesat e AFD-së për ndërmarrjet. Personeli tjetër do të qëndrojë për disa kohë në Durrës për mbikëqyrjen e punimeve.

Ndihma teknike/konsulenca institucionale do të kundërshtojë organizimin në të ardhmen të SHUKD-së për kornizën për planet në vazhdim për racionalizimin dhe mbledhjen e shërbimit të



ujësjellësit të Shqipërisë, organizimin dhe procedurat për të gjitha shërbimet, si: burimet njerëzore, funksionimin dhe mirëmbajtjen, menaxhimin e klientit, faturimin dhe rikuperimin etj. Ai do të ndihmojë SHUKD-në të marrë dhe përditësojë mjetet e menaxhimit, të tilla si bazën e të dhënave të klientit, sistemin e informacionit gjeografik, sistemin e menaxhimit të operacioneve (SCADA), sistemet e zbulimit të rrjedhjeve etj. Një fond pajisjesh prej rreth 150 mijë euro do të vihet në dispozicion sipas këtij komponenti, për të blerë dhe instaluar instrumente për zbulimin e rrjedhjeve.

Zbatimi i Programit do të fillojë me zgjedhjen e konsulentëve me paketa kontratash siç përshkruhet më poshtë:

Konsulenca e zbatimit

- Kontrata 1. projektim i detajuar, ndihmë në tenderim dhe mbikëqyrje të punimeve, për:

Komponenti 1. Rinovim i rrjetit të shpërndarjes në qytetin e Durrësit.

Komponenti 2. Rehabilitim i sistemit të Fushë-Kuqes.

- Kontrata 2

Komponenti 3. Përgatitje e masterplanit të konceptit të kanalizimit të bazuar në periudhën e projektuar deri në vitin 2040.

Konsulenca institucionale/ ndihma teknike

- Kontrata 3

Komponenti 4. Masat shoqëruese për ndërtimin e kapaciteteve dhe forcimin institucional të SHUKD-së dhe mbështetje për AKUM-in në zbatimin e programit.

Shuma indikative e vlerësuar për shërbimet e konsulencës (komponentët 1, 2 dhe 4) është 7 milionë euro.

Skeduli i zbatimit

Organizimi institucional

AFD-ja do të financojë të gjithë projektin përmes një kredie prej 60 milionë euro dhe një granti prej 1 milion euro. Të dyja marrëveshjet e financimit do të nënshkruhen ndërmjet AFD-së dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë (MFE) do të jetë Përfutuesi dhe Marrësi i Huas.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësllës-Kanalizimeve (AKUM) do të jetë përgjegjëse për zbatimin e të gjithë koordinimit të zbatimit të programit. AKUM-ja do të veprojë si Njësia e Koordinimit të Programit (NJKP), përgjegjëse për prokurimin dhe kontraktimin e punimeve dhe shërbimeve të konsulencës, si dhe monitorimin e përgjithshëm dhe raportimin e programit. Në kuadër të organizimit institucional të AKUM-it një staf i kualifikuar i dedikuar që formon NJKP-në do të trajtojë zbatimin e përditshëm të programit.

E gjithë infrastruktura dhe pajisjet e financuara nga projekti do të bëhen asete të SHUKD-së në fund të projektit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe SHUKD-ja do të nënshkruajnë një Marrëveshje për Zbatimin e Projektit, dhe asistenti teknik do të përgatisë një Manual të Veprimeve të Projektit, në fillim të projektit. Të dyja palët do të japin detaje mbi përgjegjësitë e palëve të interesuara dhe procedurat e zbatueshme për projektin.

Skeduli i zbatimit shtrihet në katër vite:

	Përshkrimi	S1	S2	S3	S4	S5	S6	S7	S8
1	Konsulencë institucionale/ndihmë teknike për komponentin 4	x	x	x	x	x	x	x	x
2	Shërbimet e konsulencës për zbatimin për komponentin 1								
	Projektimi i detajuar- rinovim i rrjetit të shpërndarjes në qytetin e Durrësit	x	x						
	Prokurimi i punimeve		x						
	Zbatimi i punimeve për rinovimin e rrjetit të Durrësit			x	x	x	x	x	x
3	Shërbimet e konsulencës për zbatimin për komponentin 2								



	Studimi i fizibilitetit/projektimi paraprak dhe projektimi i detajuar	x	x	x					
	Prokurimi i punimeve				x				
	Implementimi i punimeve për rehabilitimin e zonës së Fushë-Kuqes					x	x	x	x
3	Shërbimet e konsulencës për zbatimin për komponentin 3								
	Përgatitje e masterplanit të higjienës publike		x	x	x				

Rezultatet e pritshme të projektit

Nëpërmjet këtij projekti, SHUKD-ja synon të përgjysmojë ujin pa të ardhura (NRW), aktualisht mbi 70%, që do të konsistojë në një reduktim të konsumit të ujit të papërpunuar prej 6 milionë m³/vit (reduktim të humbjeve teknike) dhe rritje e ujit të faturuar me 6 milionë m³/vit (reduktim të humbjeve komerciale). Gjithashtu, rinovimi i pajisjeve të pompimit dhe zëvendësimi i tubacioneve të transmetimit pritet të gjenerojë një reduktim të konsumit të energjisë të SHUKD-së me 10 GWh/vit ose 16%.

Bazuar në këto hipoteza, norma e brendshme e kthimit për Projektin, gjatë një periudhë 20-vjeçare, arrin 8.02%. SHUKD-JA do të rrisë marzhin e saj bruto me 6.7 milionë euro, për t'u krahasuar me shpenzimet mesatare operative prej 8.5 milionë euro në vitin 2017 dhe 2018.

Arritja e këtij objekti ambicioz do të kërkojë,

përveç projektit, përpjekje të vazhdueshme të SHUKD-së në menaxhimin komercial të shërbimit, veçanërisht në zbatimin e matësve individualë dhe faturimin për të gjithë klientët. Do të kërkojë gjithashtu përpjekje në zbulimin dhe riparimin e rrjedhjeve, dhe në përgjithësi në mirëmbajtjen parandaluese të infrastrukturës dhe pajisjeve të SHUKD-së.

Projekti do të përmirësojë cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimit të furnizimit me ujë për popullsinë e rajonit të Durrësit, me një kosto më të ulët mjedisore. Do të ketë ndikime pozitive në uljen e pabarazive dhe ruajtjen e ekosistemeve ujore nëntokësore. Komponenti i ndërtimit të kapaciteteve do të rrisë pritshmëritë operationale ndaj SHUKD-së dhe do të sjellë ndikime strukturore në qeverisjen e shërbimit të ujësjellësit në të gjithë vendin.

Skeduli 3. Plani i financimit

Në EURO	Totali	Huaja	Granti
Punimet dhe furnizimet	52.700.00	52.700.00	0
Shërbimet e konsulencës	8.300.000	7.300.000	1.000.000
Total	61.000.000	61.000.000	1.000.000

Skeduli 4. Kushtet pararendëse

Sa më poshtë zbatohet për të gjitha dokumentet e dorëzuara nga Përfituesi, si një kusht pararendës:

- nëse dokumenti i dorëzuar nuk është origjinal por fotokopje, fotokopja origjinale e vërtetuar i dorëzohet Agjencisë;
- versioni përfundimtar i një dokumenti, drafti i të cilit është dërguar më parë, dhe për të cilin është rënë dakord nga Agjencia, nuk do të ndryshojë materialisht nga drafti i rënë dakord;
- dokumentet që nuk janë dërguar më parë dhe mbi të cilat është rënë dakord, do të jenë të pranueshme për Agjencinë.

PJESA I. KUSHTET PARARENDËSE QË DUHET TË PËRMBUSHEN NË DATËN E NËNSHKRIMIT

1. Dorëzimi nga Përfituesi tek Agjencia i një kopjeje të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për miratimin “në parim” të kësaj Marrëveshjeje; dhe

2. Dorëzimi tek Agjencia i një kopjeje origjinale të dokumentit përkatës të lëshuar nga autoriteti/et kompetent në Republikën e Shqipërisë që autorizon një person ose persona të caktuar për të ekzekutuar këtë Marrëveshje në emër të tij.



PJESA II. KUSHTET PARARENDËSE PËR TRANSFERIMIN E PARË TË FONDIT

1. Një letër e nënshkrimit model të personave të autorizuar për të nënshkruar, në emër të Përfituesit, kërkesat për tërheqjet e fondit dhe çdo vërtetim në lidhje me këtë Marrëveshje dhe për të marrë të gjitha masat e tjera dhe/ose të nënshkruajë të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme lidhur me zbatimin e projektit në emër të Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Nga Agjencia nuk ka asnjë kundërshtim për Manualin e Veprimeve të Projektit.

PJESA III. KUSHTET PARARENDËSE PËR TË GJITHA TËRHEQJET E FONDEVE, DUKE PËRFSHIRË TËRHEQJEN E PARË TË FONDIT

Dorëzimi nga Përfituesi nëpërmjet MIE/AKUM tek Agjencia i udhëzimeve (në veçanti informacion i llogarisë së kontraktuesit përkatës) të kërkuara për transferimin e tërheqjes së fondeve direkt te Kontraktuesi palë e tretë, sipas kërkesës, dhe:

3. të gjitha kontratat dhe formularët e porosive së bashku me çdo plan dhe kuotë (nëse është e zbatueshme) që i janë dhënë më parë Agjencisë në përputhje me dhe siç përcaktohet në udhëzimet e prokurimit, në lidhje me tërheqjen e fondit që kërkohet të paguhet drejtpërdrejt; dhe

4. çdo raport, faturë ose kërkesë për pagesë të ndërmjetme, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Agjencinë, të cilat mund të dorëzohen në formën e fotokopjeve ose dublikatave të vërtetuara.

Skeduli 5. Informacioni që Agjencia është e autorizuar shprehimisht të zbulojë në faqen e internetit të Agjencisë (në veçanti në platformën e saj të hapur të të dhënave)

1. Informacion lidhur me Projektin

- Numri dhe emri në librin e AFD-së;
- Përshkrimi;
- Sektori operues;
- Vendi i zbatimit;
- Data e pritshme e fillimit të projektit;
- Data e pritshme e përfundimit teknik;
- Statusi i implementimit i përditësuar në bazë gjysmë vjetore;

2. Informacion lidhur me financimin e Projektit

- Lloji i financimit (hua, grant, bashkëfinancim, fonde të deleguara);

- Masa e principalit të Grantit;
- Masa totale e tërhequr në bazë vjetore;
- Planifikimi i shumave të tërheqjes së fondit në bazë trevjeçare; dhe
- Sasia e Grantit që është tërhequr (e përditësuar sipas ecures së zbatimit të Projektit);

3. Informacion tjetër

- Njoftimi mbi informacionin e transaksionit, bashkangjitur këtij skeduli; dhe
- Përmbledhja e vlerësimit të projektit, përmbajtja e së cilës përcaktohet në nenin 6.18 “Vlerësimi i Projektit”.

Skeduli 6. Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social

1. Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social (ESCP) synon të konsolidojë në një dokument të vetëm masat dhe veprimet materiale që Projekti të zbatohet në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të AFD-së dhe për pranueshmërinë e AFD-së.

2. ESCP-ja paraqet në një mënyrë të saktë angazhimet e bëra nga Përfituesi për të shmangur, minimizuar, reduktuar ose kompensuar ndikimet e mundshme të Projektit për mjedisin njerëzor dhe natyror, gjatë të gjitha fazave të projektit: projektimi, ndërtimi dhe funksionimi.

3. Standardet mjedisore dhe sociale të zbatuara nga AFD-ja bazohen në:

- Politikën e menaxhimit mjedisor dhe social të riskut për funksionimin e financuar nga AFD-ja. <https://www.afd.fr/en/resources/environmental-and-social-risk-management-policy-afd-funded-operations>.

- Kuadri Mjedisor dhe Social (ESF) – Grupi i Bankës Botërore:

<http://documents.worldbank.org/curated/en/383011492423734099/pdf/114278-WP-REVISED-PUBLIC-Environmental-and-Social-Framework.pdf>.

- Udhëzimet Mjedisore, të Shëndetit dhe Sigurisë- Grupi i Bankës Botërore: https://www.ifc.org/wps/wcn/connect/Topics_Ext_Content/IFC_External_Corporate_Site./Sustainability-Ay-IFC/Policies-Standards/EHS-Guidelines/

- Konventat kryesore/themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) të ratifikuara nga Shqipëria.

4. AKUM/NJKP është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e angazhimeve të listuar më sipër.



ASPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
1. Monitorimi dhe raportimi				
1.1. Raportimi i rregullt	1.1.1. Të përgatitet dhe dorëzohet AFD-së në bazë të rregullt, raportet e monitorimit mbi performancën Mjedisore, Sociale, të Shëndetit dhe Sigurisë (ESHS) të Projektit, duke përfshirë por pa kufizuar zbatimin e ESCP-së, statusin e përgatitjes dhe zbatimin të dokumenteve të E&S të kërkuara sipas ESCP-së, aktivitetet e angazhimit të aktorëve, funksionimin e mekanizmit (ve) të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.	AKUM/NJKP	Duke filluar nga data efektive e Marrëveshjes së Shumës së Kredisë. Çdo vit gjatë zbatimit të Projektit.	Raportet vjetore të pavarura ESHS ose seksioni i pavarur ESHS në raportet e progresit të Projektit që duhet të jenë të pranueshme për AFD-në.
1.2. Incidentet dhe aksidentet	1.2.1. Të njoftohet menjëherë AFD-ja për ndonjë incident ose aksident lidhur me Projektin që ka ose mund të ketë një ndikim negativ të konsiderueshëm për mjedisin, trashëgiminë kulturore, komunitetet e prekura, publikun ose punonjësit, duke përfshirë ndër të tjera, rastet e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit (SEA), ngacmimin seksual (SH); aksidentet që rezultojnë në vdekje, dëmtim i rëndë ose i shumëfishtë; dhe çdo përhapje e COVID-19 në zonën e Projektit	AKUM/NJKP	Çdo aksident apo incident do t'i njoftohet menjëherë Drejtuesit të Ekipit të Detyrës të AFD-së, pas shënimit të incidentit apo aksidentit. Raporti i aksidentit apo incidentit do të dorëzohet tek AFD-ja brenda 48 orësh pas informimit për incidentin apo aksidentin. Një raport i detajuar do të dorëzohet pranë AFD-së jo më vonë se 7 ditë pune pasi SHUKD-ja mëson për incidentin ose aksidentin, përveç në rast se bihet dakord për një afat kohor të ndryshëm në një mënyrë të pranueshme për AFD-në. Ky sistem i njoftimit/raportimit do të vendoset në funksion përgjatë zbatimit të Projektit.	Të gjitha aksidentet dhe incidentet do t'i raportohen menjëherë AFD-së. Të gjitha incidentet dhe aksidentet do t'i raportohen AFD-së ose në raportet vjetore të pavarura të ESHS-së ose në seksionin e dedikuar të ESHS-së në raportet e progresit të Projektit për pranueshmëri nga ana e AFD-së.
1.3. Raportet e rregullta të Kontraktuesve	1.3.1 AKUM/NJKP duhet të kërkojnë Kontraktuesve të sigurojnë raporte monitorimi tremujore për AKUM/NJKP për performancën mjedisore, sociale, të shëndetit dhe sigurisë (ESHS) në përputhje me sistemet matëse mjedisore dhe sociale në dokumentet dhe kontrata përkatëse të detyrueshme. AKUM/NJKP do t'i dorëzojë këto raporte AFD-së me kërkesë të AFD-së.	AKUM/NJKP/Konsulentit/Kontraktuesit	Kontraktuesit duhet të dorëzojnë raportet e rregullta çdo tre muaj me kërkesë të AKUM/NJKP (në rastin e situatave me incident apo të paparashikuar). NJZP-ja do t'i dorëzojë raporte tremujore AFD-së, kur kërkohet. Sistemi i raportimit do të jetë në funksion përgjatë zbatimit të Projektit.	Raportet e monitorimit të ESHS-së të Kontraktuesit mund të kërkojnë nga AFD-ja.

ASPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
2. Vlerësimi dhe Menaxhimi i Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale të Rreziqeve				
2.1 Struktura organizative	2.1.1 AKUM/NJKP me mbështetjen e konsulentit institucional me stafin e kualifikuar dhe burimet e duhura për të mbështetur menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve të ESHS-së të Projektit, duke përfshirë 1 specialist të mjedisit dhe social me kohë të plotë dhe 1 specialist të shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS) me kohë të plotë, përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë e plotë me rregulloren e mjedisit dhe të punës të Shqipërisë, të gjithë me eksperiencën dhe kualifikimet e pranueshme për AFD-në.	AKUM/NJKP-Konsulentit Institucional	Konsulentit institucional do të mbështesë AKUM/NJKP lidhur me çështjet e ESHS-së, duke përfshirë specialistët që do të mbahen përgjatë zbatimit të Projektit.	Përbërja organizative e stafit të komponentëve institucional të dedikuar për të mbështetur AKUM/NJKP me CV-të e specialistëve të ESHS-së do të marrin NOC të AFD-së. Ndryshimet e Stafit Mbështetës dhe zëvendësimi i ndonjë specialisti të ESHS-së do të marrë NOC të AFD-së.
2.2 Vlerësimet mjedisore dhe sociale/planet e menaxhimit/specifikimet e punimeve	2.2.1 Një konsulent i mjedisit dhe social që do të punësohet nga AKUM/NJKP dhe monitorohet nga NJZP-ja, do të jetë përgjegjës për të përgatitur një VNMS që	AKUM/NJKP	VNMS/PMMS do të përgatitet në lidhje me Projektimin Konceptual të Projektit.	VNMS/PMMS do të marrë një NOC nga AFD-ja.



(a)	do të përfshijë një PMMS, për çdo nën-projekt.			
	2.2.2 AKUM/NJKP do të jetë përgjegjës për të përfshirë aspektet përkatëse të kësaj ESCP, VNMS, PMMS dhe çdo masë tjetër përkatëse të ESHS-së, në specifikimet e ESHS-së të dokumentacionit të prokurimit të Kontraktuesit. Pas kësaj, AKUM/NJKP do të sigurojë që Kontraktuesit zbatojnë kërkesat e ESHS-së të kontratave të tyre.	AKUM/NJKP	Masat përkatëse të ESHS-së do të përfshihen në dokumentet e prokurimit përpara lançimit të procesit të prokurimit për aktivitetet përkatëse të Projektit dhe më pas në pajtueshmëri gjatë kryerjes se këtyre aktivitetëve.	Dokumentacioni i Prokurimit dhe kontrata e kontraktuesve do të marrë një NOC nga AFD-ja.
3. Puna dhe kushtet e punës				
3.1 Masat e shëndetit dhe sigurisë në punë	3.1.1 Kontraktuesit do të përgatisin, miratojnë dhe zbatojnë planet dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS), që mbulojnë përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave, trajnimet e punëtorëve të projektit për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e mundshme (pajisjet e mbrojtjes personale, ndihma e parë, pajisjet zjarrfikëse, tensioni i lartë etj.), dëmtimet dhe për të zbutur ndikimet në komunitetet lokale, siç përshkruhen në PMMS. Planet dhe masat e OHS-së do të bazohen në VNMS-në dhe PMMS-në dhe në legjislacionin dhe rregulloret e Shqipërisë për punën.	AKUM/NJKP-Konsulenti institucional	Masat e OHS-së duhet të zbatohen përgjatë zbatimit të Projektit dhe monitorimi të raportohet në raportin gjysmë vjetor të ESHS-së të AKUM/NJKP/konsulentit.	Planet dhe masat e sigurisë dhe shëndetit në punë të Projektit të përgatitura nga kontraktuesit do të marrin NOC të AFD-së.

ASPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
4. Efektshmëria e burimeve dhe parandalimi dhe menaxhimi i ndotjes				
4.1 Efektshmëria e burimeve dhe parandalimi dhe menaxhimi i ndotjes	4.1.1 Si pjesë e përgatitjes së VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të konsiderojë sipas nevojës, se çfarë është përkatëse në lidhje me këtë aspekt, përfshirë ndër të tjera, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, efektshmërinë e burimeve, furnizimin me ujë dhe mbrojtjen e dheut etj. AKUM/NJKP do të përfshijë ato aspekte përkatëse në specifikimet e ESHS-së të dokumenteve të prokurimit dhe në kontratën me Kontraktuesin e cila nga ana e tij do të përgatisë, implementojë dhe ruajë plane të ndryshme lidhur me mjedisin, si pjesë e ndërtimit të PMMS-së, përfshirë Planin e Menaxhimit të Mbetjeve që do të përcaktojë sasinë e mbetjeve, kategorizimin e tyre dhe trajtimin, ruajtjen, transportin e propozuar dhe masat në dispozicion.	AKUM/NJKP Konsulenti i E&S-së	I njëjti afat kohor për zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Detyrimi kontraktual do të përfshihet në kontratat përkatëse me kontraktuesit dhe entet mbikëqyrëse me nënshkrimin e këtyre kontratave. Menaxhimi i aspekteve përkatëse do të ruhet gjatë zbatimit të Projektit dhe do të raportohet në raportin e ESHS-së. Një objekt i licencuar për shkatërrimin/përpunimin e niveleve të konsiderueshme të mbetjeve të rrezikshme do të identifikohet dhe kontraktohet përpara fillimit të punimeve.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Shikoni pikën 1.1.1. më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me raportimin. Licenca e objektit për shkatërrimin/përpunimin e niveleve të konsiderueshme të mbetjeve të rrezikshme do të pajisen me NOC të AFD-së.
5. Shëndeti dhe siguria në komunitet				
5.1 Shëndeti dhe siguria në komunitet	5.1.1 Si pjesë e përgatitjes së VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të konsiderojë sipas nevojës se çfarë është përkatëse në lidhje me këtë aspekt, përfshirë ndër të tjera: minimizimin e mundësisë për ekspozimin e komunitetit ndaj sëmundjeve të transmetueshme; krijimin dhe zbatimin e sistemeve të duhura të menaxhimit të cilësisë për të menaxhuar rreziqet dhe ndikimet që shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e kryera sipas Projektit mund të kenë në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit; përfshirë ndër të tjera parandalimin dhe reagimin ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, si dhe ngacmimit seksual. AKUM/NJKP do të përfshijë gjithashtu aspektet përkatëse në specifikimet e ESHS-së të dokumenteve të prokurimit dhe në	AKUM/NJKP Konsulenti i E&S-së	I njëjti afat kohor për zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Detyrimi kontraktual do të përfshihet në kontratat përkatëse me kontraktuesit dhe entet mbikëqyrëse me nënshkrimin e këtyre kontratave. Menaxhimi i aspekteve përkatëse do të ruhet gjatë zbatimit të Projektit dhe do të raportohet në raportin e ESHS-së.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Shikoni pikën 1.1.1. më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me raportimin.



	kontratën me Kontraktuesin që nga ana tjetër do të përgatisë, zbatojë dhe ruajë plane të ndryshme lidhur me menaxhimin si pjesë e ndërtimit të PMMS-së, duke përfshirë Planin e Menaxhimit të Trafikut (PMT) për rehabilitimin e rrugëve ekzistuese dhe punimeve të tjera që mund të çmohen të arsyeshme.			
--	---	--	--	--

SPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
6. Trashëgimia kulturore				
6.1 Menaxhimi i trashëgimisë kulturore	6.1.1 Duke pasur parasysh trashëgiminë kulturore dhe tiparet arkeologjike të Durrësit, konsulenti i E&S-së do të vlerësojë me kujdes, si pjesë e zhvillimit të VNMS-së dhe PMMS-së, ndikimin e Projektit në trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë. AKUM/NJKP do të përfshijë në specifikimet e Punës të dokumentacionit të prokurimeve dhe në kontratën me Kontraktuesin, të gjitha masat e lehtësimit nga VNMS-ja dhe PMMS-ja lidhur me trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë. Nga ana tjetër, Kontraktuesi do të përgatisë, zbatojë dhe ruajë një Plan Menaxhimi për Trashëgiminë Kulturore (PMTK) që do të përfshijë gjithashtu një procedurë për gjetjen e mundësisë për çdo punim, duke përfshirë gërmimet në rrugën e qytetit të vjetër të Durrësit. AKUM/NJKP do të përfshijë autoritetet kombëtare dhe/ose lokale të përfshira në trashëgiminë Kulturore dhe arkeologjinë, në çdo hap të projektimit dhe zbatimit të Projektit.	SHUKD AKUM/NJKP Konsulenti i E&S-së Kontraktuesi	I njëti plan kohor për zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Detyrimi kontraktual do të përfshihet në kontratat përkatëse me kontraktuesit dhe subjektet mbikëqyrëse me nënshkrimin e këtyre kontratave. Menaxhimi i aspekteve përkatëse do të ruhet gjatë zbatimit të Projektit dhe do të raportohet në raportin e ESHS-së.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Shikoni pikën 1.1.1. më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me raportimin.
7. Angazhimi i aksionerëve dhe zbulimi i informacionit				
7.1 Plani i Angazhimit të Grupeve të Interesit	7.1.1 Si pjesë e VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të përgatisë Planin e Angazhimit të Aktorëve (SEP);	Konsulenti i E&S-së	Si pjesë e VNMS-së, SEP do të përgatitet në lidhje me Projektimin Konceptual të Projektit.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit.
7.2 Mekanizmi për zgjidhjen e ankesave	7.2.1 Si pjesë e VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të përgatisë një mekanizëm për trajtimin e ankesave (GRM). SHUKD-ja, me mbështetjen e AKUM/NJKP do të publikojë, ruajë dhe operojë për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave në lidhje me Projektin, shumë shpejt dhe në mënyrë të efektshme, në mënyrë transparente, që është e duhur nga ana kulturore dhe e aksesueshme për palët e prekura të Projektit, pa kosto dhe pa ndëshkim, duke përfshirë shqetësimet dhe ankesat e dorëzuara në mënyrë anonime.	SHUKD Konsulenti i E&S-së	Mekanizmi për zgjidhjen e ankesave do të ruhet dhe mbahet operacionale përgjatë zbatimit të projektit. Ankesat dhe zgjidhja e tyre do të raportohet në raportin vjetor të ESHS-së.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit.

Skeduli 7. Forma e raportit të ndjekjes të indikatorëve të Projektit

Indikatori	Llogaritja dhe burimi	Vlerat që nga data e nënshkrimit
Numri i personave të sapo lidhur me rrjetin e ujit të pijshëm	Raportet vjetore të SHUKD-së	20,000 persona
Numri i personave, sistemi i ujit të pijshëm të cilëve është përmirësuar	Raportet vjetore të SHUKD-së	350,000 persona
Ekonomitë në ujin e pijshëm	Raportet vjetore të SHUKD-së	6,000,000 m3/vit
Ekonomitë në konsumin e energjisë	Raportet vjetore të SHUKD-së	10 GWh/vit
Numri i personave të cilëve u është përmirësuar qëndrueshmëria klimatike	Raportet vjetore të SHUKD-së	350,000 persona



% e konsumatorëve që përfitojnë nga shërbimi i vazhdueshëm i ujit	Raportet vjetore të SHUKD-së	0%
% e njerëzve të lidhur në zonën e shërbimit SHUKD	Raportet vjetore të SHUKD-së	94% urban 83% rural
Norma e ujit pa të ardhura	Raportet vjetore të SHUKD-së	74%
Energjia e konsumuar për m ³ ujë të pijshëm të prodhuar dhe të ujërave të zeza të trajtuara	Raportet vjetore të SHUKD-së	1.5 kWh ujë të pijshëm; 0.5 kWh ujërat e zeza

Skeduli 8. Njoftimi mbi informacionin e transaksionit

SHQIPËRIA Rindërtimi i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të Durrësit	
---	--

Projekti synon të mbështesë Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë specifike autoritetet e Ujësjellësit të Durrësit për të përmirësuar performancën e tyre operacionale, duke u fokusuar në zhvillimin ekonomik, reduktimin e pabarazisë dhe qeverisjen e sektorit.

KONTEKSTI

Burimet ujore të Shqipërisë janë ndër më të bollshmet në Evropë, por me një shpërndarje të pabarabartë gjeografike dhe temporale. Uji i pijshëm prodhohet dhe shpërndahet nga 58 operatorë bashkiakë, performanca operacionale dhe financiare e të cilëve është relativisht e ulët. Si rrjedhojë, shteti shqiptar ka vendosur të injektojë rreth 12 milionë euro në vit për të kompensuar deficitet operuese.

Për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit të furnizimit me ujë dhe për të qenë në përputhje me standardet evropiane në funksion të aderimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria ka investuar masivisht në sektorin e ujësjellësit me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë. Gjithashtu, një reformë e madhe sektoriale është në proces.

Durrësi ka përjetuar dy tërmete në vitin 2019. Ky projekt është përfshirë në programin kombëtar të rindërtimit pas tërmetit, pasi përmirësimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve konsiderohet strategjike për zhvillimin e aktivitetit të turizmit dhe biznesit në Durrës, dhe ka një ndikim shumë të madh në të gjithë zhvillimin ekonomik të vendit.

PËRSHKRIMI

Projekti synon të mbështesë shërbimin e ujësjellësit të Durrësit (SHUKD) në përmirësimin e performancës së saj operacionale, në linjë me strategjinë pesëvjeçare që miratoi në vitin 2018, në mënyrë specifike, ky projekt, do të: i) përmbushë kërkesën për shërbimet e vazhdueshme dhe me cilësi për të mbështetur aktivitetet sociale-ekonomike; ii) kufizojë ndikimet mjedisore duke ruajtur sasinë dhe cilësinë e burimeve; dhe iii) përmirësojë performancën ekonomike, financiare dhe operacionale të SHUKD-së.

VENDI

Shqipëria

Data e nënshkrimit të marrëveshjes

15.11.2022

Sektorët

Ujësjellësi dhe kanalizimet, qytetet e qëndrueshme

Lokalizimi

Durrës

Kohëzgjatja e financimit

20 vjet

Instrumenti i financimit

Hua sovranë dhe granti i asistencës teknike

Shuma e financimit

61 milionë euro

Përfituesi
Republika e Shqipërisë

Menaxhimi i Projektit
AKUM

SDG-të kryesore



Kodi i Projektit: CAL1012

Projekti ka katër komponentë

1. Rinovimi i rrjetit të shpërndarjes në qytetin e Durrësit (37 milionë euro);

2. Rehabilitimi i stacionit të pompës Fushë-Kuqe dhe tubacionit të transferimit të ujit (15.7 milionë euro);

3. Realizimi i master planit të kanalizimit për rajonin e Durrësit (1.3 milionë euro);

4. Mbështetje për SHUKD-në dhe koordinimin e projektit.

Shuma indikative e vlerësuar e shërbimeve të konsulencës (komponentët 1, 2 dhe 4) është 7 milionë euro.

REZULTATET

Projekti do të ketë efekte përfituese të konsiderueshme lidhur me:

- Zhvillimin social-ekonomik të rajonit, nëpërmjet përmirësimit të performancës së operatorit dhe në këtë mënyrë duke sjellë përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ujësjellësit;

- Reduktimin e pabarazive, duke siguruar disponueshmërinë e shërbimit thelbësor të ujësjellësit, për të gjithë me një çmim të përballueshëm;

- Qeverisje e sektorit, nëpërmjet mbështetjes së rëndësishme për ndërtimin e kapaciteteve të operatorit. Projekti do të ndihmojë në përgatitjen e strategjisë së SHUKD-së të vendosjes së çmimeve për popullsitë vulnerabël.

AKTORËT DHE MODUS OPERANDI

Përfituesi do të jetë Republika e Shqipërisë

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), një agjenci e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) do të jetë pronari i projektit.

- MIE/AKUM dhe SHUKD-ja kanë nënshkruar një marrëveshje për zbatimin e projektit, për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm. Asistenca e plotë teknike do të vendoset në funksion për të mbuluar komponentin 4 të projektit. AKUM-i do të jetë përgjegjës për të gjithë zbatimin dhe prokurimin e programit, me secilin hap sipas opinionit jokundërshtues të AFD-së, që do të disbursojë fondet direkt për ofertuesit.

PLANI I FINANCIMIT

Kosto e projektit kushton 61 milionë euro, duke përfshirë një hua sovranë 60 milionë euro dhe një grant 1 milion euro, të dhënë si pjesë e përpjekjeve të ndërtimit pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019.

Granti një milion euro do të financojë pjesërisht kontratën e asistencës teknike që plotëson huanë.

Skeduli 9. Listë joshteruese e dokumenteve mjedisore dhe sociale që Përfituesi lejon të zbulohen në lidhje me procedurën e punës të mekanizmit të menaxhimit të ankesave

E & S

- Raporti i objektit E&S

- Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social (VNMS)

- Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS)

- Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS)

- Plani i Veprimit për Zhvendosje (PVZH)

- Kuadri i Politikave për Zhvendosje (KPZH)

- Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social (PAMS)

- Vlerësimi i kufizuar mjedisor dhe social

- Plani i kufizuar i veprimit mjedisor dhe social

- Kapitulli nga studimi i fizibilitetit mjedisor dhe social

- Kapitujt nga raportet e monitorimit mjedisor dhe social

- Raportet e monitorimit të zbatimit të PAMS-it



VENDIM
Nr. 35, datë 27.1.2023

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE
PROFESIONALE TË MJEKËVE,
STOMATOLOGËVE DHE
ARKITEKTËVE NË KONTEKSTIN E
MARRËVESHJES SË TREGTISË SË
LIRË TË EVROPËS QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE
PROFESIONALE TË MJEKËVE,
STOMATOLOGËVE DHE ARKITEKTËVE
NË KONTEKSTIN E MARRËVESHJES SË
TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS
QENDRORE

Përfaqësuesit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës*, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (më poshtë bashkërisht “Palët” dhe individualisht “Pala”),

në kontekst të integritetit ekonomik, në përputhje me Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (“CEFTA”) 2006, në përputhje me

nenin V të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve, dhe për qëllime të mëtejshme të liberalizimit të tregtisë së shërbimeve brenda CEFTA-s;

duke pasur parasysh qëllimet dhe prioritetet e përcaktuara në Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021–2024 (“CRM”) që synon heqjen e pengesave për njohjen e kualifikimeve profesionale, përmes miratimit dhe zbatimit të një “Kudri të Bashkimit Evropian (BE) për njohjen automatike të kualifikimeve profesionale për shtatë profesione dhe sistemin e njohjes automatike të BE-së” bazuar në bashkërendimin e kushteve minimale të trajnimit;

duke vërejtur se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet se i përjashton Palët nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse sipas traktateve ekzistuese;

me synim inkurajimin e lëvizshmërisë të profesionistëve, përputhjen më të mirë të aftësive me nevojat e tregut të punës dhe rritjen e produktivitetit;

duke theksuar objektivat e promovimit të harmonizimit rregullator dhe përafrimit të ligjeve dhe rregulloreve të Palëve me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE); në veçanti duke synuar mundësimin e lëvizjes së lirë të profesionistëve përmes transpozimit në kuadrin rajonal të direktivës 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, për njohjen e kualifikimeve profesionale, të ndryshuar me direktivën 2013/55/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 nëntor 2013;

me synimin e sigurimit të njohjes automatike të kualifikimeve profesionale bazuar në kërkesat minimale të trajnimit dhe zbatimit të saj në të tri profesionet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe Direktivën e sipërpërmendur dhe të caktimit të profesioneve që plotësojnë zbatimin e kërkesave minimale të trajnimit brenda shtojcave në jo më shumë se dy vjet për ta shtrirë atë në katër profesione të tjera me miratimin e kësaj Marrëveshjeje;

Bien dakord si më poshtë:

* Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo Marrëveshje përcakton rregullat për njohjen automatike të dëshmime të kualifikimeve formale bazuar në kushtet minimale të trajnimit brenda Palëve për akses dhe ushtrim të profesionit të rregulluar, si dhe kushtet minimale të harmonizuara të trajnimit në një ose më shumë Palëve të tjera, dhe që lejojnë mbajtësit e kualifikimit në fjalë (më poshtë: profesionistët) të ndjekin të njëjtin profesion në një Palë (më poshtë: Pala pritëse) të ndryshme nga Pala ku ata kanë marrë kualifikimet e tyre profesionale (më poshtë Pala lëshuese).

2. Termat e përdorur në këtë Marrëveshje që kanë një kuptim gjinor, pavarësisht nëse përdoren në gjininë mashkullore apo femërore, përfshijnë si gjininë mashkullore ashtu edhe atë femërore, dhe çdo gjini tjetër të njohur nga Palët.

Neni 2 Fusha e veprimit

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për personat fizikë, siç përcaktohet në shtojcën I të protokollit shtesë 6, si profesionistë të Palës lëshuese që dëshirojnë të ndjekin një profesion të rregulluar në një Palë pritëse, në varësi të kushteve minimale të harmonizuara të trajnimit, qoftë për një të vetëpunësuar ose të punësuar. Secila Palë do të lejojë një profesionist të Palës lëshuese, me dëshmi të kualifikimeve profesionale dhe formale sipas kuptimit të nenit 3(1)(b), të cilat nuk janë marrë në Palën pritëse, të ndjekë një profesion të rregulluar sipas kuptimit të nenit 3(1)(a) brenda një Palë e tillë në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e saj përkatës. Kjo njohje do të respektojë kushtet minimale të trajnimit të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Nëse dëshmitë e kualifikimit formal nuk janë në përputhje me kushtet minimale të trajnimit, siç parashikohen në këtë Marrëveshje, njohja e kualifikimit profesional do t'i nënshtrohet një sistemi të përgjithshëm njohjeje.

2. Kjo Marrëveshje zbatohet për profesionistët e mëposhtëm: mjekët, stomatologët dhe arkitektët,

siç përcaktohet dhe renditen përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III.

3. Secila Palë do t'i paraqesë grupit të përbashkët të punës për njohjen e kualifikimeve profesionale ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative që ajo miraton në lidhje me lëshimin e dëshmime të kualifikimeve formale në profesionet e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

4. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, institucionet e arsimit të lartë do të kenë programe studimi të akredituara dhe/ose programe studimi të licencuara të harmonizuara me kërkesat minimale të trajnimit të përcaktuara në shtojcat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “profesion i rregulluar”: një veprimtari profesionale ose grup veprimtarish profesionale, qasja në të cilën, ndjekja e së cilës, ose një nga mënyrat e ndjekjes të së cilës është subjekt, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në bazë të dispozitave legjislative, rregullatore ose administrative, i kualifikimeve specifike profesionale; në veçanti, përdorimi i një titulli profesional të kufizuar nga dispozita legjislative, rregullatore ose administrative për mbajtësit e një kualifikimi të caktuar profesional do të përbëjë një mënyrë ndjekjeje (të profesionit);

b) “kualifikime profesionale”: kualifikime të vërtetuara me dëshmi të kualifikimeve formale, një dëshmi kompetence e lëshuar nga një autoritet kompetent i Palës, i caktuar në përputhje me dispozitat ligjore, rregullatore ose administrative të asaj Pale, në bazë të një kursi trajnimi ose një provimi specifik dhe/ose përvojës profesionale;

c) “dëshmi e kualifikimeve formale”: diploma, certifikata dhe dëshmi të tjera të lëshuara nga një autoritet i një Pale të caktuar në përputhje me dispozitat ligjore, rregullatore ose administrative të asaj Pale dhe që vërtetojnë përfundimin e suksesshëm të trajnimit profesional të marrë kryesisht në një Palë;

d) “autoritet kompetent”: çdo autoritet ose organ i autorizuar nga një Palë në mënyrë specifike, për të lëshuar ose marrë diploma trajnimi dhe dokumente ose informacione të tjera, si dhe për të



marrë aplikimet dhe vendimet e përmendura në këtë Marrëveshje;

e) “arsim dhe trajnim i rregulluar”: çdo trajnim i cili është i orientuar në mënyrë specifike për ndjekjen e një profesioni të caktuar dhe që përfshin një kurs ose kurse të plotësuar, sipas rastit, me trajnim profesional, ose praktikë provuese ose profesionale;

f) Struktura dhe niveli i formimit profesional, i periudhës së provës ose praktikës profesionale do të përcaktohet nga ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të Palës së interesuar ose të monitoruara ose të miratuara nga autoriteti i caktuar për këtë qëllim;

g) “përvojë profesionale”: ndjekja aktuale dhe e ligjshme me kohë të plotë ose ekuivalente, me kohë të pjesshme të profesionit në fjalë në një Palë;

h) “praktikë profesionale”: një periudhë praktike profesionale e kryer nën mbikëqyrje, me kusht që të japë akses në një profesion të rregulluar, që mund të ndodhë ose gjatë ose pas përfundimit të një arsimimi që çon në një kualifikim;

i) “person fizik” siç përcaktohet në kuadrin e CEFTA-s;

j) “Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive ose Krediteve ECTS”: sistemi i krediteve për arsimin e lartë, i përdorur në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë;

k) Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale (GPPNJKP);

l) ‘CEFTA’: Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore;

m) ‘RCC’: Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Neni 4

Efektet e njohjes

Njohja e kualifikimeve profesionale nga Pala pritëse do t’i lejojë personat fizikë të kenë akses në atë Palë në të njëjtin profesion për të cilin ata janë të kualifikuar në Palën lëshuese dhe ta ushtrojnë atë në Palën pritëse në kushte jo më pak të favorshme sesa personat fizikë të saj.

KREU II PARIMET E NJOHJES

Neni 5

Rregullat e lidhura me natyrën profesionale, ligjore ose administrative

Kur një profesionist lëviz, ai i nënshtrohet rregullave profesionale, ligjore ose administrative, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me kualifikimet profesionale, të tilla si përkufizimi i profesionit, përdorimi i titujve dhe abuzimi i rëndë profesional, i cili lidhet drejtpërdrejt dhe specifikisht me mbrojtjen dhe sigurinë e konsumatorit, si dhe dispozitat disiplinore që zbatohen në Palën pritëse për profesionistët që ndjekin të njëjtin profesion në Palën pritëse.

Neni 6

Parimet e njohjes automatike

1. Secila Palë do të njohë dëshmitë e kualifikimeve formale si mjek, duke dhënë akses në veprimtaritë profesionale të mjekut me trajnim bazë dhe si mjek i specializuar, si stomatolog dhe stomatolog i specializuar, dhe si arkitekt, të renditura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III, të cilët plotësojnë kushtet minimale të trajnimit të përmendura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III dhe për qëllime të aksesit dhe ndjekjes së veprimtarive profesionale, do t’i japin këtyre dëshmive të njëjtën fuqi, si dëshmive të kualifikimeve formale që lëshon vetë.

Dëshmi të tilla të kualifikimeve formale duhet të lëshohen nga organet kompetente të Palës lëshuese dhe të shoqërohen, sipas rastit, me certifikatat e renditura përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III.

2. Këto përditësime nuk do të sjellin ndryshim të parimeve ekzistuese thelbësore ligjore të Palëve në lidhje me strukturën e profesioneve, si dhe në lidhje me trajnimin dhe kushtet e aksesit nga personat fizikë. Këto përditësime do të respektojnë përgjegjësinë e Palëve për organizimin e sistemeve arsimore.



Neni 7

Dispozitat e përbashkëta mbi trajnimin

Palët, në përputhje me procedurat specifike të secilës Palë, do të sigurojnë inkurajimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, që profesionistët, kualifikimi profesional i të cilëve mbulohet nga kjo Marrëveshje, të jenë në gjendje të përditësojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e tyre për të ruajtur një siguri dhe praktikë efektive dhe për t'u përditësuar për zhvillimet profesionale.

Neni 8

Të drejtat e fituara

Pa cenuar të drejtat e fituara, specifike për profesionet në fjalë, në rastet kur dëshmitë e kualifikimeve formale si mjek, të cilat japin akses në veprimtaritë profesionale të mjekut me formim bazë dhe mjekut të specializuar, si stomatolog dhe stomatolog i specializuar dhe si arkitekt që kanë profesionistët e Palëve, nuk plotësojnë të gjitha kërkesat për trajnim të përmendura në këtë Marrëveshje, secila Palë do të njohë si provë të mjaftueshme dëshminë e kualifikimeve formale të lëshuar nga këto Palë për atë që kjo dëshmi vërteton përfundimin me sukses të trajnimit, që fillon në datat që do të propozohen nga Grupi i Përbashkët i Punës dhe shoqërohet me një certifikatë që deklaron se mbajtësit e tyre janë përfshirë efektivisht dhe ligjrisht në veprimtaritë në fjalë për të paktën tre vjet radhazi gjatë pesë viteve para dhënies së certifikatës.

KREU III

PROCEDURA PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Neni 9

Procedura e përbashkët për njohjen e kualifikimeve profesionale

1. Pala pritëse do të njoftojë se e ka marrë kërkesën brenda 30 ditëve nga marrja e saj dhe do të informojë kërkuuesin për çdo dokument që mungon. Nëse kërkuesi nuk e dorëzon dokumentacionin shtesë, autoriteti kompetent e refuzon kërkesën si të paplotë, përveç rastit kur kandidati argumenton arsyet për mosrespektimit të afatit.

2. Procedura për shqyrtimin e një kërkesë për autorizim për të ushtruar një profesion të rregulluar duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të çojë në një vendim të arsyetuar siç duhet nga autoriteti kompetent në Palën pritëse, në çdo rast brenda tre muajve pas datës kur kërkuesi ka dorëzuar dosjen e plotë dhe në këto raste arsyet do të shpjegohen në vendimin e njohjes.

3. Vendimi ose mungesa e marrjes së një vendimi brenda afatit është objekt ankimi sipas rregullave të përgjithshme të secilës Palë.

Neni 10

Rekursi

Njohja e kualifikimeve profesionale do të përfshijë mundësinë për t'u drejtuar një mekanizmi efektiv rekursi për kërkuuesin. Në rast se nuk jepet njohja, kërkuesi duhet t'i drejtohet një autoriteti, i cili ka përbërje të ndryshme nga autoriteti që ka refuzuar kërkesën. Ky autoritet do të vendosë për ankesën pasi t'i ketë dhënë kërkuetit mundësinë për t'u dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme.

Neni 11

Dokumentet dhe Certifikatat që mund t'i kërkojnë aplikantit në përputhje me këtë Marrëveshje

1. Dokumentet

a) Dëshmi se personi në fjalë është person fizik i një Pale.

b) Dëshmi të kualifikimeve formale që japin akses në profesionin e rregulluar në fjalë, siç ato renditen përkatësisht në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III.

c) Dëshmi të kualifikimit profesional sipas kuptimit të nenit 3(1)(b), shoqëruar me certifikatën e autoritetit kompetent që deklaron se profesionisti ka qenë i angazhuar efektivisht dhe ligjrisht në aktivitetet në fjalë për të paktën tre vjet radhazi gjatë pesë vitet para dhënies së certifikatës.

d) Kur autoriteti kompetent i Palës pritëse kërkon, nga personat që dëshirojnë të ushtrorjnë një profesion të rregulluar, prova se ata kanë karakter ose reputacion të mirë ose se nuk kanë shpallur falimentin, ose nuk janë pezulluar ose ndaluar të ushtrorjnë profesionin në rast të abuzimit të rëndë profesional ose të një veprë penale, Pala pritëse përkatëse do të pranojë si provë të mjaftueshme, në lidhje me kërkuetit nga Palët që dëshirojnë të



ushtrojnë atë profesion, paraqitjen e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës lëshuese, të cilat tregojnë se këto kërkesa janë përmbushur. Këto autoritete duhet t'i ofrojnë dokumentet brenda një periudhe dymujore.

e) Kur autoritetet kompetente të Palës lëshuese nuk lëshojnë dokumentet e përmendura në nën paragrafin e parë, këto dokumente do të zëvendësohen me një deklaratë betimi ose, për Palët të cilat nuk kanë dispozitë për deklaratën e betimit, nga një deklaratë solemne, e bërë nga personi fizik në fjalë përpara një autoriteti kompetent gjyqësor ose administrativ ose, sipas rastit, para organit profesional të kualifikuar të Palës lëshuese; ky autoritet lëshon një certifikatë që vërteton autenticitetin e deklaratës së betimit ose të deklaratës solemne.

f) Kur një Palë pranuese kërkon nga një profesionist i saj që dëshiron të ushtrojë një profesion të rregulluar, një dokument në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të kërkuarit, ajo Palë do të pranojë si provë të mjaftueshme paraqitjen e dokumentit të kërkuar në Pala lëshuese. Kur Pala lëshuese nuk lëshon një dokument të tillë, Pala pritëse do të pranojë një certifikatë të lëshuar nga një autoritet kompetent në atë Palë. Në këtë rast, autoritetet kompetente të Palës lëshuese duhet të japin dokumentin e kërkuar brenda një periudhe një mujore.

g) Kur një Palë pritëse kërkon që profesionistët të angazhohen në një profesion të rregulluar,

- provë të deklaratës së gjendjes financiare të kërkuarit,

- dëshmi që kërkuari është i siguruar ndaj rreziqeve financiare që rrjedhin nga përgjegjësia profesionale e profesionistëve në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Palën pritëse në lidhje me kushtet dhe shtrirjen e mbulimit, ajo Palë do të pranojë si provë të mjaftueshme një vërtetim për këtë qëllim të lëshuar nga bankat dhe shoqëritë e sigurimit të një Pale tjetër.

Kur një Palë e kërkon këtë për profesionistët, do të sigurohet një vërtetim që konfirmon mungesën e pezullimeve të përkohshme ose përfundimtare nga ushtrimi i profesionit ose i dënimeve penale.

2. Certifikata të tjera

Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët mund të përcaktojnë që, përveç dëshmime të kualifikimeve formale, personi fizik që plotëson

kushtet e kërkuara të trajnimit, duhet të ofrojë një certifikatë nga autoritetet kompetente të tij/saj dhe çdo Palë tjetër lëshuese që deklaron se kjo dëshmi e kualifikimeve formale plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

3. Format i dhe gjuha

Të gjitha dokumentet dhe certifikatat e përmendura në këtë nen do të pranohen nga autoriteti kompetent i Palës pritëse në formatin dhe gjuhën e përcaktuar në legjislacionin e Palës lëshuese. Pala pritëse ruan të drejtën për të kërkuar përkthimin e dokumenteve dhe certifikatave në një nga gjuhët e saj zyrtare prej kërkuarit.

Neni 12

Përdorimi i titujve profesionalë

1. Nëse, në një Palë pritëse, përdorimi i një titulli profesional në lidhje me një nga veprimtaritë e profesionit në fjalë është i rregulluar, kërkuarit nga Pala tjetër, të cilët janë të autorizuar për të ushtruar një profesion të rregulluar, do të përdorin titullin profesional të Palës pritëse, që përkon me atë profesion në atë Palë, dhe të përdorë çdo inicial shoqërues.

2. Kur një profesion është i rregulluar në Palën pritëse nga një shoqatë ose organizatë, kërkuarit nga Palët nuk do të autorizohen të përdorin titullin profesional të lëshuar nga ajo organizatë ose shoqatë, ose formën e tij të shkurtuar, përveç rasteve kur ata japin prova se janë anëtarë të shoqatës ose organizatës përkatëse.

3. Nëse shoqata ose organizata e kushtëzon anëtarësimin e kualifikimeve të caktuara, ajo mund ta bëjë këtë, vetëm sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në lidhje me kërkuarit e Palëve të tjera, të cilët kanë kualifikime profesionale.

Neni 13

Përdorimi i titujve akademikë

Pala pritëse do të sigurojë që personave fizikë të interesuar t'u jepet e drejta për të përdorur titujt akademikë që u janë dhënë në Palën lëshuese dhe një formë të shkurtuar të tyre, në gjuhën e Palës lëshuese. Pala pritëse mund të kërkojë që një titull të pasohet nga emri dhe adresa e dhënies ose e bordit shqyrtues që e ka dhënë atë. Kur një titull akademik i Palës lëshuese mund të ngatërrohet në Palën pritëse me një titull që, në Palën e fundit,



kërkon trajnim shtesë që nuk është marrë nga përfituesi, Pala pritëse mund t'i kërkojë përfituesit të përdorë titullin akademik të Palës lëshuese në një formë të përshtatshme, e cila do të përcaktohet nga Pala pritëse.

KREU IV RREGULLA TË HOLLËSISHME PËR NDJEKJEN E PROFESIONIT

Neni 14 Njohja e gjuhëve

1. Një Palë, nëse gjykohej e nevojshme, do të kërkojë nga ofruesi i shërbimit që përfiton nga njohja e kualifikimeve profesionale të ketë njohuri të mjaftueshme të gjuhëve të nevojshme për ushtrimin e profesionit në Palën pritëse.

2. Një Palë do të sigurojë që çdo kontroll i kryer për kontrollin e pajtueshmërisë me detyrimin sipas paragrafit 1 do të kufizohet te njohuritë e mjaftueshme të një gjuhe zyrtare të asaj Pale.

3. Çdo kontroll gjuhësor duhet të jetë proporcional me aktivitetin që do të kryhet. Profesionisti i interesuar do të lejohet të apelojë kontrole të tilla sipas ligjit të Palës pritëse.

KREU V BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 15 Aksesi qendror për informacion

1. Palët do të sigurojnë që informacioni i mëposhtëm të jetë i disponueshëm publikisht në gjuhën angleze dhe nëpërmjet pikave të kontaktit për shërbimet:

a) një listë të të gjitha profesioneve të rregulluara në atë Palë duke përfshirë detajet e personave të kontaktit për secilin profesion të rregulluar sipas nenit 18(4);

b) kërkesat dhe procedurat për të gjitha profesionet e rregulluara në atë Palë, duke përfshirë të gjitha tarifat përkatëse që duhet të paguhet nga personat fizikë dhe dokumentet që do të dorëzohen nga personat fizikë;

c) detaje se si të apelohej, sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, vendimet e Palëve të miratuara në lidhje me këtë Marrëveshje.

2. Palët do të sigurojnë që informacioni i përmendur në paragrafin 1 të ofrohet në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm në distancë dhe me mjete elektronike dhe që të mbahet i përditësuar.

3. Palët do të sigurojnë që çdo kërkesë për informacion drejtuar pikave të kontaktit për shërbimet t'i përgjigjet sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 16 Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale

1. Grupi i Përbashkët i Punës për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale (GPPNJKP) do të lehtësojë dhe mbikëqyrë zbatimin dhe vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Anëtarët e GPPNJKP-së, ndër të tjera, do të ngarkohen me dhënien e informacionit dhe asistencës siç është e nevojshme në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale të parashikuara në këtë Marrëveshje, të tilla si informacion mbi legjislacionin, rregulloret dhe dispozitat administrative që rregullojnë njohjen e kualifikimeve të profesionistëve.

3. Termat e referencës së GPPNJKP-së do të miratohen jo më vonë se një vit pas miratimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17 Transparenca

1. Palët do t'i japin GPPNJKP-së një listë të të gjitha profesioneve ekzistuese të rregulluara, duke specifikuar veprimtaritë e mbuluara nga secili profesion, dhe një listë të arsimit dhe trajnimit të rregulluar, dhe trajnimit me një strukturë të posaçme, jo më vonë se 18 muaj pas miratimit të kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim në ato lista do t'i njoftohet gjithashtu GPPNJKP-së pa vonesa të panevojshme. Sekretariatet e CEFTA-s dhe RCC-së do të krijojnë dhe mbajnë një bazë të dhënash publike të profesioneve të rregulluara, duke përfshirë një përshkrim të përgjithshëm të veprimtarive të mbuluara nga secili profesion.

2. Palët do të shqyrtojnë nëse kërkesat sipas sistemit të tyre ligjor kufizojnë aksesin në një profesion ose ndjekjen e tij për mbajtësit e një kualifikimi specifik profesional, duke përfshirë



përdorimin e titujve profesionalë dhe aktivitetet profesionale të lejuara sipas këtij titulli, të përmendura në këtë nen si “kërkesat” janë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) kërkesat nuk duhet të jenë as drejtpërdrejt as tërthorazi diskriminuese;

b) kërkesat duhet të justifikohen nga arsye kryesore të interesit të përgjithshëm;

c) kërkesat duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar arritjen e objektivit të ndjekur dhe nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur atë objektiv;

d) Palët do të informojnë GPPNJKP-në për gjetjet e tyre.

Neni 18

Parimet e bashkëpunimit administrativ

1. Palët do të punojnë në bashkëpunim të ngushtë dhe do të ofrojnë ndihmë reciproke për të lehtësuar zbatimin dhe vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Ato duhet të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit që shkëmbejnë.

2. Nëpërmjet GPPNJKP-së, Palët do të shkëmbejnë informacionin që ata e gjykojnë të nevojshëm për ndjekjen e veprimtarive sipas kësaj Marrëveshjeje. Duke vepruar kështu, ato do të respektojnë rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në legjislacionin përkatës të Palëve.

3. Secila Palë do të shkëmbejë informacion me Palët e tjera nëpërmjet GPPNJKP-së mbi proceset me anë të së cilave ato do të japin ose marrin dëshmi të kualifikimeve formale dhe dokumente ose informacione të tjera, dhe do të marrin kërkesa dhe marrin vendimet e përmendura në këtë Marrëveshjeje.

4. Nëpërmjet GPPNJKP-në, secila Palë do t'u sigurojë Palëve të tjera emrin e një personi kontakti për secilin profesion të rregulluar, i cili do të sigurojë të gjithë informacionin përkatës dhe do të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet Palëve në lidhje me profesionin e rregulluar specifik përkatës.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 19

Transpozimi

1. Palët do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë Marrëveshje jo më vonë se tetëmbëdhjetë muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 21 të saj. Palët do të informojnë GPPNJKP-në për këtë.

Neni 20

Shtojcat

1. Të gjitha shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

2. Informacioni që duhet të ofrohet nga Palët në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III do të sigurohet nga autoritetet kompetente dhe do t'i dorëzohet GPPNJKP-së jo më vonë se 18 muaj pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, sipas nenit 21 të saj.

3. Palët do të sigurojnë që informacioni i dhënë në shtojcën I, shtojcën II dhe shtojcën III të mbahet i përditësuar dhe të ndryshohet sipas nevojës nga GPPNJKP-ja në përputhje me nenin 6(1)(2) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit në përputhje me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni përkatës i Palëve. Njoftimi zyrtar i ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohet te Depozitari.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të njoftimit të tretë formal të ratifikimit, pranimit ose miratimit për Palët që kanë depozituar njoftimin e tyre formal të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Për çdo Palë që depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit pas datës së depozitimit të njoftimit të tretë zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën Pala përkatëse depoziton njoftimin e saj zyrtar të ratifikimit, pranimit ose miratimit.



4. Maqedonia e Veriut do të veprojë si Depozitar dhe do të njoftojë të gjitha palët në këtë Marrëveshje për çdo njoftim të marrë në përputhje me këtë nen dhe çdo akt ose njoftim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 22 Ndryshimet

1. Secila Palë mund të propozojë ndryshime të Marrëveshjes duke i dërguar një njoftim me shkrim Depozitarit. Depozitari do t'ia referojë këtë njoftim GPPNJKP-së si përmendur në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Propozimet e ndryshimeve do të miratohen me konsensus të të gjithë anëtarëve të GPPNJKP-së. Këto propozime do t'i referohen organit përgjegjës të CEFTA-s për tregtinë e shërbimeve.

3. Kur të miratohen, ndryshimet do t'u paraqiten Palëve për ratifikim ose miratim.

4. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me rregullat dhe procedurën e përcaktuar në nenin 21.

Neni 23 Kohëzgjatja dhe denoncimi

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohe.

2. Çdo Palë, në çdo kohë, mund të denoncojë Marrëveshjen duke i bërë një njoftim me shkrim Depozitarit, i cili do të njoftojë Palët e tjera për këtë denoncim.

3. Ky denoncim do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës kur njoftohet Depozitari.

Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga kjo Marrëveshje do të zgjidhen përmes Mekanizmit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve CEFTA 2006.

Neni 25 Aderimi nga Palët e CEFTA-s

Palët njohin të drejtat e çdo Pale të CEFTA-s për aderim në këtë Marrëveshje.

Marrëveshja hartohet në gjuhën angleze në versionin origjinal, që do të mbetet në zotërim të

Depozitarit. Secila Palë do të marrë një kopje të verifikuar të Marrëveshjes.

Nënshkruar në _____, më _____ 2022

[Nënshkrimet]

Shtojcat:

Njohja në bazë të koordinimit të kushteve minimale të trajnimit

MJEK

Neni 1 Trajnimi mjekësor bazë

1. Pranimi në trajnimin bazë mjekësor do të jetë i kushtëzuar me zotërimin e një kualifikimi ose certifikate që siguron akses, për studimet në fjalë, në universitete.

2. Trajnimi bazë mjekësor do të përfshijë gjithsej të paktën pesë vite studimi, të cilat mund të shprehen gjithashtu me kredite ekuivalente ECTS, dhe do të përbëhet nga të paktën 5 500 orë trajnim teorik dhe praktik të ofruar nga ose nën mbikëqyrjen të një universiteti.

3. Trajnimi bazë mjekësor do të japë siguri që personi në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme

a) njohuri të përshtatshme për shkencat mbi të cilat bazohet mjekësia dhe kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave;

b) kuptim të mjaftueshëm të strukturës, funksioneve dhe sjelljes së personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe marrëdhëniet ndërmjet gjendjes shëndetësore dhe mjedisit fizik dhe social të qenies njerëzore;

c) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe praktikatat klinike, duke i siguruar atij një pasqyrë koherente të sëmundjeve mendore dhe fizike, të mjekësisë nga pikëpamja e profilaksisë, diagnostikimit dhe terapisë dhe riprodhimit njerëzor;

d) përvojë të përshtatshme klinike në spitale nën mbikëqyrjen e duhur.



Neni 2

Trajnimi i specializuar mjekësor

1. Pranimi në trajnimin mjekësor të specializuar do të kushtëzohet me përfundimin dhe vlefshmërinë e një programi të trajnimit bazë mjekësor, siç përmendet në nenin 1 të shtojcës I, gjatë të cilit kursanti ka marrë njohuritë përkatëse të mjekësisë bazë.

2. Trajnimi i specializuar mjekësor do të përfshijë trajnimin teorik dhe praktik në një spital universitar ose mësimor mjekësor ose, kur është e përshtatshme, një institucion kujdesi mjekësor të miratuar për këtë qëllim nga autoritetet ose organet kompetente.

Palët do të sigurojnë që kohëzgjatja minimale e kurseve të trajnimit mjekësor të specializuar, sipas nenit 7 të shtojcës I, të mos jetë më e vogël se kohëzgjatja e parashikuar në atë pikë. Trajnimi do të bëhet nën mbikëqyrjen e autoriteteve ose organeve kompetente. Ai do të përfshijë pjesëmarrjen personale të praktikanti si mjek i specializuar në veprimtarinë dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga shërbimet në fjalë.

Trajnimi do të jepet me kohë të plotë në institucione specifike të njohura nga autoritetet kompetente. Ai përfshin pjesëmarrjen në të gjithë gamën e aktiviteteve mjekësore të departamentit ku zhvillohet trajnimi, duke përfshirë gatishmërinë, në mënyrë të tillë që specialisti praktikant t'i kushtojë të gjithë veprimtarinë e tij profesionale trajnimit të tij praktik dhe teorik gjatë gjithë javës së punës dhe gjatë gjithë vitit, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga autoritetet kompetente. Prandaj, këto poste do t'i nënshtrohen shpërblimit të duhur.

3a. Palët mund të parashikojnë, në legjislacionin përkatës, përjashtime të pjesshme nga pjesët e kurseve të trajnimit mjekësor të specializuar të renditura në nenin 7 të shtojcës I, që do të zbatohen rast pas rasti me kusht që kjo pjesë e trajnimit të jetë ndjekur tashmë gjatë një tjetër kursi trajnimi të specializuar të renditur në nenin 7 të shtojcës I, për të cilin profesionisti ka marrë tashmë kualifikimin profesional në një Palë. Palët do të sigurojnë që përjashtimi i dhënë të barazohet me jo më shumë se gjysmën e kohëzgjatjes minimale të kursit të trajnimit mjekësor të specializuar në fjalë.

Secila Palë do të njoftojë Komitetin Shumëpalësh dhe Palët e tjera për legjislacionin e saj në fjalë për çdo përjashtim të tillë të pjesshëm.

4. Palët do të kushtëzojnë lëshimin e dëshmive të trajnimit mjekësor të specializuar pas paraqitjes së dëshmisë së trajnimit bazë mjekësor të përmendur në nenin 7 të shtojcës I.

Neni 3

Llojet e trajnimit të specializuar mjekësor

Dëshmia e kualifikimeve formale si mjek i specializuar është dëshmi e tillë e dhënë nga autoritetet ose organet kompetente, siç korrespondon, për trajnimin e specializuar në fjalë, me titujt në përdorim në Palët e ndryshme dhe të përmendura në nenin 7 të shtojcës I.

Neni 4

Trajnimi i posaçëm në mjekësinë e përgjithshme

1. Pranimi në trajnim specifik në mjekësinë e përgjithshme do të kushtëzohet me përfundimin dhe vlefshmërinë e një programi të trajnimit bazë mjekësor, siç përmendet në nenin 1 të shtojcës I, gjatë të cilit praktikanti ka marrë njohuritë përkatëse të mjekësisë bazë.

2. Trajnimi specifik në mjekësinë e përgjithshme që çon në dhënien e dëshmive të kualifikimeve formale të lëshuara përpara [1 janarit 2006] do të zgjasë të paktën dy vjet me kohë të plotë. Në rastin e dëshmive të kualifikimeve formale të lëshuara pas kësaj date, trajnimi do të zgjasë të paktën tre vjet me kohë të plotë.

Kur programi i trajnimit i përmendur në nenin 1 të shtojcës I përfshin trajnim praktik të dhënë nga një spital i miratuar që disponon pajisje dhe shërbime të përshtatshme mjekësore të përgjithshme ose si pjesë e një praktike të përgjithshme mjekësore të miratuar ose një qendre të miratuar ku mjekët ofrojnë kujdes parësor mjekësor, kohëzgjatja e trajnimit praktik mund të përfshihet, deri në maksimumi një vit, në kohëzgjatjen e parashikuar në nënparagrafin e parë për certifikatat e trajnimit të lëshuara më ose pas [1 janarit 2006].

Opsioni i parashikuar në nënparagrafin e dytë do të jetë i disponueshëm vetëm për Palët në të cilat trajnimi specifik në mjekësinë e përgjithshme zgjat dy vjet që nga [1 janari 2001].

3. Trajnimi specifik në mjekësinë e përgjithshme do të kryhet me kohë të plotë, nën mbikëqyrjen e



autoriteteve ose organeve kompetente. Ai do të jetë më shumë praktik sesa teorik.

Trajnimi praktik do të ofrohet, nga njëra anë, për të paktën gjashtë muaj në një spital të miratuar që disponon pajisje dhe shërbime të përshtatshme dhe, nga ana tjetër, për të paktën gjashtë muaj si pjesë e një praktike të përgjithshme mjekësore të miratuar ose një qendër e miratuar ku mjekët ofrojnë kujdes parësor shëndetësor.

Trajnimi praktik do të zhvillohet në bashkëpunim me institucione apo struktura të tjera shëndetësore që kanë të bëjnë me mjekësinë e përgjithshme. Megjithatë, pa paragjykuar periudhat minimale të përcaktuara në nënparagrafin e dytë, trajnimi praktik mund të ofrohet gjatë një periudhe jo më shumë se gjashtë mujore në institucione ose struktura të tjera shëndetësore të miratuara që kanë të bëjnë me mjekësinë e përgjithshme.

Trajnimi kërkon pjesëmarrjen personale të profesionistit në veprimtarinë profesionale dhe përgjegjësitë e personave me të cilët ai punon.

4. Palët do të sigurojnë që lëshimi i dëshmimeve të kualifikimeve formale në praktikën e përgjithshme mjekësore të bëhet pas zotërimit të dëshmimeve të kualifikimeve formale në trajnimin bazë mjekësor të përmendur në nenin 6 të shtojcës I.

5. Palët mund t'i japin dëshmi të kualifikimeve formale të përmendura në nenin 6 të shtojcës I një mjeku që nuk ka kryer trajnimin e parashikuar në këtë nen, por që ka kryer një trajnim tjetër, plotësues, siç vërtetohet nga dëshmitë e

kualifikimeve formale të lëshuara nga autoritetet kompetente. Megjithatë, ato nuk mund të japin dëshmi të kualifikimeve formale, përveç nëse vërtetojnë njohuri të një niveli cilësisht të barabartë me njohuritë e marra nga trajnimi i parashikuar në këtë nen.

Palët do të përcaktojnë, *inter alia*, shkallën në të cilën trajnimi plotësues dhe përvoja profesionale e fituar tashmë nga kërkuesi mund të zëvendësojë trajnimin e parashikuar në këtë nen.

Palët mund të lëshojnë vetëm dëshmitë e kualifikimeve formale të përmendura në nenin 6 të shtojcës I, nëse kërkuesi ka fituar të paktën gjashtë muaj përvojë të mjekësisë së përgjithshme në një praktikë mjekësore të përgjithshme ose në një qendër ku mjekët ofrojnë kujdes shëndetësor parësor të llojeve të përmendura në paragrafin 3.

Neni 5

Ndjekja e aktiviteteve profesionale të mjekëve të përgjithshëm

Secila Palë do të kushtëzojë ndjekjen e veprimtarive të një mjeku të përgjithshëm në kuadrin e sistemit të saj të brendshëm të sigurimeve shoqërore me zotërimin e dëshmimeve të kualifikimeve formale të përmendura në nenin 6 të shtojcës I.

Palët mund të përjashtojnë nga ky kusht personat që aktualisht po ndjekin trajnime specifike në mjekësi të përgjithshme.

Neni 6

Dëshmitë e kualifikimeve formale në trajnimet mjekësore bazë

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve formale	Autoriteti që jep kualifikimet	Certifikata shoqëruese e kualifikimeve	Data e referencës

Neni 7

Dëshmitë e kualifikimeve formale të mjekëve të specializuar

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve formale	Autoriteti që jep kualifikimet	Data e referencës

Neni 8

Titujt e kurseve të trajnimit në mjekësi të specializuar

Pala	Titulli	Titulli
	Anestezi	Kirurgji e përgjithshme
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite



	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgji neurologjike	Obstetri dhe ginekologji
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Mjekësi e Përgjithshme (internale)	Oftalmologji
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Otorinolaringologji	Pediatri
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	
Pala	Mjekësi respiratore	Urologji
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Ortopedi	Anatomi patologjike
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Neurologji	Psikiatri
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Radiologji diagnostikuese	Radioterapi
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgji plastike	Biologji klinike
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Mikrobiologji-bakteriologji	Biologji kimike
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Imunologji	Kirurgjia e krahavorit
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Pediatri	Kirurgji vaskulare
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Kardiologji	Gastroenterologji
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Reumatologji	Hematologji e Përgjithshme
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Endokrinologji	Fizioterapi
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite
	Titulli	Titulli



Pala	Neuropsikiatri	Dermato-venerologji
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Radiologji	Psikiatri për fëmijët
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Geriatri	Sëmundjet e veshkave
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Sëmundjet e transmetueshme	Mjekësia e komunitetit
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Farmakologjia	Mjekësia e punës
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Alergologji	Mjekësi bërthamore
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgjia Maksilo-faciale (trajnim bazë mjekësor)	Hematologji biologjike
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Stomatologji	Dermatologji
	Periudha minimale e trajnimit: 3 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Venerologji	Mjekësi tropikale
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Kirurgji gastroenterologjike	Aksidentet dhe urgjenca
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Neurofiziologji klinike	Kirurgjia dentare, orale dhe maksilo-faciale (trajtime bazë mjekësore dhe dentare)
	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite
	Titulli	Titulli
Pala	Onkologji	Gjenetikë mjekësore
	Periudha minimale e trajnimit: 5 vite	Periudha minimale e trajnimit: 4 vite

Neni 9

Dëshmi të kualifikimeve formale të mjekut të përgjithshëm

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve formale	Titulli profesional	Data e referencës



SHTOJCA II STOMATOLOGËT

Të gjitha dispozitat në shtojcën I janë marrë nga direktiva e BE-së 2005/36/EC për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Neni 1

Trajnimi stomatologjik bazë

1. Pranimi në trajnimin bazë stomatologjik presupozon zotërimin e një diplome ose certificate që jep akses, për studimet në fjalë, në universitete ose institute të larta të një niveli të njohur si ekuivalent në një Palë.

2. Trajnimi bazë stomatologjik përfshin gjithsej të paktën pesë vite studimi, të cilat mund të shprehen edhe me kreditë ekuivalente ECTS, dhe do të përbëhet nga të paktën 5 000 orë trajnime teorike dhe praktike me kohë të plotë që përfshin të paktën programin e përshkruar në nenin 4 të shtojcës II dhe që ofrohet në një universitet, në një institut të lartë që ofron trajnime të njohura si të një niveli ekuivalent ose nën mbikëqyrjen e një universiteti.

3. Trajnimi bazë stomatologjik do të sigurojë që personi në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

a) njohuri të përshtatshme të shkencave mbi të cilat bazohet stomatologjia dhe një kuptim të mirë të metodave shkencore, duke përfshirë parimet e matjes së funksioneve biologjike, vlerësimin e fakteve të vërtetuara shkencërisht dhe analizën e të dhënave;

b) njohuri të përshtatshme për strukturën, fiziologjinë dhe sjelljen e personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe ndikimin e mjedisit natyror dhe social në gjendjen e shëndetit të njeriut, për aq sa këta faktorë ndikojnë në stomatologji;

c) njohuri të përshtatshme për strukturën dhe funksionin e dhëmbëve, gojës, nofullave dhe të lidhura me to indet, të shëndetshme dhe të sëmura, dhe marrëdhëniet e tyre me gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe me mirëqenien fizike dhe sociale të pacientit;

d) njohuri të përshtatshme për disiplinat dhe metodat klinike, duke i ofruar dentistit një pamje koherente të anomalive, lezioneve dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve të lidhura

me to dhe të stomatologjisë parandaluese, diagnostikuese dhe terapeutike;

e) përvojë e përshtatshme klinike nën mbikëqyrjen e duhur.

Ky trajnim do t'i sigurojë atij aftësitë e nevojshme për kryerjen e të gjitha aktiviteteve që përfshijnë parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e anomalive dhe sëmundjeve të dhëmbëve, gojës, nofullave dhe indeve shoqëruese.

Neni 2

Trajnimi i specializuar stomatologjik

1. Pranimi në trajnimin stomatologjik të specializuar varet nga përfundimi dhe vlefshmëria e trajnimit bazë stomatologjik të përmendur në nenin 1 të shtojcës II.

2. Trajnimi stomatologjik i specializuar përfshin mësimin teorik dhe praktik në një qendër universitare, në një qendër trajtimi mësimore dhe kërkimore ose, sipas rastit, në një institucion shëndetësor të miratuar për këtë qëllim nga autoritetet ose organet kompetente.

Kurset e specializuara stomatologjike me kohë të plotë do të zgjasin të paktën tre vite dhe do të mbikëqyren nga autoritetet ose organet kompetente. Ato përfshijnë pjesëmarrjen personale të praktikantit si mjek stomatolog në veprimtarinë dhe në përgjegjësitë e institucionit përkatës.

3. Palët do të kushtëzojnë lëshimin e dëshmive të trajnimit stomatologjik të specializuar me zotërimin e dëshmive të trajnimit bazë stomatologjik të përmendur në nenin 5 të shtojcës II.

Neni 3

Ndjekja e veprimtarive profesionale të mjekëve stomatologë

1. Për qëllimet e kësaj direktive, veprimtaritë profesionale të mjekëve stomatologë janë veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 3 dhe të ndjekura sipas kualifikimeve profesionale të renditura në nenin 5 të shtojcës II.

2. Profesionin e mjekut stomatolog bazohet në trajnimin stomatologjik të përmendur në nenin 1 dhe 2 të shtojcës II dhe përbën një profesion specifik, i cili dallon nga profesionet e tjera të përgjithshme ose të specializuara mjekësore. Ndjekja e veprimtarive të një mjeku stomatolog



kërkon zotërimin e dëshmive të kualifikimeve formale të përmendura në nenin 5 të shtojcës II.

3. Palët do të sigurojnë që mjekët stomatologë të jenë në përgjithësi në gjendje të kenë akses dhe të ndjekin aktivitetet e parandalimit, diagnostikimit dhe trajtimit të anomalive dhe sëmundjeve që prekin dhëmbët, gojën, nofullat dhe indet fqinje, duke pasur parasysh dispozitat dhe rregullat e etikës profesionale në datat e referencës të përmendura në nenin 5 të shtojcës II.

Neni 4

Programet e studimit për mjekët stomatologë

Programi i studimeve që çon në evidentimin e kualifikimeve formale në stomatologji duhet të përfshijë të paktën lëndët e mëposhtme. Një ose më shumë nga këto lëndë mund të mësohen në kontekstin e disiplinave të tjera ose në lidhje me to.

A. Lëndët bazë	B. Lëndët mjeko-biologjike dhe lëndët e mjekësisë së përgjithshme	C. Lëndët e lidhura drejtpërdrejt me stomatologjinë
— Kimi	— Anatomi	— Protetodonci
— Fizikë	— Embriologji	— Materiale dhe pajisje dentare
— Biologji	— Histologji, përfshirë citologjinë	— Stomatologji konservative
	— Fiziologji	— Stomatologji parandaluese
	— Biokimi (ose kimi fiziologjike)	— Anestezi dhe sedatimi
	— Anatomi patologjike	— Kirurgji gojore
	— Patologji e Përgjithshme	— Patologji speciale
	— Farmakologji	— Praktik; klinike
	— Mikrobiologji	— Paedodontikë
	— Higjienë	— Ortodonti
	— Mjekësi parandaluese dhe epidemiologji	— Periodonti
		— Radiologjia dentare
	— Radiologji	— Okluzion dentar dhe funksioni i nofullës
	— Fizioterapi	— Organizimi profesional, etika dhe legjislacioni
	— Kirurgji e Përgjithshme	— Aspektet sociale të praktikës dentare
	— Mjekësi e Përgjithshme, përfshirë Pediatrinë	— Kirurgji maksimo-faciale
	— Oto-rino-laringologji	



	— Derma-venerologji — Psikiatri i Përgjithshme — Psikoterapi — Neuropatologji — Anestezi	
--	--	--

Neni 5

Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare të stomatologëve

Pala	Dëshmia e kualifikimeve formale	Autoriteti që jep dëshmitë e kualifikimeve	Certifikata që shoqëron dëshmitë e kualifikimeve	Titulli profesional	Data e referencës

Neni 6

Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare të stomatologëve të specializuar

Kirurgjia orale

Pala	Dëshmitë zyrtare të kualifikimeve	Certifikata që shoqëron dëshmitë e kualifikimeve	Data e referencës

Ortodontia

Pala	Dëshmitë zyrtare të kualifikimeve	Autoriteti që jep dëshmitë e kualifikimeve	Data e referencës



SHTOJCA III ARKITEKTI

Neni 1 Trajnimi i arkitektëve

1. Trajnimi si arkitekt duhet të përfshijë:

a) një total prej të paktën pesë vitesh studimi me kohë të plotë në një universitet ose një institucion të krahasueshëm mësimor, që çon në përfundimin me sukses të një provimi të nivelit universitar; ose

2. Arkitektura duhet të jetë komponenti kryesor i studimit të përmendur në paragrafin 1. Studimi duhet të mbajë një ekuilibër midis aspekteve teorike dhe praktike të trajnimit mbi arkitekturën dhe të garantojë të paktën përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të mëposhtme:

b) aftësive për të krijuar dizajne arkitekture që plotësojnë kërkesat estetike dhe teknike;

c) njohuri të përshtatshme mbi historinë dhe teorinë e arkitekturës dhe të arteve, teknologjive dhe shkencave njerëzore përkatëse;

d) njohjen e arteve të bukura si ndikim në cilësinë e dizajnit arkitekturor;

e) njohuri të përshtatshme për projektimin urban, planifikimin dhe aftësitë e përfshira në procesin e planifikimit;

f) të kuptuarit e marrëdhënieve midis njerëzve dhe ndërtesave, dhe midis ndërtesave dhe mjedisit të tyre, dhe nevojës për të lidhur ndërtesat dhe hapësirat ndërmjet tyre me nevojat njerëzore dhe shkallën;

g) të kuptuarit e profesionit të arkitektit dhe rolit të arkitektit në shoqëri, veçanërisht për

përgatitjen e informacioneve që marrin parasysh faktorët social;

h) të kuptuarit e metodave të hetimit dhe përgatitjes së informimit për një projekt projektimi;

i) të kuptuarit e projektimit strukturor dhe problemeve ndërtimore dhe inxhinierike që lidhen me projektimin e ndërtesave;

j) njohuri të përshtatshme të problemeve fizike dhe teknologjive dhe të funksionit të ndërtesave për t'u siguruar atyre kushte të brendshme të rehatshme dhe mbrojtje kundër kushteve klimatike, në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm;

k) aftësitë e nevojshme të projektimit për të përmbushur kërkesat e përdoruesve të ndërtesave brenda kufizimeve të vendosura nga faktorët e kostos dhe rregulloret e ndërtimit;

l) njohuri të përshtatshme për industrinë, organizatat, rregulloret dhe procedurat e përfshira në përkthimin e koncepteve të projektimit në ndërtesa dhe integrimin e planeve në planifikimin e përgjithshëm;

3. Numri i viteve të studimit akademik të përmendur në paragrafin 1 mund të shprehet edhe me kreditet ekuivalente ECTS.

Neni 2 Ndjekja e veprimtarive profesionale të arkitektëve

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, aktivitetet profesionale të një arkitekti janë aktivitetet që kryhen rregullisht nën titullin profesional të "arkitektit".

Neni 3 Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare të arkitektëve

Pala	Dëshmitë e kualifikimeve zyrtare	Autoriteti që jep dëshmitë e kualifikimeve	Certifikate shoqëruese e dëshmimeve të kualifikimit	Viti akademik i referencës

**URDHËR****Nr. 21, datë 19.1.2023****PËR NJË PLAN MENAXHIMI
SHUMËVJEÇAR PËR PESHKIMIN
FUNDOR TË QËNDRUESHËM NË
DETIN ADRIATIK (NËNZONAT
GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të marrëveshjes “Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e rekomandimit GFCM/43/2019/5 të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Kuota e sforcos e shprehur në ditë peshkimi ndryshon në bazë vjetore sipas rekomandimeve të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun.

3. Të gjitha anijet e peshkimit fundor, që peshkojnë peshq fundorë, nuk kalojnë 21 726 ditë peshkimi në vitin 2023, të ndara sipas segmentit të flotës, në përputhje me pikën 4 të këtij urdhri.

4. Ditët e peshkimit ndahen sipas segmenteve të flotës për anijet e peshkimit fundor që përdorin rrjetë fundore me timon (OTB), si më poshtë:

- a) segmenti ≥ 12 m dhe < 24 m: 16 015 ditë;
- b) segmenti ≥ 24 m: 5 711 ditë.

5. Ngarkohet Sektori i Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Inspektorati i Peshkimit të monitorojnë konsumin e kuotës së sforcos ose kufirin e sforcos, në përputhje me pikën 4 të këtij urdhri.

6. Ndalohet peshkimi deri në gjashtë milje detare nga bregu ose deri në katër milje detare për anijet që nuk lejohen të peshkojnë më shumë

se gjashtë milje detare, për të gjitha anijet e peshkimit fundor (trata koçe), që peshkojnë peshq fundor, për periudhën 1 korrik deri më 15 shtator.

7. Pas tremujorit të tretë të çdo viti, Sektori i Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave kryen verifikimin dhe rishpërndarjen e ditëve të peshkimit midis segmentit të flotës, në zbatim të faktorit kombëtar të konvertimit, i cili mbështetet në këshillat më të mira shkencore të disponueshme.

8. Nga data kur kuota e sforcos është përmbushur ose është arritur kufiri i sforcos, Inspektorati i Peshkimit ia komunikon Sektorit të Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave.

9. Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës propozon ndalimin e peshkimit fundor, në rastin kur kuota ose kufiri i sforcos është arritur nga të gjitha anijet e peshkimit, sipas segmentit të flotës.

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

11. Urdhri nr. 216, datë 29.5.2020, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi GFCM/43/2019/5] dhe urdhri nr. 639, datë 22.12.2021, “Për vendosjen e një regjimi sforcos të peshkimit për speciet kryesore fundore në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi GFCM/44/2021/1]”, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

**REKOMANDIMI GFCM 43/2019/5
PËR NJË PLAN MENAXHIMI
SHUMËVJEÇAR PËR PESHKIMIN FUNDOR
TË QËNDRUESHËM NË DETIN ADRIATIK
(NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)**

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),

duke marrë parasysh se objektivi i Marrëveshjes për themelimin e Komisionit të Përgjithshëm të



Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja e GFCM-së) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, në zonën e aplikimit të GFCM-së;

duke sjellë në vëmendje që në arritjen e qëllimit të Marrëveshjes GFCM, GFCM-ja do të miratojë rekomandime për masat e ruajtjes dhe të menaxhimit, që synojnë të sigurojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të aktiviteteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të peshkimit dhe, që në miratimin e rekomandimeve të tilla, GFCM-ja do t'u kushtojë vëmendje të veçantë masave për të parandaluar mbipeshkimin dhe për të minimizuar hedhurinat, si dhe ndikimet e mundshme në peshkimin artizanal dhe komunitetet lokale;

duke marrë parasysh që GFCM-ja do të miratojë masa menaxhuese bazuar në një qasje ekosistemi në peshkim për të garantuar ruajtjen e rezervave peshkore mbi nivelet të cilat mund të prodhojnë rendimentin maksimal të qëndrueshëm (MSY);

duke kujtuar që Deklarata Ministrore e Maltës e vitit 2017 kërkon që, në kontekstin e krijimit të një kuadri të menaxhimit të peshkimit të bazuar në ekosistem, të gjitha format e peshkimit kryesor duhet të menaxhohen me plane menaxhimi;

duke pasur parasysh që GFCM-ja do të zbatojë qasjen paraprake, në përputhje me Marrëveshjen për zbatimin e dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit të 10 dhjetorit 1982, në lidhje me ruajtjen dhe menaxhimin e rezervave të peshqve të shpërndarë dhe peshqve migratore të 4 gushtit 1995 dhe Kodit të Sjelljes për Peshkimi të Përgjegjshëm të Organizatës së Bujqësisë dhe Ushqimit të Kombeve të Bashkuara (FAO);

duke marrë parasysh se Kodi i Sjelljes i FAO-së për peshkimin përgjegjës parashikon që shtetet “duhet të zbatojnë gjerësisht qasjen paraprake në ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve ujore të gjalla, për t'i mbrojtur ato dhe për të ruajtur mjedisin ujor, duke marrë parasysh shembujt më të mirë shkencorë të mundshëm. Mungesa e informacionit të përshtatshëm shkencor nuk duhet të përdoret si arsye për shtyrjen ose mosplotësimin e masave për ruajtjen e specieve të synuara, specieve të lidhura ose të varura dhe specieve jo të synuara dhe mjedisin e tyre”;

duke pasur parasysh që të gjitha masat e formuluar nga GFCM-ja do të bazohen në këshillat më të mira shkencore të mundshme, duke marrë parasysh faktorët e përshtatshëm mjedisorë, ekonomikë dhe socialë;

duke kujtuar rekomandimin GFCM/41/2017/7 për një plan rajonal veprimi për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar në zonën e aplikimit të GFCM-së;

duke marrë parasysh që mortaliteti në peshkim duhet të mbahet nën kufijtë e sigurt për të garantuar rendimente të larta afatgjata, duke kufizuar rrezikun e kolapsit të rezervave peshkore dhe duke garantuar peshkim të qëndrueshëm;

duke marrë parasysh rëndësinë socioekonomike të peshkimit dhe nevoja për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre;

duke kujtuar që Komiteti Këshillëdhënës Shkencor për Peshkimin (SAC) ka konsideruar në mënyrë të përsëritur, se rezervat e merlucit, skampit, barbunit, gjuhëzës, cikales, karkalecit të thellësisë janë në mbishfrytëzim në nënzonat gjeografike (GSA) 17 dhe 18;

duke vënë në dukje që SAC-ja, në sesionin 21, këshilloi që masat e menaxhimit duhet të zbatohen dhe nënvizoi rëndësinë e identifikimit dhe të zbatimit të zonës shtesë të kufizuara të peshkimit (FRA – Fisheries Restricted Area), duke siguruar që kapaciteti i peshkimit të mos rritet, ndërsa përpjekja e peshkimit të menaxhohet në një mënyrë të qëndrueshme dhe madhësitë minimale të peshkut të zbarkuar janë zbatuar,

miraton, në përputhje me nenet 5/“b”, 8/“b” dhe 13 të Marrëveshjes së GFCM-së, rekomandimin e mëposhtëm:

PJESA I
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM,
SHTRIRJA GJEOGRAFIKE DHE
PËRKUFIZIMET OBJEKTIVAT E
PËRGJITHSHËM

1. Ky rekomandim përcakton një plan menaxhimi shumëvjeçar për aktivitete të qëndrueshme të peshkimit fundor (demersal) në detin Adriatik (GSAs 17 dhe 18) që shfrytëzojnë rezervat fundore, me anë të tratave fundore (trata koce ose OTB), duke përfshirë stoqet kryesore të listuara në shtojcën 1. Në bazë të këshillave të SAC-së, qëllimi i këtij rekomandimi mund të



shtrihet për forma dhe rezerva (lloje) të tjera peshkimi.

2. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të jetë në përputhje me qasjen paraprake. Ai do të hartohet për të siguruar rendimente të larta afatgjata, në përputhje me rendimentin maksimal të qëndrueshëm MSY (*Maximum Sustainable Yield*) dhe për të garantuar një rrezik të ulët të pakësimit të stokeve, duke ruajtur peshkimin e qëndrueshëm dhe relativisht të qëndrueshëm. Plani do të marrë parasysh natyrën e përzier të peshkimit fundor dhe dinamikën midis rezervave të llojeve që e përbejnë atë.

3. Palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC), anijet e të cilave peshkojnë në mënyrë aktive në GSAs 17 dhe 18, bien dakord të zbatojnë një plan të tillë shumëvjeçar të menaxhimit për peshkimin në fjalë dhe në përputhje me objektivat e përgjithshëm dhe specifike, si dhe masat e përcaktuara nga ky rekomandim.

4. Do të ndërmerren një grup masash paraprake të përkohshme të menaxhimit për detin Adriatik, në mënyrë që të sigurohet që, duke minimizuar ndikimet socioekonomike dhe duke realizuar këshillat shkencore të SAC-së, rezervat dhe peshkimi përparojnë drejt niveleve biologjiksht të qëndrueshme.

5. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të vazhdojë të ndjekë, gjithashtu, zvogëlimin e aktiviteteve të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (IUU) në GSA 17 dhe 18.

Shtrirja gjeografike

6. Plani shumëvjeçar i menaxhimit i parashikuar nga ky rekomandim do të zbatohet në GSA 17 dhe 18.

Përkufizimet

7. Për qëllimin e këtij rekomandimi do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Fmsy” nënkupton vlerën e mortalitetit të llogaritur të peshkimit, që, me një model të caktuar peshkimi dhe në kushte mesatare aktuale mjedisore, jep rendimentin maksimal afatgjatë;

b) “Blim” nënkupton pikën limit të referencës, e shprehur si biomasa e rezervës riprodhuese nën të cilën mund të ketë një kapacitet të zvogëluar riprodhues;

c) “Bpa” nënkupton pikën e referencës paraprake, e shprehur si biomasa e rezervës

riprodhuese, e cila siguron që biomasa e rezervës riprodhuese të ketë më pak se 5% probabilitet të jetë nën Blim;

d) “Deti Adriatik” nënkupton GSA-të 17 dhe 18, siç përcaktohet në rezolutën GFCM/33/2009/2 për krijimin e nënzoneve gjeografike në zonën e aplikimit GFCM, që ndryshon rezolutën GFCM/31/2007/2;

e) “Anije aktive peshkimi” nënkupton çdo anije të peshkimit fundor që peshkon speciet kryesore të listuara në shtojcën I dhe me leje peshkimi nga shteti, flamurin e të cilit mban, për të kryer operacione specifike të peshkimit, gjatë një periudhë të caktuar, në një zonë të caktuar ose për një peshkim të caktuar nën kushte specifike;

f) “Rezervat kryesore” janë organizmat detarë që u përkasin specieve, siç përcaktohet në shtojcën I të rekomandimit aktual;

g) “Segmenti i flotës” nënkupton grupin e anijeve që veprojnë me kombinime të llojeve të rrjetave dhe klasat e gjatësisë së anijeve, siç përcaktohet në shtojcën 3 dhe që synojnë rezervat kryesore, siç përcaktohet në shtojcën 1;

h) “Peshkimi i paligjshëm, i paraportuar dhe i parregulluar” ose “peshkimi IUU” nënkupton veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 3 të Planit Ndërkombëtar të Veprimit të FAO 2001 për Parandalimin, Shkurajimin dhe Eliminimin e Peshkimit të Paligjshëm, të Paraportuar dhe të Parregulluar (IOPA-IUU), si dhe dispozitat e rekomandimit GFCM/41/2017/7;

i) “Pikë e përcaktuar për zbarkim” nënkupton porte ose vende afër bregut të përcaktuara nga CPC-ja, sipas rekomandimit GFCM/40/2016/1 për një skemë rajonale për masat e shtetit portual për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar në zonën e GFCM-së të aplikimit, përfshirë terminalet në det të hapur dhe instalimet e tjera për zbarkim, transferim, paketim, përpunim, furnizimin me karburant ose rifurnizimin e anijeve të peshkimit, ku zbarkimi, transferimi, paketimi dhe/ose veprimtaritë e përpunimit të produkteve të peshkut janë të lejuara.

PJESA II

OBJEKTIVAT SPECIFIKË

8. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të synojë të kontribuojë në objektivat e përmendur në nenin



2 dhe parimet e listuara në nenin 5 të marrëveshjes së GFCM-së.

9. Plani shumëvjeçar i menaxhimit, në veçanti, do të:

a) zbatojë qasjen paraprake në menaxhimin e peshkimit;

b) sigurojë që nivelet e shfrytëzimit të rezervave kryesore janë në MSY deri në vitin 2026;

c) parandalojë rritjen e kapacitetit të peshkimit në lidhje me vitin 2015 ose mesataren e 2015–2017 dhe përpjekjen (sforcon) e peshkimit, në lidhje me 2015 ose mesataren e tre vjetëve 2015–2018;

d) mbrojë zonat e riprodhimit dhe të të vegjëleve, si dhe habitatet thelbësore të peshkut EFH (*Essential Fish Habitat*), që janë të rëndësishme për rezervat më kryesore të peshqve fundorë me rendësi tregtare;

e) kontribuojë në eliminimin e hedhurinave (*discards*), duke shmangur dhe duke zvogëluar zëniet e padëshiruara dhe duke siguruar që i gjithë peshku i zënë të zbarkohet;

f) sigurojë masa për të rregulluar kapacitetin dhe përpjekjen e peshkimit të flotës në nivelet e mortalitetit të peshkimit, në përputhje me MSY, me qëllim që të kemi një flotë ekonomikisht të vlefshme dhe pambishfrytëzimin e burimeve biologjike detare.

10. Plani shumëvjeçar i menaxhimit do të bazohet në një qasje me dy hapa, ku: i. në dy vitet e para do të zbatohet një regjim i përkohshëm i përpjekjeve të peshkimit; dhe ii. në vitin 2021, në bazë të të dhënave të reja shkencore, SAC-ja do të vlerësojë gjendjen e stoqeve dhe do të propozojë kuota vjetore të përpjekjeve të peshkimit, në përputhje me dispozitat e përfshira në pjesët II, IV dhe V të këtij rekomandimi, duke kontribuar kështu për të arritur Fmsy dhe duke qëndruar brenda kufijve të sigurt biologjikë.

11. Në vitet 2020 dhe 2021 do të vendoset një regjim paraprak i përkohshëm i përpjekjeve në peshkim. CPC-ja duhet të sigurojë së bashku, që deri në vitin 2021, përpjekja e përgjithshme e peshkimit (numri i ditëve të peshkimit) të vendosur nga flotat që peshkojnë në mënyrë aktive për stoqet kryesore të peshqve fundore (demersale) me trata fundore (koce) dhe që veprojnë në GSAs 17 dhe 18, do të zvogëlohen të paktën 12 për qind për OTB-në dhe 16 për qind për TBB-në, përkatësisht me përpjekjen vjetore të bërë në 2015-n ose me mesataren trevjeçare, brenda periudhës 2015–2018.

Çdo CPC siguron që zvogëlimi i përpjekjeve të jetë proporcional në kontributin e tij për përpjekjen totale në vitin referues në zonë, sipas formave të peshkimit në shtojcën 4, siç raportohet përmes kuadrit së referencës për grumbullimin e të dhënave GFCM (DCRF), detyra V-2 në 2017-n. Ky kontribut do të llogaritet sipas formulës dhe formave të peshkimit në shtojcën 4. Reduktimi i përgjithshëm i përpjekjeve të peshkimit do të ndahet në mënyrë të barabartë në periudhën tranzitore, duke rezultuar në kuotat e përpjekjeve të listuara në shtojcën 4 që do të zbatohen në vitet 2020 dhe 2021.

12. Për vitet 2022–2026 do të vendoset një regjim pesëvjeçar i përpjekjeve të peshkimit. CPC-të do t'i komunikojnë të dhënat e tyre vjetore të përpjekjeve të peshkimit Sekretariatit të GFCM-ja, në përputhje me dispozitat e paragrafit 36. Çdo vit, në bazë të këshillave të SAC-së, GFCM-së, do të përcaktojnë kuota vjetore të përpjekjeve në peshkim. Këto kuota do të shprehen në ditë peshkimi për çdo CPC dhe për segmentet e flotës dhe format e peshkimit, sipas aneksit 3 dhe do të lejojnë arritjen e objektivave të përcaktuar në paragrafin 9. GFCM-ja do të sigurojë që, për secilin CPC, rritja ose ulja e përpjekjeve të alokuara është në përputhje me formulën në shtojcën 4 dhe me përpjekjet totale të peshkimit në vitin referues në atë zonë, sipas formave të peshkimit për çdo segment të flotës të listuar në shtojcën 3, siç raportohet duke filluar nga viti 2021.

13. Dispozitat në paragrafët 11 dhe 12 nuk do të zbatohen për flotat kombëtare që operojnë me trata fundore (koce) dhe peshkojnë më pak se 1 000 ditë gjatë periudhës referuese të përmendur në paragrafin 9/“c”; flota të tilla kombëtare nuk duhet të tejkalojnë kufirin e përpjekjeve prej 3 000 ditësh peshkimi në vit.

Synimet

14. Objektivi operacional i planit shumëvjeçar të menaxhimit do të jetë mbajtja e mortalitetit (vdekshmërisë) të peshkimit për stoqet kryesore të listuara në shtojcën 1, brenda vlerave të parashikuara të referencës paraprake për Fmsy, me qëllim arritjen ose ruajtjen e nivelit të Fmsy, në përputhje me objektivat e këtij rekomandimi.

Masat mbrojtëse

15. Bazuar në këshillat shkencore të SAC-së, kur biomasa e riprodhuesve të ndonjë prej stoqeve kryesore është nën Bpa, GFCM-ja do të marrë



masa përmirësuese për të siguruar kthimin e shpejtë të stoqeve në fjalë mbi ato nivele, të afta për të prodhuar MSY. Në veçanti, përpjekja për peshkim do të vendoset në nivele, në përputhje me prodhimin e një vdekshmërie peshkimi më të ulët se Fmsy, duke marrë parasysh uljen e biomasës.

16. Bazuar në këshillat shkencore të SAC-së, kur biomasa e riprodhuesve të ndonjë prej stoqeve kryesore është nën Blim, GFCM-ja do të marrë masa të mëtijshme përmirësuese për të siguruar kthimin e shpejtë të stoqeve në fjalë mbi ato nivele të afta për të prodhuar MSY. Në veçanti, masa të tilla përmirësuese mund të përfshijnë pezullimin e peshkimit, që synon stoqet përkatëse dhe një zvogëlim adekuat të përpjekjeve të peshkimit ose kufirit të zënies.

PJESA III MASAT TEKNIKE

Madhësia minimale e referencës për ruajtje

17. Do të zbatohet rekomandimi GFCM/40/2016/5, që përcakton një madhësi minimale të referencës së ruajtjes për merlucin në Detin Mesdhe.

18. Madhësia minimale e referencës së ruajtjes përcaktohet, si më poshtë:

- a) për karkalecat e thellësisë, me gjatësi karapace 20 mm (CL);
- b) për skampin, me 20 mm CL ose gjatësi totale 70 mm (TL);
- c) për gjuhëzën, në 20 cm TL; dhe
- d) për barbunin, në 11 cm TL.

19. Individët e stoqeve kryesore më të vogla se madhësia minimale e referencës së ruajtjes, siç përcaktohet në paragrafët 17 dhe 18, nuk do të mbahen në bord, transferohen, zbarkohen, magazinohen, shiten ose ofrohen për shitje.

20. Palët kontraktuese të komunikojnë çdo vit te Sekretariati i GFCM-së metodat specifike që ato zbatojnë në bazë të parashikimeve të përcaktuara në paragrafët 17 deri 19, përfshirë detyrimet e zbarkimit, që synojnë të shmangin hedhurinat, që janë në fuqi në disa Palë Kontraktuese, si dhe metodat e inspektimit të zbarkimit, kur një skemë fleksibël parashikohet në nivelin kombëtar.

Zonat e kufizuara të peshkimit

21. Do të zbatohet rekomandimi GFCM/41/2017/3 për krijimin e një zone të

kufizuar të peshkimit (*Fisheries Restricted Area*) në Gropën e Jabukës/Pomo në detin Adriatik.

22. FRA-ja do të krijohet për ruajtjen dhe administrimin e rezervave peshkore në detin Adriatik. SAC-ja do të shqyrtojë mundësinë e krijimit të FRA-ve të reja në Adriatikon Jugor dhe Verior. Palët Kontraktuese të interesuara, mundësisht duhet të paraqesin të dhënat e nevojshme për vlerësimin e FRA-ve jo më vonë se një muaj përpara takimit të vitit 2020 të Komitetit Nënrajonal për Detin Adriatik (SRC-AS) dhe të mbështesin punën për vlerësimin e FRA-ve, në përputhje me ecurinë e përshkruar në shtojcën 2.

23. Do të ndalohet çdo aktivitet i peshkimit me trata fundore (koce) në FRA, e krijuara sipas paragrafëve 21 dhe 22, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga një rekomandim specifik për rregullat e menaxhimit për secilën nga këto FRA.

24. SAC-ja mund të identifikojë zonat e riprodhimit dhe të rritjes së të vegjëlve për cilindo prej rezervave demersale në detin Adriatik dhe, në rastin kur stoku është jashtë kufijve të sigurt, SAC-ja mund të propozojë masa shtesë, të cilat mund të përfshijnë kufizimin e veprimtarisë së peshkimit jashtë ujërave territoriale.

Mbyllja e peshkimit në hapësirë dhe në kohë

25. Për qëllime të ruajtjes së rezervave, palët kontraktuese duhet të mbyllin zonën bregdetare, pavarësisht nga thellësia, deri në gjashtë milje detare nga bregu ose katër milje detare për anijet që nuk lejohen të peshkojnë më shumë se gjashtë milje detare, për të gjitha anijet e peshkimit fundor (trata koce) që peshkojnë peshq fundorë, për një periudhë të vazhdueshme për të paktën tetë javë.

26. Në alternativë të paragrafit 25, palët kontraktuese duhet të mbyllin për të paktën 30 ditëve të vazhdueshme dhe të mbulojnë të paktën 20 për qind të detit territorial për të gjitha anijet e peshkimit fundor (trata koce), pavarësisht nga gjatësia e tyre e përgjithshme, në zonat dhe periudhat e njohura si të rëndësishme për mbrojtjen e të vegjëlve të peshqve fundorë (demersale). Zonat e tilla, gjithashtu, duhet të llogaritin rrugët e migracionit dhe modelet hapësinore të shpërndarjes së të vegjëlve.

27. Për të përcaktuar kufizimet e duhura hapësinore-kohore, në funksion të administrimit të qëndrueshëm të rezervave të peshqve të



përmendura në shtojcën 1, palët kontraktuese i komunikojnë Sekretariatit të GFCM-së, jo më vonë se 30 qershori 2020, dhe çdo vit pas kësaj, kufizimet hapësinore, si përcaktohet në paragrafët 25 ose 26, në ujërat nën juridiksionin e tyre, të cilat ato zbatojnë, me qëllim mbrojtjen e zonave të riprodhimit dhe të të vegjëlvë të peshqve fundorë (demersale) të listuar në shtojcën 1.

PJESA IV MASAT E MENAXHIMIT TË FLOTËS

28. Palët kontraktuese duhet të sigurojnë që kapaciteti i përgjithshëm i flotës që peshkojnë në mënyrë aktive me trata fundore (koce) për rezervat kryesore të peshqve fundore (demersal), për sa i përket tonazhit bruto (GT) dhe/ose tonazhit të regjistruar bruto (GRT), fuqisë së motorike (kw) dhe numrit të anijeve, siç është regjistruar si në regjistrat kombëtarë ashtu edhe në GFCM, nuk tejkalon, gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij rekomandimi, kapacitetin e flotës për peshkimin demersal në 2015 ose mesataren e tij gjatë 2015–2017.

29. Dispozitat e paragrafëve 9/“c” dhe 28 nuk do të zbatohen për flotat kombëtare që operojnë me trata koce dhe peshkojnë për më pak se 1 000 ditë gjatë periudhës referuese të përmendur në paragrafin 9/“c”. Kapaciteti i peshkimit të flotave të tilla aktive që veprojnë me trata koce nuk do të rritet më shumë se 50 për qind, në lidhje me periudhën e referimit.

30. Anijet e autorizuar, që përdorin trata koce në detin Adriatik, për të peshkuar për rezervat kryesore të listuara në shtojcën 1, do të listohen nga palët kontraktuese, flamurin e së cilës mbajnë.

31. Palët kontraktuese do t'i komunikojë Sekretariatit të GFCM-së, jo më vonë se 31 janari i çdo viti, listën e anijeve që mbajnë flamurin e tyre dhe peshkojnë në mënyrë aktive për rezervat kryesore të listuara në shtojcën 1 për vitin aktual ose vitet e ardhshme. Kjo listë do të përfshijë, për secilën anije, informacionin e përmendur në shtojcën 3 të rekomandimit GFCM/42/2018/5 mbi një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor, që shfrytëzon rezervat e demersaleve në ngushticën e Sicilisë (në zonat gjeografike 12 deri në 16, që shfuqizon rekomandime GFCM/39/2015/2 dhe GFCM/40/2016/4).

32. Anijet që operojnë me trata fundore (koce) dhe që shfrytëzojnë rezervat e peshqve fundore (demersale) në detin Adriatik do të lejohen të kryejnë veprimtari specifike të peshkimit, nëse këto përcaktohen në një autorizim të vlefshëm peshkimi të lëshuar nga autoritetet kompetente. Anijet e autorizuar mbi gjatësi 12 metra duhet të pajisen me një sistem monitorimi të anijeve (VMS) nga 1 janari 2021 dhe me një regjistrë elektronik (ERS) nga 1 janari 2022, ndërsa, për anijet e autorizuar nën 12 metra, Komiteti i Pajtueshmërisë (CoC) I GFCM vlerëson sistemet më të përshtatshme të gjeopozicionimit dhe raportimin e zënieve.

33. Palët Kontraktuese do të sigurojnë që janë krijuar mekanizma adekuatë për regjistrimin e secilës anije peshkimi në regjistrin kombëtar të flotës, për regjistrimin e zënieve të anijes dhe përpjekjet e peshkimit përmes *logbook*-ut si dhe për monitorimin e aktiviteteve të anijeve të peshkimit dhe zbarkimit përmes anketave për marrjen e mostrave të zënieve dhe të përpjekjeve, sipas rregullave të përcaktuara nga secila palë kontraktuese.

34. Për të eksploruar një monitorim sa më të mirë të përpjekjeve të peshkimit për të zbuluar orët aktuale të peshkimit, GFCM-ja do të nisë një projekt pilot, që synon instalimin e sensorëve në vinçat e anijes, në mënyrë që të regjistrojë dhe të raportojë në kohë reale të hedhurat dhe tralimin e rrjetave fundore (demersale).

35. Dispozitat e mësipërme nuk cenojnë rekomandimin GFCM/33/2009/7, në lidhje me standardet minimale për krijimin e një sistemi të monitorimit të anijeve në zonën e aplikimit të GFCM.

36. Duke filluar nga 1 janari 2021, me qëllim të mbledhjes së të dhënave për përpjekjet e peshkimit për krijimin e një regjimi të ardhshëm të përpjekjeve të peshkimit, Palët Kontraktuese të raportojnë çdo vit pranë Sekretariatit të GFCM-së deri më 30 qershor të çdo viti të dhëna nga viti i kaluar për Kw x ditë të peshkimi për trata koce dhe gjatësi anije, pa shkrirje të klasave të gjatësisë së anijes.



PJESA V
MONITORIMI SHKENCOR,
PËRSHTATJA DHE RISHIKIMI I PLANIT
SHUMËVJEÇAR TË MENAXHIMIT

37. Komiteti Këshillëdhënës Shkencor (SAC, *Scientific Advisory Committee*) do të sigurojë, mbi baza vjetore, deri në vitin 2020, këshilla mbi statusin e rezervave kryesore në detin Adriatik, duke përfshirë edhe objektiva specifike për të ruajtur mortalitetin (vdekshmërinë) e peshkimit brenda pikave të referimit të rëna paraprakisht dakord dhe për të ruajtur ose për të rivendosur rezervat kryesore në nivele që mund të prodhojnë MSY, në përputhje me objektivat e përcaktuar në paragrafin 1.

38. SAC-ja do të vlerësojë pasojat biologjike, ekonomike dhe sociale të zbatimit të disa skenarëve të menaxhimit, me qëllim rivendosjen dhe mirëmbajtjen e popullatës së rezervave peshkore mbi nivelet që mund të prodhojnë MSY.

39. Bazuar në këshillat e SAC-së, GFCM-ja mund të rishikojë përmbajtjen e planit shumëvjeçar të menaxhimit.

40. Kur këshillat e SAC-së tregojnë se objektivat e përgjithshëm ose specifike të planit shumëvjeçar të menaxhimit nuk janë duke u përmbushur, GFCM-ja vendos për masa shtesë dhe/ose alternative të menaxhimit për të kontribuar në arritjen e këtyre objektivave.

41. Nëse, për ndonjë arsye (p.sh., mungesa e të dhënave të përshtatshme), SAC-ja nuk është në gjendje të sigurojë një këshillë të saktë për gjendjen e rezervave të specieve kryesore të listuara në aneksin 1 dhe për nivelet e tyre të shfrytëzimit, GFCM-ja do të vendosë për masa me të përshtatshme të menaxhimit për të siguruar qëndrueshmërinë e peshkimit. Masa të tilla do të bazohen në këshillat e SAC-së, do të jenë në përputhje me qasjen paraprake dhe të marrin parasysh elementet mjedisore dhe socioekonomike, në një mënyrë që garantojnë qëndrueshmërinë e peshkimit.

42. Në vitin 2020, SAC-ja do të vlerësojë ndikimin e peshkimit me grepa fundorë (*bottom longlines*), që synon peshkimin e riprodhuesve të merlucit në stokun e detit Adriatik. SAC-ja do të vlerësojë nevojën për të përfshirë anijet që ushtrojnë këtë formë peshkimi në këtë plan menaxhimi shumëvjeçar dhe nevoja për të miratuar

masa specifike hapësinore për të mbrojtur stokun riprodhues të merlucit në detin Adriatik.

PJESA VI
MASAT SPECIFIKE PËR TË ADRESUAR
AKTIVITETET E PESHKIMIT IUU (PPP)

43. Palët kontraktuese duhet të krijojë një mekanizëm për të siguruar që anijet që peshkojnë në mënyrë aktive në detin Adriatik të deklarojnë të gjitha zëniet dhe zëniet shoqëruese të specieve kryesore të listuara në shtojcën 1. Detyrimi për të deklaruar elektronikisht zëniet do të zbatohet nga 1 janari 2022, pavarësisht nga sasia e zënë, për anijet mbi 12 metra gjatësi, ndërsa për anijet nën 12 metra, CoC-ja do të vlerësojë sistemin më të përshtatshëm të raportimit të zënieve.

44. Çdo palë kontraktuese do të përcaktojë pikat e zbarkimit (*landing point*) ku do të bëhet zbarkimi nga anijet që peshkojnë, në mënyrë aktive për rezervat kryesore në detin Adriatik.

45. Për secilin port të caktuar, palët kontraktuese duhet të specifikojnë kohën dhe vendet e lejuara të zbarkimit dhe të transferimit.

46. Palët kontraktuese të kryejnë inspektime në bazë të një analize të rrezikut.

47. Ndalohej zbarkimi ose transferimi nga anijet e peshkimit të çdo sasive të rezervave kryesore të peshkuara me trata fundore (koce) në detin Adriatik, përveç porteve të përcaktuara nga palët kontraktuese, në përputhje me paragrafin 44 më lart.

48. Palët kontraktuese do t'i komunikojë Sekretariatit GFCM, jo më vonë se 30 nëntori i çdo viti, çdo ndryshim në listën e pikave të caktuara të zbarkimit, ku mund të ndodhin zbarkime të rezervave kryesore në detin Adriatik.

49. Palët kontraktuese do të angazhohen për të bashkëpunuar në luftën kundër aktiviteteve të peshkimit IUU (PPP), veçanërisht përmes shkëmbimit dhe mbledhjes së informacionit për të luftuar kundër veprimtarive të paligjshme.

50. Pjesa VI e këtij rekomandimi nuk paragjykon zbatimin e rekomandimit GFCM/41/2017/7.



PJESA VII
PROGRAMI I MONITORIMIT,
KONTROLLIT DHE MBIKËQYRJES

51. Duke filluar nga 1 janari 2021, anijet e autorizuar të peshkimit fundor (koce), mbi 12 metra gjatësi, që peshkojnë në mënyrë aktive për rezervat kryesore të specieve të listuara në shtojcën 1, do të pajisen me VMS; për anijet nën 12 metra, CoC-ja do të vlerësojë sistemin më të përshtatshëm të gjeopozicionimit, duke lejuar autoritetet e kontrollit të ndjekin aktivitetet e tyre.

52. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 1 të rekomandimit GFCM/35/2011/1, në lidhje me krijimin e një regjistri GFCM, duke ndryshuar rekomandimin GFCM/34/2010/1, të gjitha zëniet e rezervave të specieve kryesore, pavarësisht nga pesha e zënë, si dhe zëniet e llojeve jokryesore (*non-target*) mbi 50 kg, do të raportohen në *logbook*.

53. Palët kontraktuese të monitorojnë konsumin e kuotës së sforcos ose kufirin e sforcos, në përputhje me paragrafin 13, të shprehur në ditët e peshkimit deri në vitin 2021 (shtojca 4) dhe në ditët e peshkimit për çdo segment flote (shtojca 3) pas 2021. Që nga data kur kuota e sforcos është përmbushur ose është arritur kufiri i sforcos, pala kontraktuese e interesuar do t'ia komunikojë atë Sekretariatit GFCM dhe do të ndalojë peshkimin, kur kuota ose kufiri i sforcos është arritur nga të gjitha ose një pjesë e anijeve të peshkimit që mbajnë flamurin e saj.

PJESA VIII
SKEMA E INSPEKTIMIT PILOT

54. Me kërkesë të palëve kontraktuese, me ndihmën e Sekretariatit të GFCM-së, GFCM-ja do të fillojë në vitin 2020 një projekt pilot, me qëllim krijimin e një programi vëzhgimi dhe inspektimi, në mënyrë që të sigurojë pajtueshmërinë me masat e ruajtjes dhe të menaxhimit të përfshira në këtë rekomandim.

55. Ky program i vëzhgimit dhe i inspektimit do të bazohet në rezultatet e projektit pilot dhe të miratuar para fundit të vitit 2020. Ai do të përfshijë, ndër të tjera, elementet e mëposhtme:

- a) inspektim në det të hapur;
- b) procedurat për një hetim efektiv mbi një shkelje të pretenduar të masave të ruajtjes dhe të menaxhimit të përfshira në këtë rekomandim dhe

për raportimin në GFCM, për veprimet e ndërmarra, përfshirë procedurat për shkëmbimin e informacionit;

c) dispozitat për veprimet e duhura që duhen ndërmarrë, kur inspektimet zbulojnë shkelje të rënda, si dhe ndjekja e duhur dhe transparente e veprimeve të tilla, në mënyrë që shteti flamur të mbajë përgjegjësinë në kuadër të programit të synuar;

d) inspektime portuale;

e) monitorimin e zbarkimeve dhe të zënieve, përfshirë ndjekjen statistikore për qëllime menaxhimi;

f) programe specifike të monitorimit, përfshirë dhe inspektimin me anije; dhe

g) programet e vëzhguesve.

PJESA IX
PLANET E MENAXHIMIT KOMBËTAR

56. Për të siguruar ruajtjen e duhur të rezervave demersale, palët kontraktuese duhet të miratojnë masa të menaxhimit të peshkimit ose plane kombëtare të menaxhimit në detin Adriatik.

57. Palët kontraktuese njoftojnë Sekretariatin e GFCM-së, nga 31 janari 2020, për masat e menaxhimit ose për planet e menaxhimit të miratuara në nivelin kombëtar. Kur është e përshtatshme, nëse këto masa ndryshohen, palët kontraktuese do të komunikojnë këto ndryshime deri më 31 janar të vitit pasardhës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

58. Plani shumëvjeçar i menaxhimit i krijuar me këtë rekomandim mbetet në fuqi për shtatë vjet nga data e miratimit të tij.

59. Masat në këtë rekomandim nuk cenojnë masa më të rrepta të miratuara nga palët kontraktuese.

60. GFCM-ja mund të rishikojë këtë rekomandim, në bazë të këshillave shkencore të SAC-së.



SHTOJCA 1
LISTA E SPECIEVE KRYESORE TË
ADRESUARA NGA KY REKOMANDIM

Emri	Emri shkencor	GSA 17	GSA 18
Merluc	<i>Merluccius merluccius</i>	X	X
Skampi	<i>Nephrops norvegicus</i>	X	X
Gjuhëza	<i>Solea solea</i>	X	X
Karkalec thellësie	<i>Parapenaeus longirostris</i>	X	X
Barbun	<i>Mullus barbatus</i>	X	X

SHTOJCA 2
KUSHTET E REFERENCËS PËR KRIJIMIN
E FRA-ve NË DETIN ADRIATIK

Në vazhden e zbatimit pozitiv të Jabuka/Pomo FRA, me frymë të ngjashme bashkëpunimi dhe duke njohur vlerën e miratimit të masave të ngjashme në pjesën tjetër të detit Adriatik, puna duhet të përparojë drejt krijimit të FRA-ve në Adriatikon Jugor dhe Verior.

Hapat e mëposhtëm janë planifikuar:

1. Palët kontraktuese, veçmas vlerësojnë realizueshmërinë e FRA-ve, në konsultim me aktorët kombëtarë;

2. Komponentët kryesorë duhet të përfshijnë ekosistemet e ndjeshme detare (*Vulnerable Marine Ecosystems VME*), habitatet thelbësore të peshkut (*Essential Fish Habitats EFH*), dinamikën hapësinore të flotës së peshkimit dhe ndikimet socioekonomike, siç parashikohen nga administratat kombëtare;

3. Diskutimet bilaterale zhvillohen midis Palëve Kontraktuese, në lidhje me FRA-të e mundshme;

4. Organizimi i një *workshop*-i me palët kontraktuese, shkencëtarë dhe palë të interesuara dhe me mbështetjen e projektit FAO AdriaMed, për të ekzaminuar të gjithë komponentët kryesorë për krijimin e FRA-ve të reja.

Grupi i punës të tentojë para Komitetit Subregional të ardhshëm për detin Adriatik të finalizojë dhe të bien dakord për të gjitha elementet që duhet të përmbahen në propozimin e FRA-ve, siç përshkruhet në “Formën standarde për paraqitjen e propozimeve për zonat e kufizuara të peshkimit në Mesdhe dhe Detin e Zi të GFCM-së”.

SHTOJCA 3
SEGMENTET E FLOTËS (PËRSHTATUR PËR SHQIPËRINË)

Tipi i rrjetës	Nënzona gjeografike (GSAs)	Speciet e përfshira	Segmentet e flotës sipas gjatësisë	Dite peshkimi ²
Trata fundore (koce)	18	Barbun, merluc, karkalec thellësie, skampi	>12 - <24m >24 m	

SHTOJCA 4
FORMULA E NDARJES SË SFORCËS SË PESHKIMIT (PËRPJEKJEVE)

Formula e ndarjes ku kuotat e sforcës janë proporcionale me kontributin e CPC-së në sforcon totale, në një vit të caktuar referimi dhe të gjitha klasgjatësitë e anijeve:

$$[\text{Pakësimi i CPCa} = \text{Pakësimin e përgjithshëm} \times (\text{CPCa}^2 / (\text{CPCa}^2 + \text{CPCb}^2 + \text{CPCc}^2 + \text{CPCd}^2 + \text{CPCe}^3))]]$$

Gjatë viteve 2020–2021 do të vendoset një pakësim i përgjithshëm prej 12 përqindësh mbi numrin e ditëve të peshkimit për tratat fundore (koce), të raportuar në DCRF detyra V-2, për vitin 2015 ose mesataren e viteve 2015–2018.

Formula e mësipërme përdoret për të shpërndarë kuotën e ditëve të peshkimit për Palët Kontraktuese për anijet e peshkimit fundor dhe raportohet në tabelën më poshtë:

Forma e peshkimit	Zona gjeografike	EU 2020	EU 2021	Shqipëri 2020	Shqipëri 2021	Mali i Zi 2020	Mali i Zi 2021
Peshkim fundor: trata, koce	17–18	147 606	137 046	23 124	22 748	NA	NA ³

² Këto të dhëna do të plotësohen duke filluar nga viti 2021.

³ Mali i Zi nuk kalon limitin e 3000 ditëve në peshkim në vit në përputhje me paragrafin 13.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë